REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Arsimit dhe Sportit

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

## 2022

ASCAP

Drejtoria e Performancës

www.ascap.edu.al

# Raporti i Vlerësimit të Performancës së SAPU - 2022

**HYRJE**

Vizioni i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS)për sektorin e arsimit është një sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Europian. Në funksion të këtij procesi, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 (SKA) është në harmoni me objektivat e kornizës europiane për fushën e arsimit dhe të formimit, me Kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe me Objektivin 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qendrueshëm.

Vizioni i MAS-it bazohet në realizimin e tri qëllimeve kryesore të politikave:
**Qëllimi i Politikës A:** Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.
**Qëllimi i Politikës B:** Menaxhim efektiv dhe efecient i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.
**Qëllimi i politikës C:** Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Qëllimi i politikës A lidhet me arsimin parauniversitar dhe zbërthehet në 5 objektiva specifikë:
**Objektivi specifik A1:** Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë.
**Objektivi specifik A2:** Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
**Objektivi specifik A3:** Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie.
**Objektivi specifik A4:** Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë.
**Objektivi specifik A5:** Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.

Qëllimi i politikës B lidhet me menaxhimin e sistemit të arsimit dhe zbërthehet në 2 objektiva specifikë:
**Objektivi specifik B1:** Rritja e performancës së shkollës nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional e të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë.
**Objektivi specifik B2:** Garantimi i performancës së sistemit të arsimit nëpërmjet ndërtimit të një kornize gjithëpërfshirëse të vlerësimit dhe kapaciteteve për zbatimin e saj.
Roli udhëheqës në zbatimin e SKA-së i takon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si institucion përgjegjës për fushën e arsimit. Përgjegjësia institucionale për të realizuar vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar i është ngarkuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është e përcaktuar në Planin e Veprimit dhe ndahet ndërmjet MAS-it, institucioneve vartëse, institucioneve arsimore, vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë.

Ky raport është hartuar nga Drejtoria e Performancës pranë ASCAP-it, institucioni përgjegjës për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, bazuar në VKM Nr. 98, datë 27.02.2019, "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)".

Falenderojmë anëtarët e grupit që kontribuan për hartimin e raportit, si dhe të gjithë aktorët të cilët dhanë kontributin e tyre për grumbullimin e të dhënave statistikore.

Ky është raporti i parë i vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri nga një institucion i brendshëm.

**GRUPI HARTUES I RAPORTIT**


| | |
|---|---|
| Gerti Janaqi | Drejtor i Përgjithshëm |
| Bashkim Muça | Drejtor Drejtorie |
| Redian Dengeri | Përgjegjës Sektori |
| Ermal Kola | Specialist |
| Adel Iljazi | Specialist |
| Erjola Shehaj | Specialist |
| Albina Nuredini | Specialist |
| Mirela Kondili | Specialist |
| Etleva Lundra | Specialist |
| Lindita Çifçi | Specialist |

**TABELA E PËRMBAJTJES**

**1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

1.1. Qëllimi i vlerësimit
1.2. Metodologjia
1.3. Institucionet përgjegjëse/kontribuese

**2. KONTEKSTI I VLERËSIMIT**

2.1. Kuadri ligjor
2.2. Kuadri institucional
2.3. Gjendja e sistemit

**3. VLERËSIMII PËRGJITHSHËM**

3.1. Vlerësimi i qëllimit të politikave
3.2. Vlerësimi i objektivave

**4. VLERËSIMI TEKNIK**

4.1. Aksesi në arsim
4.2. Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës
4.3. Mësuesit
4.4. Zotërimi i kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës
4.5. Digjitalizimi i arsimit
4.6. Menaxhimi i sistemit

**5. REKOMANDIME**

**6. REFERNCAT**

**7. ANEKSI 1**
Tabela përmbledhëse e vlerësimit të performancës së sistemit

**SHKURTIMET**

| | |
|---|---|
| ASCAP | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar |
| DPAP | Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar |
| DRAP | Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar |
| KEK | Korniza Evropiane e Kualifikimeve |
| IAL | Institucioni i Arsimit të Lartë |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| KSHK | Korniza Shqiptare e Kualifikimeve |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| NjVV | Njësia e Vetëqeverisjes Vendore |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim |
| PBA | Programi buxhetor afatmesëm |
| PBB | Produkti i brendshëm bruto |
| PISA | Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve |
| PKAB | Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë |
| QSHA | Qendra e Shërbimeve Arsimore |
| RASH | Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar |
| SAPU | Sistemi Arsimor Parauniversitar |
| SKA | Strategjia Kombëtare e Arsimit |
| SMIP | Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën |
| VANAF | Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor |
| ZVAP | Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar |

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## 1.1. Qëllimi i vlerësimit

Dy qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së SAPU-së janë:

a) Nxitja e llogaridhënies së aktorëve të sistemit arsimor, për përmbushjen e objektivave në funksion të qëllimit të politikave.
b) Përmirësimi i politikave arsimore dhe rritja e rezultateve të sistemit, nëpërmjet shfrytëzimit të informacionit të saktë për gjendjen e sistemit.

## 1.2. Metodologjia e vlerësimit

Lidhur me mënyrën se si veprohet për vlerësimin e arritjeve të synuara në objektivat e SKA-së, ndiqen hapat e mëposhtëm:

### 1.2.1. Planifikimi i vlerësimit

Planifikimi është procesi ku përcaktohen **o**bjekti, mënyra dhe koha e planifikimit, si dhe planifikimi i aspekteve kryesore të vlerësimit.

### 1.2.2. Metodat e mbledhjes së të dhënave

Për grumbullimin e të dhënave përdoren metodat e mëposhtme:

- Të dhënat zyrtare online
- Të dhënat me kërkesë zyrtare
- Raportet zyrtare
- Të dhëna nga raportet, testimet dhe programet ndërkombëtare
- Monitorimi i drejtpërdrejtë
- Intervistimi

### 1.2.3. Kriteret e vlerësimit

Në dokumentet e vlerësimit të performancës miratuar me Urdhër Nr. 130, datë 16.03.2022 "Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës në Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe Manualit të saj", janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e performancës: kriteri ligjor, kriteri profesional, kriteri financiar dhe kriteri menaxherial.

### 1.2.4. Nivelet e vlerësimit

Korniza e Vlerësimit të Performancës përcakton pesë nivele vlerësimi 1-5, sipas përqindjeve të rezultatit të arritur.

### 1.2.5. Kronologjia e vlerësimit

Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar është realizuar në mënyrë të përshkallëzuar, nga poshtë lart, duke filluar me nivelin e realizimit të treguesve, që përcaktojnë nivelin e realizimit të masave dhe duke vijuar me nivelin e realizimit të produkteve, objektivave dhe qëllimit të politikave.

Për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor ndiqet kronologjia e mëposhtme:

- Treguesi
- Masa
- Produkti
- Objektivi
- Qëllimi i politikës
- Performanca e sistemit

### 1.2.6. Teknika e vlerësimit

**Teknika e vlerësimit të realizimit të masës**

Matja e treguesve kombëtarë të realizimit të masës
Përqindja e realizimit të treguesve
Niveli i indeksuar 1-5, i realizimit të masës

**Formati i vlerësimit të masës**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS/VEPRIMTARISË - Indeksi 1-5 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| X.N.N.N. | Përshkrimi i masës/veprimtarisë | T1 | % | |
| | | TN | % | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës/veprimtarisë X.N.N.N.** | | **% mesatare** | |

**Teknika e vlerësimit të realizimit të produktit**

Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të masave, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të produktit.

**Formati i vlerësimit të produktit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT (1-5) | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| X.N.N. | Përshkrimi i produktit | X.N.N.1 | Indeksi |
| | | X.N.N.N | Indeksi |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.** | | **Indeksi mesatar** |

**Teknika e vlerësimit të realizimit të objektivit**

Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të produkteve, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të objektivit.

**Formati i vlerësimit të objektivit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5) | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| X.N. | Përshkrimi i objektivit | X.N.1. | Indeksi |
| | | X.N.N. | Indeksi |
| | **Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N.** | | **Indeksi mesatar** |

**Teknika e vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës**

Nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të objektivave, shprehur me indeks zbatimi 1-5, vlerësohet niveli i realizimit të qëllimit të politikës.

**Formati i vlerësimit të qëllimit të politikës**

| VLERËSIMI I I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5) | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Qëllimit i politikës** | **Objektivi** | **Vlerësimi** |
| X | Përshkrimi i qëllimit të politikës | X.1. | Indeksi |
| | | X.N. | Indeksi |
| | **Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës X** | | **Indeksi mesatar** |

**Teknika e vlerësimit të performancës së sistemit**

Në përfundim, nëpërmjet mesatares së ponderuar të realizimit të qëllimit të politikave, vlerësohet performanca e sistemit arsimor parauniversitar.

**Formati i vlerësimit të performancës së sistemit**

| VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË | | |
|---|---|---|
| **PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR** | **Qëllimi i politikës** | **Vlerësimi 1-5** |
| | Përshkrimi i qëllimit të politikës 1 | Indeksi mesatar |
| | Përshkrimi i qëllimit të politikës X | Indeksi mesatar |
| | **Vlerësimi i performancës së SAPU-së** | **Indeksi mesatar P1-PN** |

**Korniza e vlerësimit të performancës**

| Vlerësimi | Kriteret | % | Niveli |
|---|---|---|---|
| **Nuk ka progres** | ▪ Mungon kuadri i plotë ligjor, mungojnë aktet nënligjore si vendimet, udhëzimet, për realizimin e objektivave/qëllimeve të politikave të SKA-së.<br>▪ Ka mungesë në plotësimin e strukturave.<br>▪ Mungojnë burimet financiare të nevojshme për mbështetjen e plotësimit të akteve nënligjore dhe strukturave institucionale.<br>▪ Mungojnë hapat konkretë në drejtim të menaxhimit. | **0-19%** | **1** |
| **Ka pak progres** | ▪ Ekzistojnë ligjet kryesore, vendimet, udhëzimet për realizimin e objektivave/qëllimeve të politikave të SKA-së, por ka mungesa akoma në kuadrin ligjor.<br>▪ Struktura institucionale është plotësuar mjaftueshëm, por ka akoma mungesa në burimet njerëzore.<br>▪ Mungojnë burimet financiare për të mbështetur zbatimin e plotë të objektivave.<br>▪ Ka hapa të ngadalshëm për realizimin e planeve të hartuara, bazuar në praktikat më të mira. | **20-39%** | **2** |
| **Në progres e sipër** | ▪ Kuadri ligjor/rregullator është miratuar në funksion të realizimit të objektivave dhe legjislacioni është në zbatim e sipër në dy vitet e fundit.<br>▪ Struktura institucionale është e plotësuar.<br>▪ Ka mbështetje të pjesshme financiare në zbatim të elementëve të veçantë të kuadrit ligjor dhe politikave.<br>▪ Ekzistojnë praktika të mira menaxheriale për zhvillimin e veprimtarive, por ka ngecje në zbatimin e tyre. | **40-59%** | **3** |
| **Ka shumë progres** | ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimeve të politikave të SKA-së.<br>▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë.<br>▪ Ka mungesa në mbështetjen financiare për realizimin e plotë dhe në kohë të planeve të veprimit.<br>▪ Ecuria e realizimit masave/veprimtarive është e dukshme në katër vitet e fundit. | **60-79%** | **4** |
| **Realizuar** | ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimeve të politikave të SKA-së.<br>▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë shumë mirë.<br>▪ Financimi është në përputhje të plotë me kontekstin dhe zhvillimet në zbatim të qëllimit të politikave.<br>▪ Është krijuar një model i qëndrueshëm i menaxhimit institucional për zbatimin e kuadrit ligjor . | **80-100%** | **5** |

### 1.3. Institucionet përgjegjëse/kontribuuese për vlerësimin e performancës

**1.3.1.** Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgjegjësinë për zhvillimin e sistemit arsimor në Shqipëri. Ajo ushtron këtë rol nëpërmjet strukturave të saj, në qendër dhe në bazë, si dhe nëpërmjet institucioneve të varësisë.

**1.3.2. Institucioni përgjegjës për vlerësimin e performancës** së sistemit arsimor parauniversitar, është **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)**, bazuar në VKM Nr. 98, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)", sipas dispozitave më poshtë:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME 4/a**
4. Fushat e përgjegjësisë së ASCAP-it janë:
**a) garantimi dhe vlerësimi i performancës** së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË ASCAP**
*Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ka përgjegjësi të:*
**a) organizojë punën për vlerësimin e performancës** së sistemit arsimor parauniversitar,publik dhe *privat.*

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ASCAP**
5. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar kryen detyrat, si më poshtë vijon:
**a) vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar**, efektshmërinë dhe efiçencën e masave si dhe përmbushjen e objektivave.

**1.3.3.Institucionet kontribuese** janë **Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore**, të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ose janë kontribues në realizimin e masave të përcaktuara në SKA dhe dërgimin e të dhënave pranë ASCAP-it.

## 2. KONTEKSTI I VLERËSIMIT

Më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë e teknologjikë me ndikim në zhvillimet në fushën e arsimit.

### 2.1. Kuadri ligjor

- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" , i ndryshuar.
- VKM Nr. 98, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)".

- VKM Nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- VKM Nr. 540, datë 19.9.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre”.
- VKM Nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- Urdhri Nr. 130, datë 16.03.2022 Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës në Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe Manualit të saj”.
- Urdhri Nr. 172 datë 3.4.2023 “Për miratimin e raportit për përcaktimin e paketës së treguesve kombëtar të vlerësimit të sistemit arsimor”.

### 2.2. Kuadri institucional

Sistemi arsimor në Republikën e Shqipërisë përfshin pesë nivele kryesore:

- Arsimi parashkollor, mosha 3-6 vjeç.
- Arsimi fillor, mosha 6-10 vjeç.
- Arsimi i mesëm i ulët, mosha 11-14 vjeç.
- Arsimi i mesëm i lartë, mosha 15-18 vjeç.
- Arsimi i lartë, mosha mbi 18 vjeç.

#### 2.2.1. Struktura qeverisëse

**Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**
Republika e Shqipërisë praktikon një qeverisje të centralizuar të sistemit arsimor. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) është përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, ndërsa arsimi dhe formimi profesional janë kompetencë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

#### 2.2.2. Njësitë zbatuese të arsimit parauniversitar

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**
ASCAP-i është përgjegjës për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor, hartimin e kurrikulës dhe zhvillimin profesional të mësuesve,si dhe sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

**Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP)**
DPAP-ja është njësia zbatuese e MAS për arsimin parauniversitar e cila ka 4 drejtori rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) Lezhë, Durrës, Korçë dhe Fier, si dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) në 61 bashki. DPAP-ja dhe strukturat e saj të varësisë janë përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të arsimit parauniversitar, duke përfshirë ndër të tjera: monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin; planifikimin e buxhetit të shkollave; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore; zbatimin e kurrikulës dhe standardeve; ofrimin e asistencës teknike në shkolla, punësimin e mësuesve dhe bashkërendimin me autoritetet vendore.

**Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)**
QSHA-ja është përgjegjëse për zhvillimin, administrimin dhe analizën e rezultateve të testeve kombëtare e ndërkombëtare. Në veçanti, QSHA-ja është përgjegjëse për maturën shtetërore, zhvillimin e provimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, provimet e shtetit për profesionet e rregulluara, si dhe administron bazën e të dhënave shtetërore për arsimin.

**Shkolla e Drejtorëve**
Shkolla është krijuar si organizatë jofitimprurëse dhe funksionon me mbështetjen e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).

**2.3. Gjendja e sistemit**

**Aksesi në arsim**
Tabelat e mëposhtme krijojnë një panoramë të qartë mbi të dhënat statistikore që lidhen me aksesin në arsimin shqiptar në 5 vitet e fundit. Mbi bazën e këtyre të dhënave analizohet situata në arsimin e sotëm dhe tendencat për të ardhmen. Të dhënat e tabelave janë marrë nga statistikat zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për arsimin në 5 vitet e fundit.

**Tabela 1**. Numri i institucioneve sipas niveleve, në një hark kohor 5-vjeçar

| Numri i institucioneve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi bazë** | **Arsimi i mesëm** | **Gjithsej** |
| 2017 - 2018 | 1919 | 1345 | 454 | 3718 |
| 2018 - 2019 | 2063 | 1265 | 456 | 3784 |
| 2019 - 2020 | 2121 | 1228 | 458 | 3807 |
| 2020 - 2021 | 2156 | 1172 | 451 | 3779 |
| 2021 - 2022 | 2090 | 1166 | 452 | 3708 |




Nga të dhënat rezulton se numri i institucioneve në arsimin parashkollor ka ardhur në ngritje, me përjashtim të vitit të fundit. Numri i institucioneve të arsimit bazë ka ardhur në ulje të butë, ndërsa numri

i institucioneve të arsimit të mesëm është i qëndrueshëm. Shihet se numri i përgjithshëm i institucioneve për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në 5 vitet e fundit është pak a shumë i qëndrueshëm.

**Tabela 2.** Raporti bruto i regjistrimit, sipas niveleve, përgjatë një harku kohor 5- vjeçar

| Numri i nxënësve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi bazë** | **Arsimi i mesëm** | **Gjithsej** |
| 2017 - 2018 | 81026 | 319671 | 99457 | 500154 |
| 2018 - 2019 | 78942 | 306530 | 95359 | 480831 |
| 2019 - 2020 | 77858 | 294879 | 89869 | 462606 |
| 2020 - 2021 | 71332 | 286486 | 88965 | 446783 |
| 2021 - 2022 | 72384 | 278138 | 85188 | 435710 |




Nga të dhënat rezulton se numri i nxënësve në 5 vitet e fundit në të gjitha nivelet e arsimit ka ardhur në ulje. Në vitin shkollor 2021-2022 numri i nxënësve ishte rreth 13% më i ulët krahasuar me vitin shkollor 2017-2018.

**Tabela 3.** Numri i mësuesve sipas niveleve, në një hark kohor 5- vjeçar

| Numri i mësuesve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi bazë** | **Arsimi i mesëm** | **Gjithsej** |
| 2017 - 2018 | 4740 | 24790 | 7687 | 37217 |
| 2018 - 2019 | 4820 | 24712 | 7587 | 37119 |
| 2019 - 2020 | 5143 | 24370 | 7432 | 36945 |
| 2020 - 2021 | 5209 | 24443 | 7154 | 36806 |
| 2021 - 2022 | 5352 | 24400 | 7269 | 37021 |




Nga të dhënat 5-vjeçare rezulton se numri i mësuesve në arsimin parashkollor ka ardhur në ngritje ndërsa në arsimin bazë dhe të mesëm ky numër ka lëvizje të vogla.

**Tabela 4**. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesit ndihmës në shkollat e zakonshme, përgjatë një harku kohor 5- vjeçar

| Numri i nxënësve me AK | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi bazë** | **Arsimi i mesëm** | **Gjithsej** |
| 2017 - 2018 | 500 | 3446 | 456 | 4402 |
| 2018 - 2019 | 492 | 3664 | 530 | 4686 |
| 2019 - 2020 | 494 | 3550 | 529 | 4573 |
| 2020 - 2021 | 503 | 3580 | 589 | 4672 |
| 2021 - 2022 | 502 | 3750 | 516 | 4768 |

| Numri i mësuesve ndihmës | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Arsimi parashkollor** | **Arsimi bazë** | **Arsimi i mesëm** | **Gjithsej** |
| 2017 - 2018 | | 700 | - | 700 |
| 2018 - 2019 | | 926 | 18 | 944 |
| 2019 - 2020 | 74 | 971 | 24 | 1069 |
| 2020 - 2021 | 56 | 1089 | 31 | 1176 |
| 2021 - 2022 | 88 | 1260 | 60 | 1408 |




Nga të dhënat 5-vjeçare rezulton se numri i nxënësve me AK në arsimin bazë e të mesëm është me një rritje të lehtë, ndërsa numri i mësuesve ka një rritje të dukshme, gjë që tregon interesin e politik bërësve lidhur me integrimin e fëmijëve më aftësi të kufizuar.

**Tabela 5**. Të dhëna në progres që lidhen me numrin e klasave kolektive

| **Klasa gjithsej në vite dhe klasa kolektive** | | | |
|---|---|---|---|
| Viti arsimor | Klasa gjithsej | Klasa kolektive | Ne % |
| 2017-2018 | 18951 | 3210 | 16.9% |
| 2018-2019 | 14963 | 2685 | 17.9% |
| 2019-2020 | 14747 | 2618 | 17.8% |
| 2020-2021 | 14425 | 2517 | 17.4% |
| 2021-2022 | 14068 | 2558 | 18.2% |




Nga të dhënat 5-vjeçare rezulton se numri i klasave kolektive ka ardhur në ulje.

**Tabela 6**. Të dhëna në progres që lidhen me numrin e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive

| Nxënës gjithsej në vite dhe nxënës në klasa kolektive | | | |
|---|---|---|---|
| **Viti arsimor** | **Nxënës gjithsej** | **Nxënës në klasa kolektive** | **Në %** |
| 2017-2018 | 296736 | 33941 | 11.4% |
| 2018-2019 | 282906 | 25863 | 9.1% |
| 2019-2020 | 270113 | 23118 | 8.6% |
| 2020-2021 | 261780 | 21494 | 8.2% |
| 2021-2022 | 251207 | 22029 | 8.8% |




Nga të dhënat 5-vjeçare rezulton se numri i nxënësve që mësojnë në klasa kolektive ka ardhur në ulje.

**Tabela 7**. Të dhëna për raportin nxënës / klasë dhe nxënës / mësues në arsimin bazë

| Raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë - arsimi bazë | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **Raporti Nxënës/mësues** | **Raporti Nxënës/klasë** |
| 2017-2018 | 13.5 | 20.9 |
| 2018-2019 | 12.9 | 20.9 |
| 2019-2020 | 12.7 | 20.3 |
| 2020-2021 | 12.3 | 20.1 |
| 2021-2022 | 11.9 | 19.9 |




Nga të dhënat 5-vjeçare rezulton se raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në arsimin bazë ka ardhur në rënie gjë që tregon për rritjen e mundësive për një arsim më cilësor.

**Tabela 8**. Të dhëna për raportin nxënës / klasë dhe nxënës / mësues në gjimnaze

| **Raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë - gjimnaz** | | |
|---|---|---|
| **Viti** | **Raporti nxënës/mësues** | **Raporti nxënës/klasë** |
| 2018-2019 | 13.5 | 27 |
| 2019-2020 | 13.1 | 25.2 |
| 2020-2021 | 13.1 | 25.2 |
| 2021-2022 | 13.5 | 26.8 |




Nga të dhënat 4-vjeçare rezulton se raporti nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në arsimin e mesëm ka pasur qëndrueshmëri, ndërkohë që në vitin e fundit raporti nxënës/klasë është rritur.

**Tabela 9.** Të dhëna për numrin e fëmijëve jashtë shkolle (braktisja e shkollës)

| Arsimi Bazë | | | |
|---|---|---|---|
| **Viti shkollor** | **Gjithsej në %** | **Nx. në shtator** | **Braktisës** |
| 2017-2018 | 0.48 | 319671 | 1549 |
| 2018-2019 | 0.52 | 306530 | 1602 |
| 2019-2020 | 0.49 | 294879 | 1458 |
| 2020-2021 | 0.51 | 286486 | 1450 |
| 2021-2022 | 0.62 | 278138 | 1720 |

Nga të dhënat 5-vjeçare bie në sy se përqindja e nxënësve që kanë braktisur shkollën në arsimin bazë në vitin 2021-2022 ka pësuar një rritje me 0.11%.

**Tabela 10.** Institucionet e arsimit parauniversitar publik dhe privat për vitin 2021-2022

| Institucione Arsimore | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | **3,511** | **3,245** | **463** |
| Kopshte | 2,090 | 1,847 | 243 |
| Shkolla 9-vjeçare | 969 | 1,051 | 115 |
| Gjimnaze + Shkolla të arsimit të mesëm të orientuar | 448 | 343 | 105 |
| Gjimnaze me kohë të pjesshme | 4 | 4 | 0 |

Në arsimin publik dhe privat kemi 197 shkolla të bashkuara, të cilat përfshihen edhe tek numri i shkollave të arsimit bazë edhe tek numri i shkollave të arsimit të mesëm të lartë.



**Tabela 11.** Nxënës me aftësi të kufizuar mendore në Arsimin Parauniversitar 2021-2022

| Nxënës me aftësi të kufizuar mendore | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | **3,913** | **3,809** | **104** |
| Kopshte | 417 | 386 | 31 |
| Arsimi bazë | 3,178 | 3,118 | 60 |
| Nga të cilët në shkolla speciale | 460 | 460 | 0 |
| AML + Gjimnaze të orientuara | 318 | 305 | 13 |
| Gjimnaz | 239 | 226 | 13 |
| Gjimnaz me kohë të pjesshme | 63 | 63 | |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 16 | 16 | |

**Tabela 12.** Nxënës me aftësi të kufizuar fizike në Arsimin Parauniversitar 2021-2022

| Nxënës me aftësi të kufizuar fizike | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | **768** | **743** | **25** |
| Kopshte | **85** | **78** | **7** |
| Arsimi bazë | **546** | **532** | **14** |
| Shkolla speciale | 128 | 128 | 0 |
| AML + Gjimnaze të orientuara | **137** | **133** | **4** |
| Gjimnaz | 109 | 105 | 4 |
| Gjimnaz me kohë të pjesshme | 23 | 23 | |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 5 | 5 | |

Fëmijët me aftësi të kufizuar janë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e MAS-it. Infrastruktura ka ardhur gjithmonë në përmirësim, numri i klasave të veçanta si dhe numrin e mësuesve ndihmës ka ardhur në rritje.

**Tabela 13.** Mësues ndihmës në Arsimin Parauniversitar 2021-2022

| Mësues ndihmës | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | 1,515 | 1,408 | 107 |
| Kopshte | 177 | 88 | 89 |
| Arsimi bazë | 1,276 | 1,260 | 16 |
| Arsimi i mesëm | 62 | 60 | 2 |
| Gjimnaz | 61 | 59 | 2 |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 1 | 1 | 0 |




Numri i mësuesve ndihmës ka ardhur në rritje, si një përpjekje e MAS për të ndihmuar sa më shumë në integrimin e nxënësve me AK. Në vazhdimësi, ASCAP-i ka ofruar trajnime për këtë kategori mësuesish.

**Tabela 14.** Nxënës rom dhe egjiptian  në Arsimin Parauniversitar 2021-2022

| Nxënës rom | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | 4,338 | 4,274 | 64 |
| Kopshte | 690 | 674 | 16 |
| Arsimi bazë | 3,475 | 3,438 | 37 |
| Arsimi fillor | 2,357 | 2,334 | 23 |
| Arsimi i mesëm i ulët | 1,118 | 1,104 | 14 |
| AML + Gjimnaze të orientuara | 173 | 162 | 11 |
| Gjimnaz | 129 | 118 | 11 |
| Gjimnaz me kohë të pjesshme | 36 | 36 | |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 8 | 8 | |
| **Nxënës egjiptian** | **Total** | **Publik** | **Privat** |
| **Institucionet arsimore** | 9,997 | 9,846 | 151 |
| Kopshte | 1,694 | 1,664 | 30 |
| Arsimi bazë | 7,458 | 7,350 | 108 |
| Arsimi fillor | 4,266 | 4,203 | 63 |
| Arsimi i mesëm i ulët | 3,192 | 3,147 | 45 |
| AML + Gjimnaze te orientuara | 845 | 832 | 13 |
| Gjimnaz | 612 | 599 | 13 |
| Gjimnaz me kohë të pjesshme | 141 | 141 | |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 92 | 92 | |

Nxënësit rom dhe egjiptian janë të barabartë me të gjithë nxënësit e tjerë në arsimin bazë dhe të mesëm.

**Tabela 15.** Numri i psikologëve në vitin 2021-2022

| Psikologë | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | **625** | **459** | **166** |
| Kopshte | **92** | **44** | **48** |
| Arsimi Bazë | **345** | **285** | **60** |
| Arsimi i Mesëm | **188** | **130** | **58** |




**Tabela 16.** Numri i punonjësve social, në funksion të cilësisë së shërbimit psiko-social

| Punonjës social | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | **268** | **231** | **37** |
| Kopshte | 32 | 18 | 14 |
| Arsimi bazë | 163 | 149 | 14 |
| Arsimi i mesëm | 73 | 64 | 9 |



Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë marrë një vëmendje të shtuar me kalimin e viteve. Numri i shtuar i psikologëve dhe punonjësve social në sistem është shoqëruar dhe me rritjen e filtrave për tu punësuar si psikolog apo punonjës social, ku përfshihen ngritja e Urdhrit të Psikologut, praktika profesionale që duhet ndjekur para punësimit, si dhe provimi i licencës. Trajnimet që janë bërë nga ASCAP-i kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen profesionale të këtij shërbimi. Urdhri Nr. 313, datë 20.10.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social", ka ndikuar në rritjen e besueshmërisë për kandidatët që kërkojnë të bëhen pjesë e këtij shërbimi duke u punësuar në institucionet arsimore publike.

**Tabela 17.** Mësues në Arsimin Parauniversitar 2021-2022

| Mësues | Total | Publik | Privat |
|---|---|---|---|
| **Institucionet arsimore** | 37,021 | 31,956 | 5,065 |
| Kopshte | 5,352 | 4,398 | 954 |
| Arsimi bazë | 24,400 | 21,823 | 2,577 |
| Arsimi fillor | 9,668 | 8,564 | 1,104 |
| Arsimi i mesëm i ulët | 14,732 | 13,259 | 1,473 |
| AML + Gjimnaze të orientuara | 7,269 | 5,735 | 1,534 |
| Gjimnaz | 6,718 | 5,184 | 1,534 |
| Shkolla me drejtim të orientuar | 551 | 551 | 0 |




**Përmirësime në sistemin arsimor parauniversitar**

Gjatë viteve të fundit janë bërë disa përmirësime në sistem, si:

- Kuadri rregullator ka përcaktuar nivelet e diplomave për mësuesit e arsimit parauniversitar.
- Janë hartuar standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor për mësuesit në sistemin e arsimit parauniversitar.
- Me përfundimin e studimeve të larta të nivelit Master, nga mësuesi kërkohet të zhvillojë praktikën profesionale me kohëzgjatje 3 muaj, pas së cilës mund t'i nënshtrohet provimit të shtetit.
- Mësuesit e licensuar aplikojnë për punë nëpërmjet sistemit online të njohur si Portali "Mësues për Shqipërinë".
- Është krijuar portali i trajnimit të mësuesve, me prioritet aftësimi i tyre për kompetencën digjitale.

- Procesi i identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë bëhet çdo katër vjet dhe bazohet në standardet profesionale të mësuesit.
- Procesi i identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar.
- Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit dhe testin për profilin/ lëndën përkatëse.
- Janë hartuar standardet e performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave.
- Janë hartuar standardet profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.

Reforma e re kurrikulare përfshiu përgatitjen e një pakete të plotë kurrikulare për arsimin parauniversitar. Kjo paketë siguron koherencën vertikale dhe horizontale të kurrikulës për të tri nivelet e arsimit: arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.

Paketa kurrikulare për arsimin parauniversitar, për kurrikulën me bazë kompetencat, që përfshin:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.
- Kurrikulat bërthamë për nivelet 0-3:
  a) klasa përgatitore dhe arsimi fillor (I-V);
  b) arsimi i mesëm i ulët (VI-IX), dhe
  c) arsimi i mesëm i lartë (X-XII).
- Kornizën e vlerësimit të nxënësve, përfshirë nivelet e arritjeve të nxënësve për çdo shkallë të kurrikulës dhe fushë të nxëni/lëndë mësimore.
- Planin mësimor të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm si dhe planet mësimore për shkolla të veçanta (për klasat e shansit të dytë, për fëmijët e ngujuar, për shkollat speciale, për arsimin bazë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, për arsimin bazë me kohë të pjesshme, për pakicat kombëtare).
- Programe lëndore, të përgatitura për klasat dhe lëndët e arsimit bazë dhe lëndët e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të arsimit të mesëm.
- Programet orientuese të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (VANAF), të provimeve kombëtare të arsimit bazë (PKAB) dhe të maturës shtetërore (MSH).
- Udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat dhe udhëzues kurrikularë të përgjithshëm dhe lëndorë, për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.

**Jepen çdo vit raportet e vlerësimeve të rezultateve të nxënësve.**

- Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor - ZVAP.
- Rezultatet e vlerësimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë - ZVAP.
- Rezultatet e vlerësimit në maturën shtetërore - QSHA.

**Rezultatet e nxënësve shqiptarë në vite në testin PISA**

Shqipëria merr pjesë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) që nga viti 2000. Nxënësit shqiptarë kanë treguar nivel në rritje në tri gjitha fushat e testimit ndërkombëtar, veçanërisht në matematikë. Megjithatë rezultatet e nxënësve shqiptarë në vite mbeten akoma më të ulëta krahasuar me rezultatet mesatare të vendeve të OECD-së.

**Tabela 18.** Rezultatet e nxënësve shqiptarë në vite krahasuar me mesataren e OECD-së

| Fusha | 2000 | | 2009 | | 2012 | | 2015 | | 2018 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | AL | OECD | AL | OECD | AL | OECD | AL | OECD | AL | OECD |
| Lexim | 349 | *495* | 385 | *493* | 384 | *496* | 405 | 493 | 405 | *487* |
| Matematikë | 381 | *497* | 377 | *496* | 394 | *494* | 413 | 490 | 437 | *489* |
| Shkenca | 376 | *500* | 391 | *501* | 397 | *501* | 427 | 493 | 417 | *489* |

## 3. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 përcakton se vizioni i MAS për sektorin e arsimit synon ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale.

### 3.1. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU

**Formulat e vlerësimit**

**1. Vlerësimi i nivelit të realizimit të Masës**
M = (T1 + T2 + … + TN) / N shprehur në % dhe konvertuar në indeks zbatimi1-5
ku “M” është Masa dhe “T” është treguesi
*Mesatarja e nivelit të realizimit të treguesve*

**2. Vlerësimi i nivelit të realizimit të Produktit**
P= (M1 + M2 + … + MN) / N        ku “P” është  produkti
*Mesatarja e masave*

**3. Vlerësimi i nivelit të realizimit të Objektivit**
O = (P1+P2+…+ PN) / N  ku “O” është Objektivi
*Mesatarja produkteve*

**4. Vlerësimi i nivelit të realizimit të Qëllimit të Politikave**
Q = (O1 + O2 +… + ON) / N          ku “Q” është Qëllimi i Politikave
*Mesatarja e objektivave*

**5. Vlerësimi i Performancës së Sistemit**
Performanca = (Q1 + Q2) / 2
*Mesatarja e Qëllimit të Politikave*

**VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË RSH**

**Tabela  e vlerësimit**

| VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU- SË | | | |
|---|---|---|---|
| **PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR** | **VIZIONI** | **QËLLIMI I POLITIKËS** | **VLERËSIMI 1-5** |
| | Sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në BE. | **Qëllimi i politikës A** Arsimi parauniversitar | **3.70** |
| | | **Qëllimi i politikës B** Menaxhim i sistemit të arsimit parauniversitar | **4.05** |
| | **Vlerësimi i performancës së SAPU-së** | | **3.90** |




Gjatë vitit 2022, mbështetur në vizionin e MAS për sektorin e arsimit, në qëllimin e politikave arsimore, objektivat dhe rezultatet e pritshme, është realizuar një progres i dukshëm në zbatimin e masave të parashikuara në SKA 2021-2026. Mbështetur në objektivat strategjike, kornizën e vlerësimit të performancës dhe kriteret e vlerësimit, procesi i vlerësimit të performancës së SAPU ka evidentuar përparim të dukshëm në të gjitha nivelet e arsimit, sistemin arsimor parashkollor dhe parapërgatitor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm. Janë hedhur hapa të rëndësishëm në planifikimin në përputhje me objektivat e strategjisë, shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e donatorëve.

### 3.2. VLERËSIMI I QËLLIMIT TË POLITIKAVE

**QËLLIMI I POLITIKËS A: ARSIMI PARAUNIVERSITAR**

Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS A | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Qëllimi i politikës** | **Objektivi** | **Vlerësimi** |
| A | Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë | A.1. Aksesi në arsim | 3.25 |
| | | A.2. Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës | 4.1 |
| | | A.3. Mësuesit | 3.25 |
| | | A.4. Zotërimi i kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës | 4.1 |
| | | A.5. Digjitalizimi i arsimit | 3.8 |
| | **Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës A.** | | **3.7** |



**QËLLIMI I POLITIKËS B: MENAXHIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË**

**Menaxhim efektiv dhe eficent i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksional për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.**

Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë ndahet midis tri niveleve të ndryshme:

**1. Niveli qendror**

- Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (sot ASCAP).
- Institucioni përgjegjës për provimet kombëtare (sot QSHA).
- Institucionit përgjegjës qendror për garantimin e ofrimit të shërbimit cilësor, nëpërmjet vlerësimit dhe inspektimit (sot DPAP).

**2. Niveli rajonal/vendor**

Drejtoritë rajonale (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) në varësi të DPAP-së.

**3. Niveli i tretë**

Institucionet arsimore parauniversitare(shkollat dhe kopshtet)si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimit.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS B | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Qëllimi i politikës** | **Objektivi** | **Vlerësimi** |
| B | Menaxhim efektiv dhe efiçent i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionalë për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies | B.1. Niveli i shkollës | 4 |
| | | B.2. Niveli i sistemit | 4.1 |
| | **Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës B.** | | **4.05** |



## 3.3. VLERËSIMI IREALIZIMIT TËOBJEKTIVAVE

**OBJEKTIVI SPECIFIK A1: AKSESI NË ARSIM**
**Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë.**

**Përshkrim i objektivit**
Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton nxënës të ndryshëm dhe të veçantë që mësojnë së bashku në të njëjtën klasë, të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, pavarësisht ndryshimeve dhe sfidave të tyre. Gjithëpërfshirja është në qendër të politikave arsimore në Shqipëri, me synim rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme dhe pjesëmarrjes së fëmijëve nga grupet vulnerabël. MASR-ja, në vitin 2016, miratoi dokumentin "Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithpërfshirjen - Profili i mësuesit gjithëpërfshirës" me qëllim evidentimin e aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithsecili mësues, si ai që përgatitet t'i bashkohet radhëve të profesionit të mësuesisë, ashtu dhe ai që është në shërbim, si profesionist gjithëpërfshirës. Kjo ka bërë që edhe shoqëria të ndërgjegjësohet për nevojën e përfshirjes së fëmijëve nga grupet vulnerabël, gjë që ka sjellë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijëve nga pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane.
Edhe pse Shqipëria ka shkallë të lakmueshme të përfshirjes së fëmijëve të moshës 5 - 6 vjeç në arsimin parashkollor, si dhe të fëmijëve 6 -15 vjeç në arsimin bazë, me këtë strategji synohet që kjo përfshirje të jetë e plotë. Me "klasë përgatitore" nënkuptohen klasat për fëmijë të moshës 5 - 6 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor, të atashuara pranë shkollave të arsimit bazë, por edhe grupet e 3-ta në arsimin parashkollor, ku punohet me program të njëjtë. Po ashtu, synohet të rritet aksesi në arsimin parashkollor, për fëmijët e moshës 3 - 5 vjeç, si dhe në arsimin e mesëm të lartë, ku, përkundër pjesëmarrjes së lartë nga arsimi bazë, përfshirja është më e ulët se në vendet e tjera të rajonit për shkak të braktisjes. Në vëmendje të institucioneve arsimore do të jenë edhe fëmijët e huaj dhe emigrantët e kthyer që kanë akses në arsim, duke ofruar mundësinë e kurseve të gjuhës falas për emigrantët e kthyer dhe të huajt, të cilët do t'i ndihmonte në procesin e ri integrimit.

**Analiza e objektivit**
Gjithëpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dekadën e fundit, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël. Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore, është një ndër hapat e parë të synuar në SKA në kuadrin e realizimit të gjithëpërfshirjes në arsim, pavarësisht nga prejardhja, raca, seksi, besimi etj. Gjatë vitit 2021-2022 kanë qenë të regjistruar për këtë grup moshë 30838 fëmijë. Sipas DPAP-së, në shtator 2022, numri i regjistrimeve në klasat përgatitore dhe grupet e 3-ta të kopshteve nuk u arrit sipas planit të parashikuar, duke pësuar një rënie prej 4%. Për realizimin e këtij objektivi janë parashikuar disa hapa si: përmirësimi i infrastrukturës në kopshte dhe shkolla, hapja e klasave të reja për klasa parapërgatitore, rritja e nivelit të edukatoreve për zbatimin e kurrikulës nëpërmjet trajnimeve, përmirësimi i programeve, si dhe monitorimin dhe inspektimin e institucioneve arsimore parashkollore dhe cilësisë së shërbimit arsimor në klasat përgatitore.

Megjithëse këto objektiva nuk janë arritur, janë shënuar rezultate të rëndësishme në avancimin e cilësisë së arsimit parashkollor. Kështu, është hartuar kurrikula e re e arsimit parashkollor, që përfshin dokumentin e kornizës kurrikulare, standardet e zhvillimit dhe të nxënit, programet për secilën grup-moshë dhe kornizën e vlerësimit. Po ashtu, për herë të parë, janë hartuar standardet e zhvillimit dhe të nxënit për moshën 0–3 vjeç.

Gjatë viti shkollor 2021-2022, në institucionet arsimore bazuar në strategjitë dhe programet që ndihmojnë parandalimin e braktisjes së shkollës, janë hartuar plane konkrete ndërhyrjeje të cilat kanë përfshirë realizimin e aktiviteteve parandaluese, veprimtari ndërgjegjësuese me përfshirje të aktorëve shkollor.

Janë ngritur grupe pune për parandalimin e braktisjes që kanë evidentuar nxënësit të cilët rrezikojnë braktisjen për të vënë në dukje arsyen dhe shkaqet e këtij fenomeni dhe gjithashtu për të realizuar planin e veprimit për parandalimin e braktisjes. Grupet e punës kanë ndjekur të gjitha hapat për shmangien e braktisjes duke analizuar profilet e secilit nxënës në rrezik ose në rrezik të lartë braktisjeje.

**Vlerësimi i realizimit të objektivitA1**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT A1** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| A1 | Aksesi në arsim | A1.1. Rritja e aksesit në arsimin parashkollor | 3.75 |
| | | A1.2. Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar | 3 |
| | | A1.3. Racionalizimi i rrjetit të shkollave | 3 |
| | **Vlerësimi i realizimit të Objektivit A1** | | **3.25** |



**Konkluzione**

1. Janë hartuar dokumentet e reja për arsimin parashkollor që përfshijnë, kurrikulën e re, dokumentin e kornizës kurrrikulare, standardet e zhvillimi të të nxënit, korniza e vlerësimit.
2. Janë realizuar trajnime të vazhdueshme për të gjithë mësuesit dhe në veçanti për mësuesit ndihmës që punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta.
3. Në bashkëpunim me qeverisjen vendore janë ndërtuar institucione të reja parashkollore për të bërë të mundur krijimin e hapësirave të nevojshme për regjistrimin e të gjithë fëmijëve në kopshte.
4. Arsimin parashkollor ka akoma pjesëmarrje të ulët të fëmijëve, në raport me pritshmëritë;
5. Nuk është realizuar asnjë studim i brendshëm për rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë në edukimin në fëmijërinë e hershme.
6. Nuk ka filluar të zbatohet kuadri rregullator për ofrimin e transportit për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë.

**Rekomandime specifike**

- Të vijojë kualifikimi i mëtejshëm i mësuesve të zakonshëm dhe mësuesve ndihmës që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ofrojnë mbështetje për zhvillimin e PAI-ve;
- Të rritet shkalla e ndërgjegjësimit të prindërve nëpërmjet fushatave sensibilizuese për rëndësinë e arsimit parashkollor;
- Të realizohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë një studim i cili duhet të shoqërohet edhe me rekomandime për një bashkërendim më të mirë të veprimtarive midis institucioneve arsimore vendore dhe qeverisjen vendore, për avancimin e menaxhimit të përfshirjes në edukimin në fëmijërinë e hershme;

**OBJEKTIVI SPECIFIK A2: MJEDISI I SIGURT DHE MBËSHTETËS I SHKOLLËS**

**Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.**

**Përshkrimi i objektivit**

Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve është një nga prioritet e MAS në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar.Mirëqenia sociale, emocionale dhe fizike të nxënësve ndikon në uljen e braktisjes dhe u mundëson nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Në institucionet e arsimit parauniversitar për fëmijët me AK ofrohet mësuesi ndihmës. Rritja e numrit dhe zhvillimi profesional i tyre, janë në vëmendje të MAS-it për tu realizuar në 5 vitet në vazhdim. Ministria përgjegjëse për arsimin po zhvillon një protokoll gjithëpërfshirës për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës (fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin), homofobisë, bullizmit, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit në shkolla, duke ndjekur praktikat më të mira në rajon.

**Analiza e objektivit**

MAS-i është angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, por ende janë të nevojshëm hapa të rëndësishëm për pjesëmarrjen në arsim të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar. Shkollat ende nuk përmbushin të gjitha standardet e gjithëpërfshirjes, si infrastruktura dhe ambientet fizike apo pajisjet për fëmijët me aftësi të kufizuar. Përparësi po i jepet investimeve për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore bazuar në parimet e dizejnimit universal, të targetuar dhe të specializuar, duke konsideruar nevojat individuale të çdo nxënësi bazuar në parimet e modelit të hapësirave zhvillimore. MAS tashmë ka aprovuar standardet për projektimin e shkollave dhe kopshteve, të cilat shërbejnë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit dhe projektimit apo në rehabilitimin e godinave ekzistuese. MAS-i në bashkëpunim me institucionet arsimore ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në lidhje me rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar dhe numrit të mësuesve ndihmës. Në vitin shkollor 2021-2022 numri i mësuesve ndihmës është rritur me 20%. Gjithashtu, është ngritur një sistem mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë, me synim rritjen e aftësive profesionale të tyre. Mësuesit ndihmës janë përfshirë në rrjetet profesionale në mënyrë periodike, në seminare dhe trajnime të organizuara nga ASCAP, OJF të ndryshme në bashkëpunim me MAS. Ndërkohë, është miratuar i gjithë kuadri ligjor i nevojshëm për funksionimin e mësuesve ndihmës në institucionet arsimore. Por, pavarësisht përpjekjeve pozitive nga institucionet përgjegjëse, përsëri ka fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës shkollore jashtë dyerve të shkollës. Janë hedhur hapat e parë për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore duke hartuar bazën ligjore.

Me gjithë përpjekjet e bëra nga institucionet arsimore për mësimin e historisë/kulturës së romëve dhe/ose emigrantëve në shkolla, ka pak progres, kjo për arsye të burimeve njerëzore të kufizuara në ngritjen e kapaciteteve të mësuesve.

Në kuadër të integrimit dhe perspektivës gjinore në kurrikul, MAS-i në bashkëpunim me institucionet arsimore kanë përgatitur një material mbështetës për mësuesit në arsimin parauniversitar. Ka arritje të rëndësishme për sa i përket shtimit të numrit të shkollave Qendër Komunitare, si dhe janë bërë hapa domethënës në procesin e fuqizimit të rrjetit të këtyre shkollave. Gjithashtu, për të vazhduar nismën "Bëjmë detyrat e shtëpisë", MAS-i në bashkëpunim me institucionet arsimore ka hartuar një udhëzues të posaçëm për zbatim.

Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në sistemin e arsimit parauniversitar është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, ndërkohë që janë hartuar edhe dokumentet për standardizimin e punës së tyre. Krijimi i kabineteve psiko-sociale në të gjitha shkollat në funksion të përmirësimit të cilësisë të shërbimit psiko-social ka qenë një nga prioritet e MAS-it, i cili është realizuar pjesërisht. Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimi psiko-social për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, ka filluar në vitin 2022 dhedo të vazhdojë përgjatë periudhës 2023-2024. Në kuadër të konsolidimit të mjediseve të sigurta dhe miqësore për çdo fëmijë në shkollë, në institucionet arsimore ka mësues koordinator të dhunës dhe ekstremizmit dhe në ndihmë të tyre, ASCAP-i ka hartuar dhe publikuar udhëzuesin "Adresimi i antisemitizmit në shkollë".
Gjatë vitit 2022 janë ndërtuar 3 institucione arsimore në bashkitë Berat, Divjakë dhe Tropojë. Janë rikonstruktuar 22 institucione arsimore përkatësisht : 3 në bashkinë Elbasan, 2 në bashkinë Mat, 2 në bashkinë Lushnjë, 2 në bashkinë Pogradec dhe nga 1 institucion arsimor në bashkitë Patos, Dibër, Poliçan, Dimal, Roskovec, Devoll, Korçë, Kukës, Gjirokastër, Vau i Dejës, Selenicë dhe Sarandë.
Institucionet në varësi të MAS-it kanë hartuar paketat dhe modulet e trajnimit për menaxhimin e rrezikut në rast katastrofash, por nuk janë zhvilluar trajnime. Të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar hartojnë Plan Vjetor për "Reagimin në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore".

**Vlerësim i realizimit të objektivit A2**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT A2** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| A2 | Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës | A2.1. Sigurimi i arsimit cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabile | 3.2 |
| | | A2.2. Rritja e cilësisë së shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit | 4.1 |
| | | A2.3. Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë | 4.1 |
| | | A2.4. Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore | 5 |
| | | A2.5.Edukimi mbi reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore | 4.1 |
| | **Vlerësimi i realizimit të ObjektivitA2** | | **4.1** |




**Konkluzione**

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka rritur ndjeshëm numrin e mësuesve ndihmës në sistemin arsimor parauniversitar, duke krijuar edhe një sistem mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë, me synim rritjen e aftësive profesionale të tyre.
2. Ka nisur puna për identifikimin e shkollave për pajisjen me mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar, por hapat janë të ngadalshëm për sa i përket pajisjes së tyre me programe kompjuterike për fëmijët me vështirësi në shikim, në dëgjim dhe në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e, etj.
3. Institucionet arsimore kanë bërë përpjekje për regjistrimin e nxënësve nga grupet vulnerabël në arsimin parauniversitar por, përsëri ka fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës shkollore jashtë dyerve të shkollës. Ndërkohë, ka filluar përgatitja e bazës ligjore për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore.
4. MAS në bashkëpunim me institucionet arsimore kanë bërë arritje të rëndësishme për sa i përket shtimit të numrit të shkollave Qendër Komunitare, si dhe në fuqizimin e nismës"Bëjmë detyrat e shtëpisë", por është bërë pak progres në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të mësuesve për mësimin e historisë/kulturës së romëve dhe/ose emigrantëve në shkolla.
5. Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në sistemin e arsimit parauniversitar është rritur dhe janë hartuar dokumentet për standardizimin e punës së tyre, si dhe ka nisur puna për zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të shërbimi psiko-social, por ende nuk janë krijuar të gjitha kabinetet psiko-sociale.
6. MAS në bashkëpunim me ASCAP-in kanë hartuar udhëzuesin "Adresimi i antisemitizmit në shkollë", në kuadër të konsolidimit të mjediseve të sigurta dhe miqësore për çdo fëmijë në shkollë. Në institucionet arsimore parauniversitare ka mësues koordinator të dhunës dhe ekstremizmit, por nuk ka të dhëna për trajnimet me fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

7. Institucionet në varësi të MAS kanë hartuar paketat dhe modulet e trajnimit për menaxhimin e rrezikut në rast katastrofash dhe institucionet e arsimit parauniversitar hartojnë plan vjetor për “Reagimin në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore”.
8. Gjatë vitit 2022 janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 25 institucione arsimore në 20 bashki të vendit.

**Rekomandime specifike**

- Institucionet përgjegjëse të marrin masa për zbatimin e masave të SKA në lidhje me regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, romë dhe egjiptianë në shkollë.
- Institucionet përgjegjëse të marrin masa për pajisjen e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t’u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**OBJEKTIVI SPECIFIK A3: MËSUESIT**

**Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie.**

**Përshkrimi i objektivit**

Të gjitha hulumtimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktor përcaktues për arritjet e nxënësve. Strategjia Kombëtare e Arsimit i kushton vëmendje, si formimit fillestar të mësuesve, i cili zhvillohet në IAL, ashtu edhe zhvillimit profesional të vazhdueshëm. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ngritja e një sistemi të mirëfilltë të karrierës për mësuesit, mbështetur në vlerësimin e performancës së tyre në raport me plotësimin e standardeve profesionale.

**Analiza e objektivit**

Për rishikimin e përmbajtjes dhe organizimit të kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve, nga institucionet e arsimit të lartë janë ngritur grupe pune për të formuar mësues që janë në gjendje të zbatojnë kurrikulën bazuar në kompetenca. Sipas përcaktimeve në ligj, kurrikula e formimit fillestar të mësuesve përbëhet nga formimi i përgjithshëm psiko-pedagogjik dhe formimi shkencor i lëndës/profilit përkatës. Nga 14 grupet e punës të IAL-ve janë hartuar dhe dorëzuar në MAS raportet sipas profileve/lëndëve duke përcaktuar planet mësimore me lëndët, orët dhe kreditet përkatëse si dhe rezultatet e të nxënit për secilën lëndë.

ASCAP-i në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë për provimet ndërkombëtare ka hartuar dhe akredituar modulin e trajnimit "Zhvillimi i aftësive që kërkohen në provimin ndërkombëtar PISA, PIRLS dhe TIMSS". Lidhur me zhvillimin e aftësive të provimeve ndërkombëtare janë hartuar materialet e trajnimit për lëndët gjuhë shqipe edhe letërsi, matematikë, biologji, kimi e fizikë. Janë trajnuar 43 drejtues të rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave për DRAP-in Lezhë, si dhe do të vijojnë trajnimet sipas kalendarit 2022-2023 për DRAP Korçë, Fier dhe Durrës.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur dhe funksionojnë rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Fuqizimi i këtyre rrjeteve profesionale ka qenë në vëmendje të veçantë të punës së ASCAP-it në procesin e zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat. Për vitin shkollor 2021-2022, numri i rrjeteve profesionale dhe drejtuesve të tyre është 1250 dhe numri i anëtarëve të përfshirë në këto rrjete është 28044.

Për shtimin e mundësive për zhvillimin profesional të mësuesve është zhvilluar seminari mbarëkombëtar i përvitshëm me mësuesit e diasporës, ku nga viti 2019-2023 janë përfshirë 73 mësues në regjistrin shtetëror të diasporës. Regjistri synon krijimin e një databaze të saktë të arsimtarëve dhe nxënësve të diasporës, ku numri i tyre do të jetë në rritje nga viti në vit.

Përmirësimi i pozicionit të mësuesit parashikohet të arrihet nëpërmjet rritjes së pagave dhe sistemit të kualifikimit. Çdo vit, për ngritjen profesionale të mësuesve, ASCAP-i organizon procesin e kualifikimit të mësuesve në mbështetje të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM Nr. 194, datë 22.4.1999,"Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar".Në sistemin e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2021-222 paga mesatare bruto e mësuesve u rrit në masën 15% dhe për vitin shkollor 2022- 2023, paga mesatare bruto pësoi një rritje me 7%. Për ta përmirësuar në vazhdimësi pozicionin e mësuesit në shoqëri, deri në vitin 2025 pagat e mësuesve parashikohet të rriten deri me 40%.

**Vlerësimi i realizimit të objektivit A3**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT A3 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| A3 | Mësuesit | A3.1. Përmirësimi i cilësisë së programeve për formimin fillestar të mësuesve | 5 |
| | | A3.2. Shtimi i mundësive për zhvillimin profesional të mësuesve | 2.25 |
| | | A3.3. Përmirësimi i pozicionit të mësuesit nëpërmjet rritjes së pagave dhe sistemit të kualifikimit | 2.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të ObjektivitA3** | | **3.25** |




**Konkluzione**

1. Grupet e punës së IAL-ve të ngritura për përmirësimin e cilësisë së programeve për formimin fillestar të mësuesve kanë hartuar dhe dorëzuar në MAS raportet sipas profileve/lëndëve, duke përcaktuar planet mësimore me lëndët, orët dhe kreditet përkatëse si dhe rezultatet e të nxënit për secilën lëndë.
2. Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur dhe funksionojnë rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë.
3. Përmirësimi i pozicionit të mësuesit nuk është arritur nëpërmjet rritjes së pagave dhe sistemit të kualifikimit.

**Rekomandime specifike**

- Të shtohen mundësitë për zhvillimin profesional të mësuesve nëpërmjet funksionimit të rrjeteve profesionale.
- Të përmirësohet më tej pozicioni i mësuesit nëpërmjet sistemit të kualifikimit dhe rritjes së mëtejshme të pagave.

**OBJEKTIVI SPECIFIK A4: ZOTËRIMI I KOMPETENCAVE TË TË NXËNIT**
**Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë**

**Përshkrimi i objektivit**
Reforma kurrikulare ka në themel të saj aftësimin e nxënësve për jetën dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës. Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar vendos theksin në procesin e të nxënit dhe në rolin aktiv të nxënësve për zhvillimin e njohurive të reja. Në suksesin e këtij procesi luajnë rol cilësia e mësimdhënies - nxënies, teksteve dhe mjeteve mësimore, si dhe metodologjia e vlerësimit.
Përfitimi i kompetencave themelore i të menduarit, të komunikimit, të të shprehurit si dhe kompetencat qytetare lehtësohet kur eksperimentohen në kushte konkrete laboratorike apo nëse përdoren mjete mësimore didaktike. Hartimi i paketës minimale të mjeteve mësimore, shpërndarja e tyre nëpër institucionet arsimore sipas ZVAP-eve përkatëse, trajnimi i mësuesve me përdorimin e mjeteve dhe aparaturave mësimore të teknologjive të përparuara, janë disa nga detyrat themelore të parashtruara në SKA 2021-2026. Në mbështetje të institucioneve arsimore mbi zbatimin e kurrikulës me kompetenca në të gjithë përbërësit e saj,është parashikuar përmirësimi/hartimi i udhëzuesve për monitorimin e zbatimit të kurrikulës në nivel institucioni arsimor, si dhe në nivel lokal dhe qendror. Për të rritur rezultatet e nxënësve 15-vjeçar në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca, janë hartuar modulet e trajnimit për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës. Për njohjen e nivelit të arritjeve të nxënësve të sistemit arsimor kombëtar në tërësi dhe për të bërë krahasimin me arritjet vjetore të nxënësve, aplikohet vlerësimi i jashtëm i standardizuar ku përfshihen: Matura Shtetërore dhe Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, PKAB-së (provimi i lirimit).

**Analiza e objektivit**
Janë hartuar nga ASCAP 6 database me specifikimet teknike për pajisjet laboratorike në lëndët fizikë, kimi dhe biologji, për Arsim Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë,por mungojnë pajisjet për kurrikulat e tjera shkollore në ndihmë të zbatimit të procesit të mësimdhënies me kompetenca.
Për vitin shkollor 2021-2022janë pajisur vetëm 5 shkolla me mjete didaktike për zbatimin e mësimdhënies me bazë kompetencash, si dhe nuk është kryer trajnimi i mësuesve për përdorimin e bazës materiale. ASCAP-i ka hartuar udhëzues të cilët u vijnë në ndihmë institucioneve arsimore për të bërë vetëvlerësim të praktikave të veta si dhe institucioneve vlerësuese, si DPAP-së, ASCAP, DRAP-eve dhe ZVAP-eve për të kryer monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të institucioneve arsimore. Strukturat e institucioneve arsimore qendrore dhe vendore DRAP-et dhe ZVAP-et në përfundim të vitit 2022 janë ende të paplotësuara me organikën përkatëse (95%, ose 11 specialistë më pak nga numri i përcaktuar në organikë).
Janë trajnuar nga ASCAP-i 90 drejtues rrjetesh të profileve (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Biologji, Kimi, Fizikë). Është punuar për të përmirësuar cilësisë së provimeve bazuar në kompetenca në drejtim të administrimit, procedurave dhe zbatimin e masave për Maturën Shtetërore,PKAB-në dhe VANAF-it. Është bërë trajnimi i stafeve, të përgjegjësve të administrimit dhe administratorëve pjesëmarrës në provime, por procesi i Maturës Shtetërore ka nevojë ende për përmirësim. Në zbatim të Urdhrit nr. 127, datë 01.06.2021, "Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë për klasën e parë, në udhëzimin për fillimin e vitit shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar", u përcaktua si detyrë përfshirja për herë të parë

e gjuhës angleze në klasat e para dhe trajnimi i mësuesve përkatës. Për futjen e gjuhës angleze në klasë të parë gjatë vitit shkollor 2021-2022 u trajnuan nga ASCAP-i 646 mësues të gjuhës angleze të klasave të para. Në fillim të vitit shkollor 2022 u raportua nga DPAP-ja se rreth 29.000 nxënës së klasës 1-rë, ndjekin mësimin e gjuhës angleze, të shpërndarë mesatarisht në 1261 klasa.

Për futjen e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në arsimin bazë, në klasën e gjashtë, kjo masë ka filluar të zbatohet pjesërisht. Në zbatim të Urdhrit Nr. 127, datë 01.06.2021, "Për miratimin e planit mësimor për vitin e ri shkollor 2021-2022" u parashtrua edhe zbatimi i programit të modulit të ri të arteve, zejeve dhe sporteve. Referuar kërkesave të tregut të punës për punësimin e të rinjve në arsimin e mesëm të lartë e në varësi të interesave dhe të pasioneve të tyre, nxënësit do të kenë mundësi të zgjedhin nga një "menu" modulesh në zeje apo një lloj arti për të studiuar. Të mësuarit e zejeve dhe të arteve në arsimin e mesëm të lartë në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje. Gjatë vitit-2022, është punuar për identifikimin e burimeve dhe mundësive në shkolla për zhvillimin e programit kombëtar "Art, Zeje, Sport" në arsimin parauniversitar dhe është punuar nga grupi ndërministror për hartimin e kurrikulave sipas fushave nga ministritë e linjës.

**Vlerësimi i realizimit të objektivit A4**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT A4** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| A4 | Zotërimi i kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës. | A4.1. Pajisja e shkollave me mjete mësimore për zbatimin e kurrikulës me kompetenca dhe lënia në përdorim për 2 vite e teksteve shkollore në përdorim falas | 2.1 |
| | | A4.2. Mbështetje e vazhdueshme për mësuesit për zbatimin e kurrikulës | 4.6 |
| | | A4.3. Përmirësimi i aftësive të nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkencë | 4.5 |
| | | A4.4. Sigurimi i besueshmërisë së provimeve/vlerësimeve kombëtare | 3.5 |
| | | A4.5. Të mësuarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë | 5 |
| | | A4.6. Të mësuarit e zejeve, arteve dhe sporteve në arsimin parauniversitar | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të objektivit A4** | | **4.1** |




**Konkluzione**

1. Hartimi i paketës mësimore në ndihmë të zbatimit të procesit të mësimdhënies me kompetenca është kryer. Nuk është bërë trajnimi i mësuesve për përdorimin dhe mirëmbajtjen e paketave mësimore.
2. ASCAP-i ka hartuar udhëzues në ndihmë institucioneve arsimore për të bërë vetëvlerësim të praktikave të veta si dhe për institucionet vlerësuese, si DPAP-së, ASCAP, DRAP-eve dhe ZVAP-eve për të kryer monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm.
3. Strukturat e institucioneve arsimore qendrore dhe vendore DRAP-et dhe ZVAP-et në përfundim të vitit 2022 janë ende të paplotësuara me organikën përkatëse.
4. Është punuar për të përmirësuar cilësinë e administrimit për vlerësimin e jashtëm të shkollës dhe zbatimin e masave për Maturën Shtetërore, PKAB-në dhe VANAF-it. Është bërë trajnimi i stafeve, të përgjegjësve të administrimit dhe administratorëve të provimeve, por procesi i provimeve të Maturës Shtetërore ka ende vend për përmirësim.
5. Në kuadrin e fillimit të gjuhës angleze në klasë të parë, në vitin shkollor 2021-2022 u trajnuan nga ASCAP-i 646 mësues të gjuhës angleze të klasave të para. Në fillim të vitit shkollor 2022 rreth 29.000 nxënës së klasës parë, ndjekin mësimin e gjuhës angleze, të shpërndarë mesatarisht në 1261 klasa.
6. Gjatë vitit2022, është punuar për identifikimin e burimeve dhe mundësive në shkolla për zhvillimin e programit kombëtar “Art, Zeje, Sport” në arsimin parauniversitar dhe është punuar nga grupi ndërministror për hartimin e kurrikulave sipas fushave nga ministritë e linjës.
7. Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK-ut, miratuar me Urdhër të MAS Nr. 84 datë 06.05.2021, për miratimin e “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit”.

**Rekomandime specifike**

- Të hartohet paketa e plotë me mjete mësimore didaktike për të gjitha kurrikulat shkollore të Arsimit Bazë dhe të Arsimit të Mesëm të Lartë.
- Të mundësohet shpërndarja në shkolla e paketave me mjete mësimore didaktike për zbatimin e mësimdhënies me bazë kompetencash.
- Të bëhet trajnimi i mësuesve për përdorimin dhe mirëmbajtjen e paketave mësimore.
- Të mundësohet shërbimi wireless dhe aksesi në internet në funksion të plotë në të gjitha shkollat.
- Të ngrihen dhe funksionojnë klubet e nxënësve që do të angazhohen në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut.

**OBJEKTIVI SPECIFIK A5: DIGJITALIZIMI I ARSIMIT**

**Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.**

**Përshkrimi i objektivit**

Në koherencë të plotë me objektivat strategjike të kornizës "Edukimi & Trajnimi 2020" për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit profesional, në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 u vu theksi te kompetencat digjitale që duhet të përvetësojë nxënësi në arsimin parauniversitar. MAS-i duke u mbështetur në prirjet globale të arsimit sot, e ka vendosur integrimin e TIK-ut dhe digjitalizimin e arsimit si prioritet në strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar. Përmbushja e këtij qëllimi dikton në zhvillimin e njohurive dhe të aftësive digjitale të nxënësve dhe të mësuesve.

TIK ka ndikuar shumë në mënyrën e ofrimit të shërbimit arsimor, pasi ka potencialin t'u sigurojë nxënësve të mësuarin gjatë gjithë jetës, pjesëmarrjen e plotë në shoqëri dhe suksesin në jetën profesionale. Përmirësimi i infrastrukturës digjitale, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe i drejtuesve të shkollave, mirëmbajtja e pajisjeve etj, mbeten përparësi për të ardhmen. Për zhvillimin e kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie dhe në të nxënë, në programin e qeverisë një vend të rëndësishëm ka zënë digjitalizimi i arsimit, ku promovimi i aftësive digjitale te nxënësit, si dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie është një nga prioritet e këtij programi. Sfida është edhe për mësuesit. Përveç aftësive TIK të domosdoshme për jetën e përditshme, mësuesit kanë nevojë për kompetenca specifike digjitale që u mundësojnë atyre që ta përdorin teknologjinë për të mbështetur, përmirësuar dhe transformuar procesin e mësimdhënie-nxënies, si dhe për përgjegjësitë e tjera në shkollë.

**Analiza e objektivit**

Në funksion të zhvillimit të kompetencës digjitale janë hartuar dhe miratuar standardet profesionale të përdorimit të TIK-ut, miratuar me Urdhër Nr. 84 datë 06.05.2021, për miratimin e "Standartet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit" nga MAS-i. Dokumenti i standardeve profesionale është mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Mësuesve, DigComEdu, Kornizën e Kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3, UNESCO) si dhe në Rezolutën e Këshillit Evropian për kornizën strategjike 2021 - 2030. Është hartuar dhe publikuar nga ASCAP-i "Udhëzuesi për zbatimin e arsimit të kombinuar në institucionet arsimore parauniversitare" është hartuar dhe publikuar në 6-mujorin e parë të 2022. Lidhur me numrin e shkollave që kanë shërbim wireless kontrata për shërbimin e internetit në shkolla është bërë me AKSHI-n. Afati i kontratës ka qenë deri me 31-dhjetor 2022. Në këtë kontratë ishin të përfshirë 1200 shkolla dhe cilësia e internetit ka qenë e planifikuar nga 6-15 Gb, në varësi të zonës së shkollës dhe numrit të nxënësve të shkollë. Deri në fund të 2022 kanë marrë shërbim interneti nga AKSHI vetëm 1200 shkolla, nga 1618 shkolla në total. Ndërsa lidhur me investimet për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla, rezulton se ka përfunduar instalimi i rrjeteve wireless në 100 shkollat pilot në hapësirat e Smart Lab-ve për projektin pilot "Element IT", në përputhje me standardet. Janë ndërtuar 5 laboratorë të TIK-ut në 5 gjimnaze publike në kuadër të projektit "Inteligjenca Artificiale për të rinjtë" nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Gjithashtu, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka ndërtuar 8 laboratorë të TIK-ut për shkollat e arsimit bazë

sipas modelit pilot të 100 Smart labeve. Në kuadër të projektit “Qëndro” në bashkëpunim me MAS-in, AKSHI-in, Bankën Botërore dhe UNICEF-in janë ndërtuar 17 laboratorë TIK në shkolla për t’i dhënë mundësi nxënësve të mund të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe të mund të mësojnë nëpërmjet mësimit të kombinuar. Nuk ka të dhëna për ngritjen e klubeve të nxënësve të përfshirë në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut.

Janë rishikuar kurrikulat duke përfshirë edhe atë të TIK-ut në klasë të parë. Janë hartuar programet dhe planet mësimore të TIK-ut për klasën e parë dhe të dytë si dhe plani i implementimit për zgjerimin e iniciativës së kodimit edhe në 200 shkollat me mbështetjen e Bankës Botërore. Njëkohësisht është duke u mbështetur ASCAP-i në krijimin e një plani për zhvillimin profesional të mësuesve në nivele të ndryshme. Është përgatitur materiali për trajnimin e mësuesve dhe janë trajnuar 500 mësues të arsimit parashkollor si dhe 97 mësues të gjuhëve të huaja për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.

Nuk ka filluar  të pilotohet platforma "SELFIE".

Në kuadër të lancimit të nismës "Siguria në internet", ASCAP-i ka hartuar një manual për mësuesit lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin e mësuesve lidhur me  sfidat dhe rreziqet që përballen nxënësit në botën virtuale. Po kështu në programet lëndore të TIK-ut, klasa e parë janë të përfshira tema për sigurinë në internet. Programet mësimore aktuale të TIK-ut nga klasa IV-XII përmbajnë tematika dhe koncepte të cilat lidhen me sigurinë në internet, sigurinë kibernetike, qytetarinë digjitale dhe ndërveprimin në mjediset virtuale.

Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE), kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Është hartuar  programi i TIK-ut për klasën e parë  si dhe  materialet mbështetëse për zbatimin e programeve të klasës së parë. Për vitin 2022 në kuadër të projektit ‘Elementet IT” janë trajnuar 23 trajnerë  dhe 120 mësues që do të zhvillojnë TIK-un në klasat e para.

**Vlerësimi i realizimit të objektivit A5**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT A5 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| A5 | Digjitalizimi i arsimit | A5.1. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj | 3.5 |
| | | A5.2. Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit të shtuar të TIK-ut në të gjitha lëndët në të gjitha nivelet e arsimit duke filluar që nga klasa e parë e arsimit bazë | 4 |
| | | A5.3. Ofrimi i shërbimeve cilësore të TIK-ut për sistemin e arsimit parauniversitar | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të Objektivit A5** | | **3.8** |



**Konkluzione**

1. Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK, miratuar me Urdhër Nr. 84 datë 06.05.2021, për miratimin e “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit” nga MAS-i.
2. Lidhur me numrin e shkollave që kanë shërbim wireless deri në fund të 2022 kanë marrë shërbim internet nga AKSHI vetëm 1200 shkolla, nga 1618 shkolla në total.
3. Nuk është realizuar ngritja e klubeve të nxënësve të përfshirë në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut.
4. Është përgatitur materiali për trajnimin e mësuesve dhe janë trajnuar 500 mësues të arsimit parashkollor si dhe 97 mësues të gjuhëve të huaja për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.
5. Nuk ka filluar ende të pilotohet platforma "SELFIE”.
6. Është hartuar Programi i TIK-ut për klasën e parë si dhe materialet mbështetëse për zbatimin e tij. Sipas planifikimit kompetenca digjitale që në klasën e parë është aplikuar në 100 shkolla.

**Rekomandime specifike**

1. Të mundësohet që shërbim wireless dhe aksesi në internet të shtrihet dhe të jetë në funksion të plotë në të gjitha shkollat.
2. Të ngrihen dhe funksionojnë klubet e nxënësve që do të angazhohen në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut.
3. Të vijojë trajnimi i mësuesve në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe në të gjithë kurrikulat shkollore për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.
4. Të fillojë të pilotohet dhe zbatohet platforma "SELFIE, sipas planifikimit të detyrave të SKA-së.

**OBJEKTIVI SPECIFIK B1:Niveli i shkollës**

**Rritja e performancës së shkollës nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional dhe të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë, si një shkollë autonome.**

**Përshkrimi i objektivit**

Ky objektiv përqendrohet te menaxhimi dhe vlerësimi i shkollës si instrument për përmirësimin e performancës së saj. MAS-i ka planifikuar në SKA përmirësimin e profesionalizmit të drejtorëve duke përcaktuar standarde dhe duke ofruar programe certifikimi. Për të kontribuar në sigurimin e cilësisë, drejtuesi i shkollës duhet të kenë njohuri të thella për mësimdhënien dhe të nxënit, sepse është përgjegjës për vëzhgimin e mësuesve, bashkëpunimin me ta për përmirësimin e mësimdhënies, si dhe për ofrimin e mbështetjes për zhvillimin profesional të mësuesve. Sigurimi i cilësisë në nivel të shkollës, përfshin: vetëvlerësimin, vlerësimin e jashtëm, inspektimin, vlerësimin e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, si dhe vlerësimin e nxënësve.

Rritja e performancës së shkollës do të realizohet nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional, të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë, si një shkollë autonome.

**Analiza e objektivit**

Në vitin 2019 është ngritur Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), e cila është përgjegjëse për kornizën e vlerësimit të cilësisë dhe trajnimin e vlerësuesve të jashtëm si dhe është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) që bën vlerësime të jashtme nëpërmjet njësive të veta rajonale dhe ofron mbështetje për shkollat. Janë rritur kapacitetet inspektuese nëpërmjet trajnimeve të punonjësve të DPAP-së, DRAP-ve dhe ZVAP-ve, mësuesve si dhe ngritjes së rrjetit kombëtar të monitoruesve. Gjithashtu, është miratuar baza ligjore e nevojshme dhe ka filluar procesi i trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare nga AADF, ku janë certifikuar 440 drejtues. MAS-i ka nxjerrë dy udhëzime për emërimin e drejtuesve të shkollave përkatësisht Udhëzimin Nr. 24, datë 01.08.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 2, datë 28.01.2020" "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar i ndryshuar" si dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".

Në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucioneve arsimore, ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në kanë realizuar gjatë vitit 2022, 34 vlerësime të plota të IAP-ve publike dhe private. Janë vëzhguar dhe vlerësuar mbi 700 orë mësimore. Ndërkohë, që janë realizuar vlerësime të institucioneve arsimore për fushën "Drejtimi dhe menaxhimi i shkollës", proces i cili do të vijojë edhe gjatë vitit 2023. ASCAP-i ka filluar punën për hartimin e manualit të riskut, që përmban matricën e riskut dhe faktorët e riskut.

**Vlerësim i realizimit të objektivit B1**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT B1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| B1 | Niveli i shkollës | B1.1. Rritja e kapaciteteve inspektuese/monitoruese me fokus rritjen e cilësisë | 5 |
| | | B1.2. Përmirësimi i drejtimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore | 4.8 |
| | | B1.3. Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm janë në funksion të përmirësimit të shkollës | 2 |
| | **Vlerësimi i realizimit të ObjektivitB1** | | **4** |




**Konkluzione**

1. Në kuadër të menaxhimit efektiv dhe eficent të sistemit të arsimit është realizuar hartimi i kritereve dhe udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave dhe vlerësimi i tyre, si dhe trajnimi dhe certifikimi i drejtuesve dhe aspirantëve për drejtues nga AADF.
2. ASCAP-i, me synim rritjen e kapaciteteve inspektuese/monitoruese, për vitin 2022 ka ngritur rrjetin e vlerësuesve nëpërmjet trajnimit dhe certifikimit të tyre, duke tejkaluar vlerën e synuar. Në ndërkohë, ka filluar punën për kontrollin e cilësisë në bazë të riskut duke hartuar manualin e riskut, që përmban matricën e riskut dhe faktorët e riskut. Është realizuar vlerësimi i cilësisë së

drejtimit dhe menaxhimit të shkollës si dhe të vlerësimit të performancës së drejtuesve nga ASCAP-i.

3. Për të përmirësuar cilësinë e vlerësimit të institucioneve arsimore ASCAP-i ka hartuar paketën e vlerësimit të cilësisë. Në vitin 2022 janë zhvilluar trajnime me grupet e interesit në lidhje me paketën e vlerësimit të cilësisë, por nuk janë zhvilluar trajnime me stafet mësimore në lidhje me paketën e vlerësimit të cilësisë të institucioneve arsimore.
4. Nuk është realizuar asnjë tregues për sa i përket masës "Për një shkollë autonome, vendosja e prioriteteve në bashkëpunim me organizmat e shkollës dhe komunitetit për një planifikim afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës".

**Rekomandime specifike**

1. Institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa për zbatimin e masës "Rritja e performancës së shkollës nëpërmjet drejtimit dhe menaxhimit profesional dhe të përgjegjshëm dhe sigurimit të cilësisë, si një shkollë autonome".
2. Institucionet përgjegjëse të planifikojnë dhe të realizojnë trajnime për paketën e vlerësimit të cilësisë me mësuesit.

**OBJEKTIVI SPECIFIK B2: NIVELI I SISTEMIT**

**Garantimi i performancës së sistemit të arsimit nëpërmjet ndërtimit të një kornize gjithëpërfshirëse të vlerësimit dhe kapaciteteve për zbatimin e saj.**

**Përshkrimi i objektivit**

Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri realizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në mbështetje të VKM Nr.98, datë 27.2.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)". Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor ka dy qëllime kryesore: 1) Nxitjen e llogaridhënies së aktorëve të sistemit të arsimit për arritjen e objektivave të përcaktuar dhe; 2) Përmirësimin e politikave arsimore dhe rezultateve të sistemit të arsimit, duke shfrytëzuar informacionin për gjendjen e sistemit. Për ta realizuar këtë process ASCAP-i ka hartuar dokumentet orientuese të vlerësimit Manualin dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, të cilat janë miratuar me Urdhër të MAS Nr. 130, datë 16.02.2022. Në vijim, për vlerësimin e performancës së sistemit është hartuar dhe miratuar Pasaporta e Treguesve cila shërben si një instrument vlerësimi për performancën e sistemit arsimor. Kjo paketë treguesish e miratuar me Urdhër Nr. 172, datë 03.04.2023, është bazë për analizën e performancës së sistemit arsimor. Ajo përfshin tregues statistikorë të cilat janë gjeneruar dhe do të vijojnë të gjenerohen në të gjitha periudhat. Të dhënat statistikore e identifikojnë arsimin në nivel kombëtar dhe e bëjnë atë të krahasueshëm në nivel ndërkombëtar.

**Analiza e objektivit**

Vlerësimi vjetor i performancës së sistemit arsimor në Shqipëri, realizohet për herë të parë nga një institucion i brendshëm, pasi deri tani kemi pasur vetëm vlerësime të jashtme nga organizata ndërkombëtare. ASCAP-i nëpërmjet Drejtorisë së Performancës ka realizuar për herë të parë vlerësimin e performancës së sistemit arsimor bazur në Paketën e Treguesve dhe masat e parashikuara në SKA 2012-2026.

Për një vlerësim sa më objektiv të sistemit arsimor në Shqipëri, është realizuar plotësimi i Paketës së Treguesve Kombëtar të arsimit,nëpërmjet bashkëpunimit të grupeve të punës ngritur nga MAS, me pjesëmarrje nga Drejtoria e Performancës pranë ASCAP-it, DPAP-ja dhe INSTAT-i. Paketa e treguesve është konsultuar me eksperiencat ndërkombëtare si UNESCO, OECD, etj, duke mbajtur në konsideratë zbatimin e masave/veprimatrive të përfshira në SKA 2021 - 2026. Në ndërkohë, hartimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së SAPU-së, ka shërbyer si orientim për vlerësimin e çdo mase, produktet, objektivat të parashikuar në SKA 2021-2026. duke filluar nga masat, duke vijuar me produktet, objektivat dhe qëllimin e politikave dhe duke përfunduar me vlerësimin e përformancës së sistemit. Drejtoria e Performancës pranë ACAP-it, ka realizuar grumbullimin e të dhënave azuar në Paketën e Treguesve, ka kryer analizën për çdo masë/produkt/objektiv tëparashikuar në SKA 2021-2026 dhe, bazuar në përpunimin e të dhënave të grumbulluara, sipas metodologjisë së përcaktuar, ka realizuar vlerësimin performancës së sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri për vitin 2022.

Ndërkohë, sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) është baza e parë e të dhënave në Shqipëri që kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënit në nivelin qendror. Në këtë sistem është mundësuar krijimi i regjistrit dhe amzës digjitale e shkollës, në të cilat do të pasqyrohen të gjitha të dhënat dhe përditësimet njësoj si në dokumentet fizike. Në kuadër të krijimit të bazës së të

dhënave shtetërore të sistemit të Menaxhimit të Informacionit Paraniversitar SMIP, grupi i punës pranë ASCAP-it ka bërë të mundur shqyrtimin e të gjithë planeve mësimore për të gjitha ciklet dhe nivelet arsimore që aplikohen në sistemin arsimor. Aktualisht në sistem janë të implementuara të gjithë planet mësimore të cilat zbatohen në institucionet arsimore publike (20 plane mësimore). Në vijim të procesit të popullimit të sistemit SMIP me të gjithë llojet e kurrikulave që aplikohen ne sistemin arsimor parauniversitar, ASCAP ka rishikuar 224 plane mësimore të shkollave jopublike si dhe ka dhënë sugjerime lidhur me strukturimin dhe riorganizimin e planeve mësimore si dhe miratimin e tyre nga ministria e arsimit.
Gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuese,Drejtoria e Performancës pranë ASCAP-it, ka hasur disa vështirësi që lidhen raportimin e strukturave të veçanta, përgjegjëse për realizimin e disa masave të parashikuara në SKA.

**Konkluzione**

1. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), është implemetuar dhe po shtrihet në të gjithë shkollat e vendit. Vlen për tu theksuar se ky sistem kërkon module shtesë për të bërë të mundur mbledhjen e të dhënave statistikore sipas paketës së treguesve kombëtar të miratuar nga MAS.
2. Është plotësuar Paketa e Treguesve Kombëtar si një dokument i rëndësishmë që ndihmon në vlerësimin e përshkallëzuar të masave/produkteve/objektivave të SKA-së.
3. Drejtoria e Performancës ka hartuar dokumentet e vlerësimit, Manualin dhe Metodologjinë përkatëse, për vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit të bazuar në paketën e treguesve kombëtarë të arsimit dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.
4. Drejtoria e Performancës ka hasur vështirësi gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave nga institucionet përgjegjëse/kontribuese, ku ka pasur vonesa në raportime.

**Rekomandime specifike**

- Përfshirja e moduleve shtesë te Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), për të bërë të mundur grumbullimin e të dhënave statistikore sipas paketës së treguesve kombëtar të miratuar nga MAS, për një vlerësim sa më efektiv të performancës së sistemit arsimor.
- Rishikimi i disa masave apo produkteve të SKA 2021-2026 do të ishte i nevojshëm pasi nuk ka instrumenta apo tregues për të vlerësuar saktë realizimin e tyre.
- Të rritet niveli i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, ose kontribuese dhe Drejtorisë së Performancës pranë ASCAP-it lidhur me procesin e grumbullimit të të dhënave.
- Institucionet arsimore të bëjnë planifikime vjetore dhe raportime bazuar në parashikimet dhe objektivat e SKA 2021-2026.
- Insitutucionet administrative të Arsimit Parauniveristar të raportojnë në kohë dhe me cilësi, lidhur me realizimin e planeve vjetore në përputhje me objektivat e SKA-së.

**Vlerësim i realizimit të objektivit B2**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT B.2 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Objektivi** | **Produkti** | **Vlerësimi** |
| B2 | Niveli i sistemit | B2.1. Funksionalizimi i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) | 4.5 |
| | | B2.3. Përcaktimi i treguesve kombëtarë të arsimit | 3 |
| | | B2.4. Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësimin e performancës së sistemit | 4.75 |
| | **Vlerësimi i realizimit të ObjektivitB2** | | **4.1** |



## 4. VLERËSIMI TEKNIK I REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE

**Objektivi specifik A1**: Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë.
**Objektivi specifik A2:** Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
**Objektivi specifik A3:** Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie.
**Objektivi specifik A4:**Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë.
**Objektivi specifik A5:** Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë.

### 4.1. OBJEKTIVI SPECIFIK A1: AKSESI NË ARSIM

**Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe rritja e aksesit në arsimin parashkollor dhe në arsimin e mesëm të lartë.**

#### PRODUKTI A1.1 RRITJA E AKSESIT NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

**Masa A1.1.1 Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor**
Ndërgjegjësimi i prindërve është parashikuar të bëhet nëpërmjet veprimtarive ndërgjegjësuese të mirë planifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore. Po ashtu, do të mbështeten aktivitetet e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

**Treguesi**
**Numri i veprimtarive/aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara**

**Analiza e masës**
Gjatë vitit shkollor 2021-2022 janë hapur 283 klasa përgatitore dhe 668 grupe të treta pranë kopshteve. Zyrat vendore arsimore çdo fund viti shkollor në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë numrin e fëmijëve në moshë shkollore dhe në rastet e nevojshme me nivel rrisku organizohen me grupet e interesit, si mësues, punonjës të shërbimit psiko-social, prindër apo përfaqësues të qeverisjes vendore takime dhe seminare informuese/ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e arsimit. Ky tregues përkthehet si "fuqizim i klasave përgatitore në shkollat e arsimit publik". Niveli i zbatimit është i kënaqshëm pasi realizimi është në masën 70%. Gjithashtu nga ana e ASCAP-it në bashkëpunim me UNICEF-in është krijuar një platformë online - bebbo.al, ku prindërit të kenë mundësi për të marrë informacionet e nevojshme për vendndodhjen, kushtet, aktivitetet etj, të institucioneve arsimore parashkollore.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A1.1.1** | Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor | Numri i veprimtarive/aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara | **70%** | **3.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A1.1.1** | | **70%** | |

**Masa A1.1.2 Avancimi i koordinimit ndërmjet MAS, MSHMS-së dhe njësive të vetëqeverisje vendore duke rivlerësuar gjithë sistemin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për edukimin në fëmijërinë e hershme, bazuar në evidenca dhe studime.**

Masa përfshin një studim që parashikohet të realizohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të Qeverisë dhe pritet të ofrojë rekomandime për një bashkërendim më të mirë të veprimtarive midis ministrive përgjegjëse për edukimin parashkollor dhe qeverisjen vendore, për avancimin e menaxhimit të këtij sektori.

**Treguesi**

**Përqindja e fëmijëve nga mosha 3-6 vjeç të përfshirë në edukimin në fëmijërinë e hershme**

Ky tregues vlerëson direkt numrin e të regjistruarve në kopshte dhe në klasat përgatitore në raport me popullsinë e grup-moshës 5 vjeç.

**Analiza e masës**

Nuk janë bërë ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për edukimin e fëmijëve në moshë të hershme. Nuk është realizuar studimi i parashikuar për këtë masë.

**Niveli i zbatimit**

Nuk ka të dhëna për realizimin e kësaj mase.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.1.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A1.1.2** | Avancimi i koordinimit ndërmjet MAS, MSHMS-së dhe njësive të vetëqeverisje vendore duke rivlerësuar gjithë sistemin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për edukimin në fëmijërinë e hershme, bazuar në evidenca dhe studime | Përqindja e fëmijëve nga mosha 3-6 vjeç të përfshirë në edukimin në fëmijërinë e hershme | - | - |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A1.1.2** | | - | |

**Masa A1.1.3 Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore.**

Në pesë vitet e ardhshme do të krijohen kushtet që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç të ndjekin arsimin parashkollor në grupet e 3-ta në kopshte, ose në klasa përgatitore.

**Treguesi**

Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve 5-6 vjeç në klasat përgatitore dhe grupet e 3-ta të kopshteve.
Ky tregues vlerëson direkt përfshirjen e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore.

**Analiza e masës**

Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore, është një ndër hapat e parë të synuar në SKA në kuadrin e realizimit të gjithëpërfshirjes në arsim, pavarësisht nga prejardhja, raca, seksi, besimi etj. Për realizimin e kësaj mase janë parashikuar disa hapa si: përmirësimi i infrastrukturës në kopshte dhe shkolla, hapja e klasave të reja parapërgatitore, rritja e nivelit të edukatoreve për zbatimin e kurrikulës nëpërmjet trajnimeve, përmirësimi i programeve, si dhe monitorimi dhe inspektimi i institucioneve arsimore parashkollore.
Gjatë vitit 2021-2022 kanë qenë të regjistruar për këtë grup moshë 30838 fëmijë. Në shtator 2022, numri i regjistrimeve në klasat përgatitore dhe grupet e 3-ta të kopshteve nuk u arrit sipas planit të parashikuar, duke pësuar një rënie prej 4%.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar në nivelin 80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.1.3 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A1.1.3** | Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore | Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve 5-6 vjeç në klasat përgatitore dhe grupet e 3-ta të kopshteve, sipas gjinisë | **80%** | **4** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A1.1.3** | | **80%** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT**

**Produkti A1.1. Rritja e aksesit në arsimin parashkollor**

**Përshkrimi i produktit**
Vihet re se nga viti në vit kemi një përqindje më të lartë të fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor. Kjo vjen për disa arsye si: përmirësimi i infrastrukturës arsimore, përgatitja me trajnime apo programe më të mira për personelin mësimor, etj.

**Analiza e produktit**
Ky produkt konsiderohet pjesërisht i realizuar. Kërkohet më shumë angazhim nga ana institucioneve përgjegjëse për të ndërmarrë hapa konkret në përmbushjen e parashikimeve të përcaktuara në SKA. Zyrat arsimore vendore duhet të bashkëpunojnë edhe më shumë me organet e vetëqeverisjes vendore për të bërë të mundur pjesëmarrjen e sa më shumë fëmijëve në arsimin parashkollor.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A1.1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A1.1** | Rritja e aksesit në arsimin parashkollor | Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor | 3.5 |
| | | Avancimi i koordinimit ndërmjet MAS, MSHMS-së dhe njësive të vetëqeverisje vendore duke rivlerësuar gjithë sistemin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për edukimin në fëmijërinë e hershme, bazuar në evidenca dhe studime | - |
| | | Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A1.1** | | **3.75** |



**PRODUKTI A1.2. RRITJA E PJESËMARRJES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**Masa A1.2.1 Krijimi i sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë**.
SKA 2021-2026 synon që në institucionet e arsimit bazë dhe në ZVAP të krijohen grupe për parandalim dhe reagim ndaj mos regjistrimit në klasën e parë dhe braktisjes, të përbëra nga mësuesit, përfaqësuesit e komunitetit të prindërve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Parashikohet të hartohen plane veçanta pune për këto grupe dhe do të ndërtohet një sistem raportimi për rastet e mos regjistrimit dhe braktisjes së shkollimit. Do të vijojë mbështetja me bursë nga shteti për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por që, në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.

**Treguesi 1**
**Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 1**
Ky tregues vlerëson direkt numrin e fëmijëve të grup-moshës 6 - 10 që nuk janë të regjistruar në shkollë duke na dhënë mundësi për të marrë masat e nevojshme për të krijuar një sistem për parandalimin ndaj mos regjistrimit në shkollë.
Synimi ka qenë që niveli i mos regjistrimit të nxënësve të bjerë në 0.47%, ndërkohë realizimi është 0.61%, pra vazhdojnë të mos regjistrohen ende fëmijë në klasë të parë. Ky numër është në rritje edhe nga viti i kaluar 2020 - 2021.
Nëse në vitin 2020-2021 kanë qenë 1450 nxënës nga 286486 gjithsej, në vitin 2021-2022 rezultojnë 1720 nxënës nga 278138 nxënës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

**Treguesi 2**
**Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 2**
Ky tregues vlerëson direkt numrin e fëmijëve të grup-moshës 11 - 14 vjeç që nuk janë të regjistruar në shkollë duke na dhënë mundësi për të marrë masat e nevojshme për të krijuar një sistem për parandalimin ndaj mos regjistrimit në shkollë.
Synimi ka qenë që niveli i mos regjistrimit të nxënësve të bjerë në 0.53%, ndërkohë realizimi është 0.54% dhe si rrjedhojë treguesi konsiderohet i realizuar. Kjo tregon se kemi një vazhdimësi të nxënësve që e nisin ciklin e parë të arsimit parauniversitar klasa 1-5 për ta vazhduar edhe ciklin e dytë 6-9, vihet re braktisje shumë e vogël e kësaj kategorie.

**Treguesi 3**
**Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 3**
Ky tregues vlerëson direkt numrin e fëmijëve të grup-moshës 15 - 17 që nuk janë të regjistruar në shkollë duke na dhënë mundësi për të marrë masat e nevojshme për të krijuar një sistem për parandalimin ndaj mos regjistrimit në shkollë.
Synimi ka qenë në shifrën 1.51% e nxënësve, ndërkohë realizimi është 3.26%, duke na treguar se ende vazhdojnë të mos regjistrohen një numër i madh fëmijësh në klasë të dhjetë ose viti i parë gjimnaz.

**Treguesi 4**
**Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e pestë**
Ky tregues jep numrin e të regjistruarve në klasën e pestë në raport me popullsinë e grup-moshës 10 vjeç.
Nuk ka të dhëna për këtë tregues.

**Treguesi 5**
**Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e nëntë**
Ky tregues jep numrin e të regjistruarve në klasën e nëntë në raport me popullsinë e grup-moshës 14 vjeç.
Nuk ka të dhëna për këtë tregues.

**Treguesi 6**
**Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 1**
Ky tregues jep përqindjen e fëmijëve të regjistruar në nivelin ISCED 1 që janë të paktën dy vjet më të mëdhenj se grup-mosha për klasën përkatëse.
Nuk ka të dhëna për këtë tregues.

**Treguesi 7**
**Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 2**
Ky tregues jep përqindjen e fëmijëve të regjistruar në nivelin ISCED 2 që janë të paktën dy vjet më të mëdhenj se grup-mosha për klasën përkatëse. Treguesi është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor dhe është tregues i përdorur në SKA
Nuk ka të dhëna për këtë tregues.

**Analiza e masës**
Gjatë viti shkollor 2021-2022, në institucionet arsimore bazuar në strategjitë dhe programet që ndihmojnë parandalimin e braktisjes së shkollës, janë hartuar plane konkrete ndërhyrjeje për realizimin e aktiviteteve parandaluese, veprimtari ndërgjegjësuese me përfshirje të aktorëve shkollor. Janë ngritur grupe pune për parandalimin e braktisjes që kanë evidentuar nxënësit të cilët rrezikojnë braktisjen për të vënë në dukje arsyen dhe shkaqet e këtij fenomeni dhe gjithashtu për të realizuar Planin e Veprimit të SKA-së për parandalimin e braktisjes.
Grupet e punës kanë ndjekur të gjitha hapat për shmangien e braktisjes duke analizuar profilet e secilit nxënës në rrezik, ose në rrezik të lartë, braktisjeje. Për rastet e evidentuara me tendencë braktisjeje mësuesi kujdestar dhe punonjësi i shërbimit psiko-social kanë realizuar seanca konsultimi me prindërit e fëmijës ose kujdestarin e tij ligjor, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e frekuentimit të rregullt të shkollës dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme bazuar në mundësitë e familjes. Institucionet arsimore, kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve duke marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta në takime me Grupin Teknik Ndërsektorial me qëllim menaxhimin e rasteve në risk braktisjeje apo braktisës.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A1.2.1** | Krijimi i sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mos regjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë | Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 1 | 60% | 3.5 |
| | | Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 2 | 100% | |
| | | Përqindja e fëmijëve jashtë shkolle - niveli ISCED 3 | 50% | |
| | | Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e pestë | - | |
| | | Raporti bruto i regjistrimeve në klasën e nëntë | - | |
| | | Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 1 | **-** | |
| | | Përqindja e fëmijëve të moshës më të madhe për klasën përkatëse - niveli ISCED 2 | **-** | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A1.2.1** | | 70% | |

**Masa A1.2.2 Ofrimi i transportit edhe për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë në nevojë që plotësojnë kriteret e përcaktuara**.

Nxënësve të këtij niveli që plotësojnë kritere të caktuara, do t'u ofrohet transporti falas, me qëllim që të rritet pjesëmarrja në arsimin e mesëm të lartë. Besohet se një masë e tillë do të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes së vajzave nga zonat rurale në arsimin e mesëm të lartë.

**Treguesi**

**Numri i nxënësve në nevojë në arsimin e mesëm të lartë që e kanë përfituar këtë shërbim.**

Ky tregues jep numri e nxënësve në nevojë në arsimin e mesëm të lartë që përfitojnë shërbim transporti falas.

**Analiza e masës**

Institucionet kanë punuar për ndryshimet ligjore për të bërë të mundur realizimin e kësaj mase për vitin shkollor 2023 - 2024.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë vlerësohet në nivelin 50%.

**Tabela e vlerësimit**

<table>
<tr><th colspan="5">VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.2.2</th></tr>
<tr><th>Nr.</th><th>Masa/Veprimtaria</th><th>Treguesit e matjes</th><th>Realizimi %</th><th>Vlerësimi 1-5</th></tr>
<tr><td rowspan="2">A1.2.2</td><td>Ofrimi i transportit edhe për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë në nevojë që plotësojnë kriteret e përcaktuara</td><td>Numri i nxënësve në nevojë në arsimin e mesëm të lartë që e kanë përfituar shërbimin e transportit</td><td>50%</td><td rowspan="2">2.5</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i realizimit të masës A1.2.2</td><td>50%</td></tr>
</table>

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A1.2**

**Përshkrimi i produktit**

Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar dhe ulja e braktisjes mbeten dy nga sfidat më të mëdha të sistemit arsimor. Edhe pse janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, mbetet ende shumë punë për të bërë. Synohet ofrimi i transportit të nxënësve në arsimin e mesëm me qëllim që të reduktohet numri i fëmijëve që nuk shkojnë në gjimnaz për arsye të mos sigurimit të transportit.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

Ky produkt konsiderohet i realizuar pjesërisht dhe merr vlerësimin 2.5. Mbetet ende problem mos regjistrimi kryesisht në zona të thella, braktisja shkollore për fëmijët 6-14 vjeç si dhe mos vijimi i gjimnazit për grup moshat 15-18 vjeç.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A1.2 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A1.2** | Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar | Krijimi i sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mos regjistrimit në shkollë dhe braktisjes së nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë | 3.5 |
| | | Ofrimi i transportit edhe për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë në nevojë që plotësojnë kriteret e përcaktuara | 2.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A1.2** | | **3** |



**PRODUKTI A1.3. RACIONALIZIMI I RRJETIT TË SHKOLLAVE**

**Masa A1.3.1Pakësimi i numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive.**
Për uljen e numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive, do të vazhdohet me realizimin e planit për transferimin e nxënësve nga klasat kolektive në shkolla ku mund të arsimohen në klasa normale. Vendimet do të merren në bazë të projeksioneve demografike dhe mundësive për sigurimin e transportit deri në shkollën tjetër. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet sensibilizimit të prindërve dhe komunitetit për këtë proces, duke bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me organizatat e shoqërisë civile.

**Treguesi**
**Numri i nxënësve në klasa kolektive të transferuar në shkollat e afërta me cilësi më të mirë.**
Ky tregues jep numrin e nxënësve në klasa kolektive të transferuar në shkollat e afërta me cilësi më të mirë. Treguesi nuk është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor, është tregues i përdorur në SKA.

**Analiza e masës**
Klasat kolektive, apo të bashkuara janë klasat në të cilat mësojnë nxënësit e dy apo më shumë klasave të arsimit fillor ose të arsimit të mesëm të ulët. Shkollat me klasat kolektive ndodhen kryesisht në zona të thella malore dhe në ato raste kur numri i nxënësve në klasë është më i vogël se numri i nxënësve që duhet të ketë klasa sipas Udhëzimit të MASR Nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar kanë kontaktuar me grupet e interesit, komunitetin dhe pushtetin vendor për mundësitë reale për përqendrimin e shkollave. Referuar vendndodhjes së shkollave me klasa të bashkuara, të shkollave më të afërta, largësisë midis tyre, gjendjes së rrugëve dhe mundësitë për shfrytëzimin e tyre në të gjitha periudhat e vitit, transportit, moshës së nxënësve (kryesisht të arsimit fillor), për vitin shkollor 2022-2023 mendohet të përqendrohen 68 shkolla (4 shkolla qendër dhe 64 shkolla vartëse).Gjatë vitit shkollor 2021-2022 kanë qenë 1112 institucione arsimore me klasa kolektive (304 shkolla qendër dhe 808 shkolla vartëse). Synimi ka qenë që 10% të tyre të mbyllen dhe nxënësit të kalojnë në shkollat më të afërta me vendbanimin, por këmbëngulja e prindërve dhe vështirësitë e sigurimit të transportit e kanë bërë të pamundur realizimin e plotë të kësaj mase.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar në nivelin 60%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A1.3.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A1.3.1** | Pakësimi i numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive | Numri i nxënësve në klasa kolektive të transferuar në shkollat e afërta me cilësi më të mirë | **60%** | **3** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A1.3.1** | | **60%** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A1.3**

**Përshkrimi i produktit**

Shkollat me klasat kolektive ndodhen kryesisht në zona të thella malore, si dhe në ato raste kur numri i nxënësve në klasë është më i vogël se numri i nxënësve që duhet të hapet klasa, sipas Udhëzimit të MASR Nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar. Gjatë vitit shkollor 2021-2022 kanë qenë 1112 institucione arsimore me klasa kolektive apo të bashkuara (304 shkolla qendër dhe 808 shkolla vartëse). ZVAP-të kanë kontaktuar me grupet e interesit, komunitetin dhe pushtetin vendor për mundësitë reale për përqendrimin e shkollave. Referuar vendndodhjes së shkollave me klasa të bashkuara, të shkollave më të afërta, largësisë midis tyre, gjendjes së rrugëve dhe mundësitë për shfrytëzimin e tyre në të gjitha periudhat e vitit, transportit, moshës së nxënësve (kryesisht të arsimit fillor), për vitin shkollor 2022-2023 mendohet të përqendrohen 68 shkolla.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

Ky produkt konsiderohet i realizuar në masën 60%. Distanca e largët me shkollën më të afërt dhe mungesa e transportit janë arsyet kryesore të mosrealizimit të këtij produkti, i cili synon zvogëlim të numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A1.3 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A1.3** | **Racionalizimi i rrjetit të shkollave** | Pakësimi i numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive | 3 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A1.3** | | **3** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK A2: MJEDISI I SIGURT DHE MBËSHTETËS I SHKOLLËS**
Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

**PRODUKTI A2.1 SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR PËR FËMIJËT NGA GRUPET VULNERABILE**

**Masa A2.1.1 Sigurimi i mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara.**
Parashikohet të rritet numri i mësuesve ndihmës në rajone ku numri i nxënësve me aftësi të kufizuara për mësues është më i lartë, siç janë Tirana, Durrësi dhe Kamza, duke siguruar një raport 2-3 nxënës me aftësi të kufizuara për një mësues ndihmës.

**Treguesi 1**
**Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parauniversitar.**
Ky tregues jep numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në nivelet ISCED 0-3, në shkolla normale dhe speciale.

**Treguesi 2**
**Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike.**
Ky tregues jep numrin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike.

**Analiza e masës**
Pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në moshë shkollore në arsimin parauniversitar është shtuar nga viti në vit. Në vitin shkollor 2019-2020, në shkollat e zakonshme kanë qenë të regjistruar 4573 fëmijë, ndërkohë që për vitin 2020-2021 ky numër ishte 4,672, ndërsa për vitin 2021-2022 ka qenë 4,786 fëmijë. Pavarësisht përpjekjeve pozitive nga institucionet përgjegjëse, regjistrimi i fëmijëve me AK në moshë shkollore në arsimin parauniversitar është sërish nën numrin total të fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës shkollore. Në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuar në institucionet arsimore janë hapur 54 klasa burimore për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuar me qëllim zhvillimin e potencialeve dhe rritjen akademike të tyre. Institucionet e arsimit parauniversitar janë përpjekur për të krijuar akses për të gjithë fëmijët e evidentuar duke u garantuar edhe mësues ndihmës sipas nevojës. Gjatë vitit shkollor 2021-2022 ka vazhduar procesi i punësimit të mësuesve ndihmës duke shkuar në 1338 mësues ndihmës, ndërkohë në shtator 2022, numri i tyre është rritur me 24%, përkatësisht 1660 mësues ndihmës. Raporti fëmijë me aftësi të kufizuara-mësues ndihmës në vitin 2021 ishte 3.7, ndërkohë për vitin 2022 ky raport ka shkuar në 3.
Nga analiza e të dhënave shihet qartë që është rritur ndjeshëm numri i mësuesve ndihmës në sistemin arsimor parauniversitar. Ndërkohë, që për vitin shkollor 2022-2023 është parashikuar që ky numër të shtohet me 300 punonjës të rinj. Numri i mësuesve në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë (INND) është 17 mësues dhe 12 mësues ndihmës, ndërsa, në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë (INNSH) janë 15 mësues dhe 7 mësues ndihmës.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar në nivelin 80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.1. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.1.** | Sigurimi i mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Duhet të rritet numri i mësuesve ndihmës në rajone ku numri i nxënësve me aftësi të kufizuara për mësues është më i lartë, siç janë Tirana, Durrësi dhe Kamza, duke siguruar një raport 2-3 nxënës me aftësi të kufizuara për një mësues ndihmës. | Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parauniversitar | **80%** | **4** |
| | | Numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat publike | **80%** | **4** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.1.** | | **80%** | **4** |

**MasaA2.1.2 Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.**
Parashikohet të hartohen programe për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve për mësuesit ndihmës, që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.

**Treguesi 1**
**Hartimi i programeve dhe moduleve profesionale në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.**
Ky tregues na jep numrin e programeve dhe moduleve të hartuara dhe miratuara në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.

**Treguesi 2**
**Numri i trajnimeve të zhvilluara për mësuesit e shkollave speciale**
Ky tregues jep numrin e trajnimeve të zhvilluara për mësuesit e shkollave speciale.

**Analiza e masës**
Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë është në fokus të MAS-it, veprimtari e cila shtrihet nga viti 2022-2024. Në çdo ZVAP janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës, të cilët janë përfshirë në mënyrë periodike në seminare dhe trajnime të organizuara nga ASCAP, OJF të ndryshme në bashkëpunim me MAS, me qëllim

mbështetjen profesionale të fëmijëve me AK. Janë ngritur dhe funksionojnë në mënyrë efektive 60 rrjete profesionale të mësuesve ndihmës. Gjatë periudhës Shtator- Tetor 2022 janë trajnuar 245 specialistë në DRAP-e dhe ZVAP që mbulojnë çështjet e arsimit gjithëpërfshirës, drejtues rrjetesh profesionale të mësuesve ndihmës, si dhe mësues ndihmës anëtarë të rrjeteve profesionale. Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve të shkollave speciale janë hartuar 33 programe dhe module profesionale në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Gjithashtu janë hartuar planet shkollore për "Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë", për "Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë", si dhe për arsimin e mesëm të nxënësve që nuk dëgjojnë.
Janë trajnuar mësuesit e "Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë" për planifikimin e mësimdhënies.

**Niveli i zbatimit**
Nga analiza e treguesve të masës rezulton se është zbatuar 80%, ku treguesi "Hartimi i programeve dhe moduleve profesionale në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë" është arritur të realizohet 60% dhe treguesi "Numri i trajnimeve të zhvilluara për mësuesit e shkollave speciale" është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.2** | Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Do të hartohen programe të zhvillimit profesional për këta mësues. | Hartimi i programeve dhe moduleve profesionale në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. | **60%** | **3** |
| | | Numri i trajnimeve të zhvilluara për mësuesit e shkollave special | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.2** | | **80 %** | **4** |

**Masa A2.1.3 Kthimi i shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar.**
Në kuadër të përmirësimit të cilësisë të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës MAS është angazhuar për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar.

**Treguesi**
**Numri i shkollave speciale që janë kthyer si qendra burimore.**
Ky tregues jep numrin e shkollave speciale që janë kthyer si qendra burimore.

**Analiza e masës**
Në shtator 2018, Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuara ka shqyrtuar rekomandimet për avancimin e gjithëpërfshirjes në arsim dhe ka dalë në përfundimin se: "Shkollat e specializuara, të cilat ofrojnë arsim vetëm për persona me probleme të veçanta, nuk janë gjithëpërfshirëse. Në mënyrë të ngjashme, edhe vendosja e nxënësve me aftësi të kufizuara në klasa të përgjithshme, pa u shoqëruar, për shembull, me ndryshime strukturore në organizim, kurrikul dhe në strategjitë e mësimdhënies apo mësim nxënies nuk është tregues i gjithëpërfshirjes. Zakonisht, cilësia e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri është e ulët, pasi pritshmëritë e prindërve dhe mësuesve janë të ulëta dhe kjo kufizon mundësitë e nxënësve."Gjatë viteve në vazhdim është arritur progres në përmirësimin e të nxënit të gjuhës së shenjave për rritjen e cilësisë së arsimimit të nxënësve që nuk dëgjojnë deri në nivelin e arsimit të mesëm. Për të trajtuar problemet në këtë fushë është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 4481, datë 25.04.2018 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Personave që nuk Dëgjojnë, për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe ofrimin e shërbimeve të interpretimit në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.
Në vitin 2022 është ngritur një grup pune në MAS për hartimin e draftit për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë nuk është zbatuar ende pasi në SKA kthimi i Shkollave Speciale në Qendra Burimore synohet të realizohet në vitet 2023-2025.
**Kjo masë nuk është përfshirë në vlerësim.**

**Masa A2.1.4 Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.**
Për tu ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara institucionet arsimore duhet të pajisen edhe me programe teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mjete dhe programet për këta fëmijë përfshijnë: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, në dëgjim dhe në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecs (komunikim nëpërmjet figurave) etj.

**Treguesi**
**Numri i shkollave që disponojnë mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar në raport me numrin total të shkollave.**
Ky tregues jep numrin e shkollave që disponojnë mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar në raport me numrin total të shkollave.

**Analiza e masës**
Për të krijuar kushtet e nevojshme që fëmijët me aftësi të kufizuar të ndjekin arsimin në shkollat e zakonshme, ato duhet të pajisen me programe teknologjike dhe mjetet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara si: programe kompjuterike të ndryshme për fëmijët me vështirësi në shikim, në dëgjim dhe

në të folur; makina llogaritëse për fëmijët që vuajnë nga diskalkulia; libra audio; monitor/ekran me prekje; set me puzzle/ngjyra/lodra/fletore; libra me figura; i-pad-e; pecs (komunikim nëpërmjet figurave). Nga analiza e informacionit të marrë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase rezulton se vazhdon procesi i identifikimit të nevojave të shkollës për mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 20%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.4** | Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara. | Numri i shkollave që disponojnë mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar në raport me numrin total të shkollave. | **20%** | **1** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.4** | | **20%** | **1** |

**MasaA2.1.5 Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës.**
Për të gjitha investimet nga fonde publike do të zbatohet standardi i ndërtimit të godinave shkollore të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara në mënyrë që këta nxënës të kenë akses në të gjitha mjediset e shkollës. Standardi do të zbatohet me rastin e rinovimit të godinave shkollore.

**Treguesi 1**
**Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 1**
Ky tregues jep numrin e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara.

**Treguesi 2**
**Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 2**
Ky tregues jep numrin e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara.

**Treguesi 3**

**Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 3**

Ky tregues jep numrin e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara.

**Analiza e masës**

Vitet e fundit janë bërë hapa të rëndësishëm për sa i përket infrastrukturës së institucioneve arsimore që plotësojnë standardet për nxënësit me AK. Të gjitha shkollat që janë ndërtuar të reja plotësojnë standardet e infrastrukturës për nxënësit me AK, tashmë të miratuara, por ka ende shumë shkolla të cilat nuk kanë infrastrukturë dhe material të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuar.

**Niveli i zbatimit**

Masa konsiderohet e realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.5** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.5.** | Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe në të mjediset e shkollës. Për të gjitha investimet nga fonde publike do të zbatohet standardi i ndërtimit të godinave shkollore të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara në mënyrë që këta nxënës të kenë akses të plotë në të gjitha mjediset e shkollës. Standardi do të zbatohet edhe me rastin e rinovimit të godinave shkollore. | Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 1. | **50%** | **2.5** |
| | | Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 2. | **50%** | **2.5** |
| | | Përqindja e shkollave me infrastrukturën dhe materialet e përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara - Niveli ISCED 3. | **50%** | **2.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.5** | | **50%** | **2.5** |

**Masa A2.1.6 Mbështetje financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabile.**
MAS do të konsolidojë një program të bursave për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollave të mesme nga familjet në kushte të vështira ekonomike. Bursat do të jenë të kushtëzuara me vijimin e rregullt të shkollës, ndërsa përparësi do të kenë vajzat dhe kandidatët me performancë të mirë në mësime.

**Treguesi 1**
**Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin bazë**
Ky tregues jep numrin e numrin e fëmijëve të pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane të regjistruar në arsimin bazë dhe përfitojnë mbështetje financiare.

**Treguesi 2**
**Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë**
Ky tregues jep numrin e numrin e fëmijëve të pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë dhe përfitojnë mbështetje financiare.

**Treguesi 3**
**Përqindja e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë që e përfundojnë atë**
Ky tregues jep numrin e numrin e fëmijëve të pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane që përfundojnë klasën e nëntë në raport me numrin e fëmijëve të këtyre kategorive të regjistruar në klasën e parë 9 vjet më parë.

**Treguesi 4**
**Përqindja e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin e mesëm të lartë që e përfundojnë atë.**
Ky tregues jep numrin e numrin e fëmijëve të pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane që përfundojnë klasën e e 12-të në raport me numrin e fëmijëve të këtyre kategorive të regjistruar në klasën e dhjetë 3 vjet më parë.

**Analiza e masës**
Në vitin 2018-2019, rreth 5,000 fëmijë romë dhe 11,100 fëmijë egjiptianë ishin të regjistruar në arsimin parauniversitar, në vitin 2019-2020 ka pasur 4.862 fëmijë romë dhe 9,653 fëmijë egjiptianë, në vitin 2020-2021 ka pasur një rritje të lehtë të numrit të fëmijëve egjiptianë dhe rënie të ulët të fëmijëve romë përkatësisht 4.773 fëmijë romë dhe 10,102 fëmijë egjiptianë, ndërsa për vitin 2021-2022ka pasur 4.338 fëmijë romë dhe 9,997 fëmijë egjiptianë. Një numër i lartë i fëmijëve romë dhe egjiptianë nuk përfundojnë arsimin bazë, ndërkaq një numër i vogël i tyre regjistrohen në shkolla të mesme të larta. Pra, hendeku ndërmjet fëmijëve romë/egjiptianë dhe fëmijëve të tjerë që jetojnë në të njëjtat zona mbetet shqetësues për MAS.

**Niveli i zbatimit**
Mungojnë të dhënat për përqindjen e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë që e përfundojnë atë. Nuk ka të dhëna krahasimore për këto tregues.
**Kjo masë nuk është përfshirë në vlerësim.**

**Masa A2.1.7 Trajnime për historinë dhe kulturën rome.**

Do të krijohet një modul i veçantë mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve dhe do të hartohet një udhëzues për mësuesit për zbatimin e modulit. Në trajnime parashikohet të përfshihen mësuesit, edukatorët, drejtorët e shkollave etj.

**Treguesi 1**

**Numri i mësuesve të trajnuar për historinë dhe kulturën rome**

Ky tregues na jep numrin e mësuesve që janë trajnuar për historinë dhe kulturën rome.

**Treguesi 2**

**Hartimi i modulit mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve.**

Ky tregues parashikon hartimin e një moduli mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve.

**Analiza e masës**

Mësimi i historisë/kulturës së romëve dhe/ose migratëve nuk ka qenë i përfshirë sa duhet në lëndë të ndryshme shkollore, të tilla si: historia, edukimi qytetar, letërsia, feja ose etika, arti, muzika ose gjuhët. Për këto arsye në SKA janë parashikuar trajnime për mësimin e historisë dhe kulturës rome dhe/ose migratëve. Në kuadër të përmbushjes së synimeve të SKA-së, ASCAP-i ka hartuar një draft udhëzues për mësuesit, mbi trajtimin në kurrikulën shkollore të historisë dhe kulturës rome. Përgjatë vitit 2022, ASCAP-i ka trajnuar rreth 30 mësues dhe drejtues në kopshte e shkolla të ZVAP-ve Elbasan dhe Fier për gjuhën dhe kulturën rome.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar 30%. Janë bërë hapa të ngadaltë për zbatimin e saj. Arsyeja e mos zbatimit është se kjo masë synohet për tu realizuar në një shtrirje të gjatë kohore 2021-2025.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.7** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.7** | Trajnime për historinë dhe kulturën rome. Në trajnime do të përfshihen mësuesit, edukatorët, drejtorët e shkollave etj. Do të krijohet një modul mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve dhe do të hartohet një udhëzues për mësuesit për zbatimin e modulit. | Numri i mësuesve të trajnuar për historinë dhe kulturën rome. | **30%** | **1.5** |
| | | Hartimi i modulit mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve dhe udhëtarëve. | **30%** | **1.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.7** | | **30%** | **1.5** |

**Masa A2.1.8 Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve socialë/ psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore.**
Parashikohet të hartohen programe trajnimi që kanë në fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

**Treguesi 1**
**Numri i trajnimeve të zhvilluara me mësues, drejtues të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore.**
Ky tregues na jep numrin e trajnimeve të zhvilluara me mësues, drejtues të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore.

**Treguesi 2**
**Hartimi i programeve të trajnimit që kanë në fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.**
Ky tregues na jep numrin e programeve të trajnimit për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

**Analiza e masës**
Barazia gjinore është në qendër të parimeve të të drejtave të njeriut dhe vlerave të Kombeve të Bashkuara. Sipas Qëllimit 5 të KB për zhvillimin e qëndrueshëm, barazia gjinore nuk është vetëm e drejtë themelore e njeriut, por themel i domosdoshëm për një botë paqësore, më të begatë dhe të qëndrueshme. Për këto arsye MAS-i ka bërë pjesë të SKA-së hartimin e programeve dhe trajnimeve me fokus zvogëlimin e diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Në ndërkohë, ASCAP ka punuar për përgatitjen e një materiali mbështetës për mësuesit në arsimin parauniversitar në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në zbatimin e kurrikulës. Materiali synon të orientojë mësuesit si zhvillues dhe zbatues të kurrikulës në shkollë, në lidhje me përdorimin e strategjive të mësimdhënies që u japin mundësi të barabarta dhe fuqizojnë vajzat dhe djemtë, për krijimin e një mjedisi të nxëni të barabartë në aspektin gjinor. Trajnimet për zhvillimin e këtij moduli nuk janë realizuar ende. Kjo masë shtrihet për zbatim përgjatë periudhës 2022-2024. Për këtë arsye ASCAP-i ka planifikuar trajnime me fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore përgjatë viteve në vazhdim.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është është realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.8 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.8** | Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore. Do të hartohen programe trajnimi që kanë në fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. | Numri i trajnimeve të zhvilluara me mësues, drejtues të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore. | **0%** | **0** |
| | | Hartimi i programeve të trajnimit që kanë në fokus rritjen e njohurive dhe aftësive gjinore për zvogëlimin e stereotipave dhe diskriminimit gjinor dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.8** | | **50%** | **2.5** |

**Masa A2.1.9 Edukimi gjinor i nxënësve nëpërmjet përfshirjes në kurrikula të përmbajtjeve mësimore që synojnë edukimin gjinor.**
Hartimi i kurrikulës/orëve shkollore të edukimit gjinor, do bëjë që nxënësit do të marrin informacion mbi barazinë gjinore, stereotipat gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje nëpërmjet kurrikulës/orëve shkollore.

**Treguesi**
**Hartimi i kurrikulës/orëve shkollore për edukimin gjinor.**
Ky tregues na jep informacion për kurrikulat/orët mësimore për edukimin gjinor.

**Analiza e masës**
ASCAP-i ka përgatitur një material mbështetës për mësuesit në arsimin parauniversitar në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në zbatimin e kurrikulës, "Integrimi i perspektivës gjinore në zbatim të kurrikulës". Ky material synon orientimin e mësuesve si zhvillues dhe zbatues të kurrikulës në shkollë, në lidhje me përdorimin e strategjive të mësimdhënies, që u japin mundësi të barabarta dhe fuqizojnë vajzat dhe djemtë, për krijimin e një mjedisi të nxëni të barabartë në aspektin gjinor.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.9 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.9** | Edukimi gjinor i nxënësve nëpërmjet përfshirjes në kurrikula të përmbajtjeve shkollore që synojnë edukimin gjinor. Hartimi i kurrikulës/orëve shkollore të edukimit gjinor. Nxënësit do të marrin informacion mbi barazinë gjinore, stereotipat gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje nëpërmjet kurrikulës/orëve shkollore. | Hartimi i kurrikulës/orëve shkollore për edukimin gjinor. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.9** | | **100%** | **5** |

**MasaA2.1.10 Shtrirja e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë".**
Shtrirja e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" shërben për sigurimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije. Nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë" do të shoqërohet me një analizë të gjendjes së shkollave duke vlerësuar infrastrukturën dhe kapacitetet e institucioneve arsimore.

**Treguesi**
**Numri i shkollave që janë pjesë e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë"**
Ky tregues na jap numrin e shkollave që janë pjesë e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë".

**Analiza e masës**
Nisma " Bëjmë detyrat e shtëpisë" është një program i MAS-it, që synon të ndihmojë dhe aftësojë fëmijët në përparimin në dije dhe mundëson që nxënësi të kryejë detyrat e shtëpisë brenda mjediseve të shkollës. Gjithashtu, ka si qëllim të mbështesë aftësitë shoqërore, fizike dhe intelektuale të nxënësve përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitete të organizuara, pas përfundimit të procesit shkollor. ASCAP-i në bashkëpunim me MAS-in dhe përfaqësues të DRAP-ve ka hartuar udhëzuesin për zbatimin e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë". Kjo nismë përgjatë vitit 2021-2022 u zbatua në 130 institucione arsimore, që janë nën juridiksionin e 25 ZVAP-ve. Janë formuar 347 klasa shkollore, në të cilat u përfshinë 7576 nxënës dhe 801 mësues.
Për vitin shkollor 2022- 2023 është parashikuar që ky program të zgjerohet në 200 shkolla.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.1.10 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.1.10** | Shtrirja e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" për sigurimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije. Nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë" do të shoqërohet me një analizë të gjendjes së shkollave duke vlerësuar infrastrukturën dhe kapacitetet e institucioneve arsimore. | Numri i shkollave që janë pjesë e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë". | **100%** | **5** |
| | | Numri i nxënësve që përfitojnë nga nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë". | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.1.10** | | **100%** | **5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT**

**Produkti A2.1 Sigurimi i arsimit cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabile.**

**Përshkrimi i produktit**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të siguruar një arsim cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabël ka marrë angazhimin për të rritur numrin e mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. Në kuadër të gjithëpërfshirjes, MAS-i në bashkëpunim me partnerë të saj, po punon për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar. Ndërkohë, në SKA është parashikuar mbështetje financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël, trajnime për historinë dhe kulturën rome dhe shtrirja e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" në sa më shumë shkolla, me qëllim uljen e hendekut që ekziston në ndjekjen e shkollës nga fëmijët që vijnë nga grupe vulnerabël krahasimisht me fëmijët e tjerë. Edukimi gjinor i nxënësve, nëpërmjet përfshirjes në kurrikula të përmbajtjeve shkollore që synojnë edukimin gjinor dhe zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve

socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore synojnë të përmirësojnë barazinë gjinore në arsimin parauniversitar dhe gjithëpërfshirjen pa dallim gjinie.

**Vlerësimi i realizimit të produktit A2.1**

Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë është në fokus të SKA-së. Për këtë arsye janë ngritur dhe funksionojnë efektivisht 60 rrjete profesionale të mësuesve ndihmës. Rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës janë përfshirë në mënyrë periodike në seminare dhe trajnime të organizuara nga ASCAP-i, OJF të ndryshme në bashkëpunim me MAS-in, me qëllim mbështetjen profesionale të fëmijëve me AK.

Gjatë periudhës Shtator- Tetor 2022 janë trajnuar 245 specialistë në DRAP-e dhe ZVAP që mbulojnë çështjet e arsimit gjithpërfshirës, drejtues rrjetesh profesional të mësuesve ndihmës, si dhe mësues ndihmës anëtarë të rrjeteve profesionale.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve të shkollave speciale janë hartuar 33 programe dhe module profesionale në shërbim të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.

MAS-i ka miratuar të gjithë bazën ligjore të nevojshme për funksionimin e mësuesve ndihmës në institucionet arsimore. Institucionet në varësi të MAS-it janë në proces të identifikimit të nevojave të shkollës për mjete dhe programe për fëmijët me aftësi të kufizuar. Ka pasur një progres të ulët për sa i përket realizmit të kësaj mase, për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore.

Të gjitha shkollat që janë ndërtuar të reja plotësojnë standardet e infrastrukturës për nxënësit me AK. Megjithatë, ka edhe institucione arsimore të cilat janë të rikonstruktuara, të cilat nuk plotësojnë këto standarde. Në vitin 2022 është ngritur një grup pune në MAS për hartimin e draftit për kthimin e shkollave speciale në qendra burimore.

Në kuadër të përmbushjes së synimeve të SKA-së, për mësimin e historisë/kulturës së romëve dhe/ose migratëve në shkolla, ASCAP-i, ka hartuar draft udhëzuesin për mësuesit mbi trajtimin në kurrikulën shkollore të historisë dhe kulturës rome. Përgjatë vitit 2022, ASCAP ka trajnuar rreth 30 mësues dhe drejtues në disa kopshte dhe shkolla të ZVAP-ve Elbasan dhe Fier për gjuhën dhe kulturën rome.

Në fokus të SKA-së është zvogëlimi i diskriminimit gjinor dhe parandalimi i dhunës me bazë gjinore. ASCAP-i ka punuar për përgatitjen e një materiali mbështetës për mësuesit në arsimin parauniversitar në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në zbatimin e kurrikulës.

Në kuadër të zbatimit dhe fuqizimit të Nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ASCAP-i në bashkëpunim me MAS dhe përfaqësues të DRAP-ve ka hartuar udhëzuesin për zbatimin e saj. Kjo nismë përgjatë vitit 2021-2022 u zbatua në 130 institucione arsimore, që janë nën juridiksionin e 25 ZVAP-ve. Janë formuar 347 klasa shkollore, në të cilat u përfshinë 7576 nxënës dhe 801 mësues. Janë bërë përpjekje domethënëse për realizimin e kësaj mase nga institucionet përgjegjëse, duke krijuar një praktikë të mirë.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A2.1** | Sigurimi i arsimit cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabile | A2.1.1. Sigurimi i mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara | 4 |
| | | A2.1.2. Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë | 4 |
| | | A2.1.3. Kthimi shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar | - |
| | | A2.1.4. Pajisja e shkollave me mjete dhe programe teknologjike për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara | 1 |
| | | A2.1.5 Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës | 2.5 |
| | | A2.1.6. Mbështetje financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabile | - |
| | | A2.1.7. Trajnime për historinë dhe kulturën rome | 1.5 |
| | | A2.1.8. Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet gjinore | 2.5 |
| | | A2.1.9. Edukimi gjinor i nxënësve nëpërmjet përfshirjes në kurrikula të përmbajtjeve shkollore që synojnë edukimin gjinor | 5 |
| | | A2.1.10.Shtrirja e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A2.1** | | **3.2** |



**PRODUKTI A2.2. RRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL**

**Masa A2.2.1 Shtimi i numrit të punonjësve psiko-socialë në shkolla**
Në periudhën 2021-2026 parashikohet të rritet numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla sipas standardit të përcaktuar nga MAS.

**Treguesi**
**Numri i punonjësve psiko-socialë në shkolla.**
Ky tregues na jep të dhëna për numrin e punonjësve psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar.

**Analiza e masës**
Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në sistemin e arsimit parauniversitar është rritur vitet e fundit, ku kemi një psikolog/punonjës social për 500-700 fëmijë. Për vitin shkollor 2021-2022 kanë dhënë mbështetjen e tyre profesionale për mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve 628 punonjës të SHPS, ndërkohë që për vitin shkollor 2022- 2023, bazuar në udhëzimin Nr.461 datë 27.07.2022 "Për një ndryshim të Urdhrit Nr. 313,datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit piko-social në instituionet arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social", i ndryshuar, është parashikuar një rritje numri prej 230 punonjësish.

**Niveli i zbatimit**
Masa është realizuar 100%, ashtu siç është planifikuar.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.2.1** | Shtimi i numrit të punonjësve psiko-socialë në shkolla. Në periudhën 2021-2026 do të rritet numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla sipas standardit të përcaktuar nga MAS. | Numri i punonjësve psiko-social në shkolla | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.2.1** | | **100%** | **5** |

**Masa A2.2.2 Sigurimi i kushteve optimale të punës për shërbimin psiko-social.**
Parashikohet të ngrihen kabinetet e SHPS-së në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar dhe do të sigurohen pajisjet përkatëse për psikologët dhe punonjësit socialë në shkolla.

**Treguesi**

**Numri i shkollave që kanë ambiente pune të veçanta që plotesojnë kushte optimale për shërbimin psiko-social në raport me numrin total të shkollave.**

Ky tregues na jep të dhëna për numrin e shkollave në të gjithë republikën, me kushte pune të veçanta për shërbimin psiko-social.

**Analiza e masës**

Në funksion të përmirësimit të cilësisë të shërbimit psiko-social është përmirësimi i kushteve fizike dhe krijimi i kabineteve psiko-sociale në të gjitha shkollat. Për vitin shkollor 2021-2022 janë ngritur 410 zyra në mbështetje të mirëqenies psiko-emocionale të nxënësve për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme apo vlerësimin e tyre. Megjithëse punonjësit e shërbimit psiko-social kanë mjedise për ushtrimin e funksionit, sërish ato kanë nevojë për pajisjen e tyre me mjete si kompjuter, kancelari etj.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.2.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.2.2** | Sigurimi i kushteve optimale të punës për shërbimin psiko-social | Numri i shkollave që kanë ambiente pune të veçanta që plotësojnë kushte optimale për shërbimin psiko-social në raport me numrin total të shkollave | 50% | 2.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.2.2** | | **50%** | **2.5** |

**MasaA2.2.3 Hartimi dhe standardizimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social.**

Dokumentet e punës për shërbimin psiko-socialdo të përfshijnë parimet, standardet, format e vlerësimit, testet e standardizuara psikologjike etj. që u nevojiten profesionistëve gjatë punës me nxënësit, stafet e shkollës, prindërit, komunitetin dhe aktorë të tjerë që të gjithë profesionistët të punojnë në mënyrë të njësuar.

**Treguesi**

**Dokumentet e hartuara/miratuara dhe standartizuara për shërbimin psiko-social.**

Ky tregues na jep të dhëna për numrin e dokumenteve të hartuara/miratuara për shërbimin psiko-social.

**Analiza e masës**

Në ndihmë të profesionistëve të shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare, ASCAP-i ka hartuar 3 dokumente: "Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor", "Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor" dhe "Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor".

"Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor" është dokument që siguron orientim për punonjësit e shërbimit psiko-social, për nxënësit, për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, për strukturën drejtuese të njësisë së shërbimeve psiko-sociale të shkollës (drejtuesi i NJSHPS-ës dhe supervizorët) dhe për marrësit e shërbimeve psiko-sociale në shkollë. Përveç kësaj, ka për qëllim të rrisë kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social, në lidhje me praktikat e duhura profesionale, si dhe të stimulojë zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit.

"Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor" kërkon të zbatojë standardet etike për sjellje të veçanta profesionale, në përputhje më aktet ligjore dhe nënligjore të urdhrave përkatëse të profesionit, ku janë të përfshirë punonjësit e shërbimit psiko-social. Pavarësisht pozicionit të punës, mjedisit të punës, grup-moshës së nxënësve etj., punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të reflektojnë mbi temën dhe synimin e secilit parim dhe standardi etik, për zbatimin e tyre në situata individuale.

"Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor" është një udhëzues praktik, mbi procedurat që duhen të ndiqen nga punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor, në identifikimin, vlerësimin, ndërhyrjen dhe në parandalimin e problematikave me të cilat nxënësit, prindërit dhe mësuesit përballen në shkollë, familje dhe komunitet. Udhëzuesi synon të ofrojë një kornizë të unifikuar veprimesh institucionale, të cilat janë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, si dhe në mbështetje të suksesit të tyre akademik dhe social.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar në nivelin 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.2.3 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.2.3** | Hartimi dhe standardizimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social. Këto dokumente përfshijnë parimet, standardet, format e vlerësimit, testet e standardizuara psikologjike etj., që u nevojiten profesionistëve gjatë punës me nxënësit, stafet e shkollës, prindërit, komunitetin dhe aktorë të tjerë që të gjithë profesionistët të punojnë në mënyrë të njësuar. | Dokumentet e hartuara/ miratuara dhe standartizuara për shërbimin psiko-social. | 100 % | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.2.3** | | **100%** | **5** |

## Masa A2.2.4 Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social.

Psikologëve dhe punonjësve socialë do t'u ofrohen mundësi për zhvillim profesional për të avancuar cilësinë e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata me IQ të lartë, në bashkëpunim me mësuesit.

**Treguesi**

**Numri punonjësve të shërbimit psiko-social te trajnuar.**

Ky tregues na jep të dhëna për numrin e punonjësve të shërbimit psiko-social te trajnuar.

**Analiza e masës**

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimi psiko-social për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të ofruar, ASCAP-i gjatë vitit 2022 ka trajnuar rreth 650 punonjës të shërbimit psiko-social dhe oficerë sigurie. Trajnimet janë fokusuar kryesisht mbi dokumentet e hartuara për këtë shërbim me synim rritjen e cilësisë dhe njehsimin e punës së të gjithë punonjësve psiko-social, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre në ndihmë të nxënësve, punonjësve arsimorë, prindërve dhe komunitetit. Trajnimi ofroi praktikat e punës mbi procedurat që duhen të ndiqen nga punonjësit psiko-social në identifikimin, vlerësimin, ndërhyrjen dhe parandalimin e problematikave me të cilat nxënësit, prindërit dhe mësuesit përballen në shkollë e familje. Rritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë ofroi një kornizë të unifikuar veprimesh institucionale të cilat janë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe në mbështetje të suksesit të tyre akademik dhe social. Rritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë i pajisi punonjësit e shërbimit psiko-social dhe oficerët e sigurisë me aftësi praktike dhe njohuri në rritjen e kompetencës profesionale dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimit të tyre në shkolla. Sipas SKA trajnimi i stafeve të shërbimit psiko-social synohej të arrihej gjatë vitit 2022. Për shkak të numrit të lartë të punonjësve psiko-socialë, numrit të ulët të trajnuesve dhe volumit të materialeve trajnuese, kjo masë do të shtrihet në vitin në vazhdim.

**Niveli i zbatimit**

Nga analiza e të dhënave rezulton se masa është realizuar 80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.2.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.2.4** | Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social. Psikologëve dhe punonjësve socialë do t'u ofrohen mundësi për zhvillim profesional për të avancuar cilësinë e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata me IQ të lartë, në bashkëpunim me mësuesit. | Numri punonjësve të shërbimit psiko-social te trajnuar. | 80 % | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.2.4** | | **80%** | **4** |

**Masa A2.2.5 Hartimi i planeve për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve.**

Institucionet arsimore parauniversitare do të hartojnë plane për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos në raste pas emergjencave.

**Treguesi**

**Planet e hartuara/miratuara për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve.**

Ky tregues jep numrin e planeve të hartuara për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve.

**Analiza e masës**

Është hartuar “Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor”. Nëpërmjet këtij udhëzues punonjësit e shërbimit psiko-social orientohen për hartimin dhe zbatimin e seancave sensibilizuese për mirëqenien emocionale. Kështu, punonjësi i shërbimit psiko-social në çdo shkollë duhet të hartojë dhe zbatojë plan pune për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien social-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve, por jo të gjithë e kanë realizuar.

**Niveli i zbatimit**

Masa konsiderohet e realizuar 80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.2.5 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.2.5** | Hartimi i planeve për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos në raste pas emergjencave. | Planet e hartuara/ miratuara për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve. | 80% | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.2.5** | | **80%** | **4** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A.2.2**

**Përshkrimi i produktit**

Në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit në SKA janë planifikuar 5 masa. Kështu, është planifikuar shtimi i numrit të punonjësve psiko-socialë në shkolla dhe sigurimi i kushteve optimale të punës për shërbimin psiko-social, për të rritur cilësinë e shërbimit dhe krijimin e nje mjedisi mikpritës për fëmijët. Përpos promovimit në vazhdimësi të shërbimit psiko-social, duhet ti kushtohet rëndësi përmirësimit të mëtejshëm të tij, në funksion të grupeve të interesit. Në këtë aspekt, është planifikuar për tu realizuar standardizimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social si dhe zhvillimi i kapaciteteve të tyre. Tashmë, në sistemin tonë parauniversitar, nxënësve nuk u transmetohen vetëm dije, por u ofrohet dhe mbështetje psiko-sociale si dhe seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien social-emocionale të fëmijëve, e cila është një nga prioritet e SKA.

**Analiza e produktit**

Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social në sistemin e arsimit parauniversitar është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Për vitin shkollor 2021-2022 kanë dhënë mbështetjen e tyre profesionale për mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve 628 punonjës të SHPS. Për vitin shkollor 2021-2022 kanë qenë të pajisur me zyra në funksion të ushtrimit të profesionit të shërbimit psiko-social 410 institucione arsimore. Krijimi i kabineteve psiko-sociale në të gjitha shkollat në funksion të përmirësimit të cilësisë të shërbimit psiko-social ka qenë një nga prioritet e MAS-it, i cili është realizuar pjesërisht. Ndërkohë, ka përfunduar procesi i hartimit të dokumenteve për standardizimin  e punës së shërbimit psiko-social. Kjo masë e parashikuar në SKA ka shënuar arritje dhe është realizuar plotësisht nga institucionet përgjegjëse në vitin 2022. Ndërkaq, ASCAP-i ka filluar punën për zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të shërbimi psiko-social për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, gjë e cila do të vazhdojë edhe gjatë viteve 2023-2024.Trajnimi i punonjësve të shërbimit psiko-social do të fokusohet edhe në hartimin e planeve të punës për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien social-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.2 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A2.2** | Rritja e cilësisë së shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit. | A2.2.1. Shtimi i numrit të punonjësve psiko-social në shkolla | 5 |
| | | A2.2.2. Sigurimi i kushteve optimale të punës për shërbimin psiko-social | 2.5 |
| | | A2.2.3. Hartimi dhe standardizimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social | 5 |
| | | A2.2.4. Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit psiko-social | 4 |
| | | A2.2.5. Hartimi i planeve për seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A2.2** | | **4.1** |



**PRODUKTI A2.3. KONSOLIDIMI I MJEDISEVE TË SIGURTA DHE MIQËSORE**

**Masa A2.3.1 Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm**

Në bashkëpunim me partnerët, MAS do të zhvillojë një protokoll gjithëpërfshirës për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës (fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin), homofobisë, bullizmit, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit në shkolla.

**Treguesi**

**Numri i rasteve të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla.**

Ky tregues na jep numrin e rasteve të evidentuara dhe të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla.

**Analiza e masës**

Nga raportimi i të dhënave nga institucionet përgjegjëse dhe analiza e tyre rezulton se në çdo shkollë ka mësues koordinator të dhunës, ekstremizmit dhe është krijuar rrjeti i koordinatorëve të dhunës dhe ekstremizmit. Çdo shkollë ka plan për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës dhe ekstremizmit. E gjithë procedura për identifikimin dhe menaxhimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla gjendet në dokumentin "Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor". Gjithashtu, ASCAP-i ka publikuar udhëzuesin (materiali ndihmës) për mësuesit "Adresimi i antisemitizmit në shkollë". Nuk disponohen të dhëna në rang rajoni në lidhje me identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe as në lidhje numrin e rasteve të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të evidentura dhe të menaxhuara nga shkollat.

**Niveli i zbatimit**

Masa konsiderohet e realizuar 30%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.3.1** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.3.1** | Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm. | Numri i rasteve të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla. | **30%** | 1.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.3.1** | | **30%** | **1.5** |

**Masa A2.3.2 Fuqizimi i rrjetit të shkollave-qendra komunitare.**
Vazhdimi i mbështetjes për shkollat-qendra komunitare ku fokusi në do të jetë në fuqizimin e rrjetit të këtyre shkollave në nivel të ZVAP-ve, DRAP-ve dhe në nivel vendi.
**Treguesi**
**Numri i shkollave që janë pjesë e nismës "Shkolla qendër komunitare" në raport me numrin total të shkollave.**
Ky tregues jep numrin e shkollave që janë pjesë e nismës "Shkolla qendër komunitare" në raport me numrin total të shkollave.

**Analiza e masës**
Mbështetur në "Standardet për Shkollën Qendër Komunitare" Nr.1794, datë13.03.2014 dhe kritereve të përzgjedhjes, shkresa 1794/1, datë 31.03.2014, të gjitha ZVAP që kërkuan shtimin e numrit të SHQK-ve për vitin shkollor 2021-2022, ngritën grup pune me urdhër të drejtorit të ZVAP-së, për monitorimin dhe verifikimin e plotësimit të kritereve për përzgjedhjen e SHQK-së, nën juridiksionin e tyre. Në shtator 2021, listës zyrtare me 266 institucione arsimore të arsimit parauniversitar SHQK, iu shtuan edhe 195 institucione arsimore të arsimit parauniversitar. Tashmë janë rreth 461 shkolla që planifikojnë dhe zhvillojnë gjatë një viti shkollor veprimtari të ndryshme, që nxisin procesin e shndërrimit të këtyre institucioneve në qendra komunitare. Janë rreth 2500 klube që drejtohen nga 2500 mësues, ku marrin pjesë dhe përfitojnë rreth 49000 nxënës. Janë ngritur kapacitetet e 195 shkollave të reja në nismën SHQK për vitin shkollor 2021-2022, nëpërmjet trajnimit të koordinatorëve të ZVAP-ve në gjithë vendin.

**Niveli i zbatimit**
Nga analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse konstatohet se masa është realizuar 100%, ashtu siç parashikohet në SKA.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.3.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.3.2** | Fuqizimi i rrjetit të shkollave-qendra komunitare. | Numri i shkollave që janë pjesë e nismës "Shkolla qendër komunitare" në raport me numrin total të shkollave. | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.3.2** | | **100%** | **5** |

**Masa A2.3.3 Fuqizimi i rrjetit të shkollave me klasa të profilizuara në sport (klasat sportive)**
Në periudhën 2021-2026, fokusi do të jetë në shtrirjen e rrjetit të këtyre shkollave në nivel të ZVAP-ve, DRAP-ve dhe në nivel vendi, dhe shtimin e disiplinave sportive, në bazë të të cilave do të krijohen klasat e profilizuara në sport, si: gjimnastikë, atletikë etj.

**Treguesi**
**Hartimi i programeve të profilizuara në sport.**
Ky tregues na jep numrin e programeve të profilizuara në sport të hartuara dhe miratuara.

**Treguesi**
**Numri i klasave të profilizuara në sport (klasat sportive) në raport me numrin e klasave.**
Ky tregues do të na japë numrin e klasave të profilizuara në sport (klasat sportive) në raport me numrin total të klasave.

**Analiza e masës**
Për vitin shkollor 2021-2022, në sistemin arsimor parauniversitar janë hapur 55 shkolla me klasa sportive në disiplinat futboll, basketboll dhe volejboll. Në profilin e edukimit fizik janë angazhuar 125 mësues, të cilët kanë ngritur rrjetet profesionale, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve brenda tyre. ASCAP-i ka hartuar 24 programe shkollore për klasat e arsimit bazë, ndarë sipas gjinisë vajza/djem mbështetur në ngarkesën shkollore të lëndës së "Edukimit fizik sporte dhe shëndet", për disiplinat sportive atletikë, gjimnastikë dhe tenis: atletikë 4 programe për klasat 6,7,8,9; tenis 4 programe për klasat 6,7,8,9; gjimnastikë janë hartuar 4 programe, grupuar sipas shkallëve të kurrikulës, për klasat 1-2, 3-5, 6-7 dhe 8-9. Gjithashtu, në këtë kuadër gjatë vitit 2018 janë hartuar edhe programet për klasat sportive për disiplinat: 4 programe basketboll 6,7,8,9, 4 programe volejboll 6,7,8,9 dhe 4 programe futboll, 6,7,8,9.

**Niveli i zbatimit**
Masa është realizuar 100%.
**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.3.3** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.3.3** | Fuqizimi i rrjetit të shkollave me klasa të profilizuara në sport (klasat sportive) | Hartimi i programeve të profilizuara në sport. | 100% | 5 |
| | | Numri i klasave të profilizuara në sport (klasat sportive) në raport me numrin total të klasave. | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.3.3** | | **100%** | **5** |

**Masa A2.3.4 Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkolla.**
MAS, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, do të nxjerrë një akt nënligjor të ri për punësimin e oficerëve të sigurisë në të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë, si dhe në shkollat e arsimit bazë që plotësojnë kritere të caktuara për numrin e nxënësve, vendndodhjes, vlerësimit të sigurisë etj.

**Treguesi**
**Numri i oficerëve të sigurisë në shkolla**
Ky tregues na jep numrin e oficerëve të sigurisë të punësuar në shkolla.

**Analiza e masës**
Bazuar në VKM Nr. 600, datë 9.10.2018 "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë", në institucionet arsimore publike u zhvilluan proceduarat e konkurrimit për 150 oficerë sigurie. Kandidatët fitues, pasi u trajnuan nga Akademia e Sigurisë, filluan të ofrojnë shërbimin në institucionet arsimore.
Për vitin shkollor 2021-2022 në institucionet arsimore publike kanë ofruar shërbimin 150 oficerë sigurie. Ndërsa në vitin shkollor 2022-2023 është parashikuar të shtohen edhe 70 oficerë sigurie.

**Niveli i zbatimit**
Nga analiza e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse konstatohet se masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.3.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.3.4** | Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkolla. | Numri i oficerëve të sigurisë në shkolla. | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.3.4** | | **100%** | **5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.3**

**Përshkrimi i produktit**
Qëllimi i institucioneve të arsimit parauniversitar është që fëmijët të fitojnë dije, shkathtësi, aftësi dhe të zhvillojnë sjellje pozitive. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që mjediset të jenë të sigurta dhe miqësore për çdo fëmijë. Kështu, në lidhje me produktin "Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë", në SKA është parashikuar realizimi i 4 masave gjatë periudhës 2022-2024.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

Në kuadër të konsolidimit të mjediseve të sigurta dhe miqësore për çdo fëmijë në shkollë, në institucionet arsimore ka mësues koordinator të dhunës dhe ekstremizmit. Shkollat kanë ngritur rrjetin e koordinatorëve të dhunës dhe ekstremizmit. Në ndihmë të mësuesve koordinatorë, ASCAP-i ka hartuar dhe publikuar Udhëzuesin "Adresimi i antisemitizmit në shkollë". Shkollat kanë hartuar plan për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës dhe ekstremizmit. Ka arritje të rëndësishme për sa i përket shtimit të numrit të shkollave Qendër Komunitare, si dhe janë bërë hapa domethënëse për procesin e fuqizimit të rrjetit të këtyre shkollave. ASCAP-i ka hartuar 24 programe për klasat e profilizuara në sport (klasat sportive), specifikisht për disiplinat atletikë, gjimnastikë dhe tenis. Në vitin 2021-2022 kanë funksionuar 55 klasa sportive, të cilat planifikohen të rriten në vitet në vazhdim.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.3 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A2.3** | Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë. | A2.3.1. Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit, ekstremizmit të dhunshëm. | 1.5 |
| | | A2.3.2.Fuqizimi i rrjetit të shkollave-qendra komunitare. | 5 |
| | | A2.3.3.Fuqizimi i rrjetit të shkollave me klasa të profilizuara në sport (klasat sportive). | 5 |
| | | A2.3.4.Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkolla. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A2.3.** | | **4.1** |



**PRODUKTI A2.4. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE**

**Masa A2.4.1 Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore.**
Përparësi do t'u jepet rindërtimit dhe rinovimit të godinave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, si dhe ndërtimit të godinave të reja shkollore në zonat urbane, ku përqendrimi i nxënësve është i madh, në mënyrë që, brenda vitit 2025, të mos ketë asnjë shkollë me dy turne.

**Treguesi**
**Numri i shkollave të rinovuara dhe të ndërtuara.**
Ky tregues na jep numrin e shkollave të rinovuara dhe të ndërtuara.

**Analiza e masës**
Përmirësimi i infrastrukturës shkollore zë vend të rëndësishëm në politikat e shtetit shqiptar. Tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019 shkaktoi dëme të konsiderueshme në infrastrukturën shkollore. MAS-i ka aprovuar standardet për projektimin e shkollave dhe kopshteve, të cilat shërbejnë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të godinave/hapësirave të reja të shkollave apo në rehabilitimin e godinave ekzistuese. Gjatë vitit 2022 janë ndërtuar 3 institucione arsimore në bashkitë Berat, Divjakë dhe Tropojë. Janë rikonstruktuar 22 institucione arsimore përkatësisht :3 në bashkinë Elbasan, 2 në bashkinë Mat, 2 në bashkinë Lushnje, 2 në bashkinë Pogradec dhe nga 1 institucion arsimor në bashkitë Patos, Dibër, Poliçan, Dimal, Roskovec, Devoll, Korçë, Kukës, Gjirokastër, Vau i Dejës, Selenicë dhe Sarandë.

**Niveli i zbatimit**
Niveli i realizimit të kësaj mase është 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.4.1** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.4.1** | Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. | Numri i shkollave të rinovuara dhe të ndërtuara. | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.4.1** | | **100%** | **5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.4**

**Përshkrimi i produktit**

Infrastruktura shkollore është një ndër elementët më të rëndësishëm për një proces arsimor cilësor. MAS-i dhe njësitë e qeverisje svendore mbështesin rehabilitimin dhe ndërtimin e institucioneve arsimore parauniversitare. Në këtë kuadër, në SKA në lidhje me produktin: "Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore" është synuar vetëm një masë. Kjo masë konsiston në rritjen e investimeve për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore, e cila ka dhe një tregues për numrin e shkollave të rikonstruktuara dhe të ndërtuara. Ky produkt është parashikuar të realizohet gjatë dy viteve 2022-2024.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

Procedurat dhe kriteret për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve arsimore kryhet nga njësitë e qeverisjes vendore në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ato janë përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të sistemit arsimor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale. Gjatë vitit 2022 janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 25 institucione arsimore në 19 bashki të vendit.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.4 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| A2.4. | Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore. | Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A2.4** | | **5** |



**PRODUKTI A2.5 EDUKIMI MBI REAGIMIN NDAJ EMERGJENCAVE CIVILE DHE FATKEQËSIVE NATYRORE**

**Masa A2.5.1 Hartimi i planit kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.**

Parashikohet hartimi i një plani gjithëpërfshirës për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Treguesi**

**Hartimi i paketave dhe dokumenteve që orientojnë reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.**

Ky tregues na jep numrin e paketave dhe dokumenteve të hartuara për reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Analiza e masës**

ASCAP-i ka përgatitur një material ndihmës "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë", për shkollat me modelet e veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.5.1** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.5.1.** | Hartimi i planit kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore. Ky tregues do të na thotë nëse janë evidentuar ao jo raste të menaxhuara të dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla. | Hartimi i paketave dhe dokumenteve që orientojnë reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore. | 100% | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.5.1.** | | **100%** | **5** |

**Masa A2.5.2 Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit dhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe komisionit të sigurisë dhe shëndetit në shkolla.**
Do të konsolidohet paketa e dokumenteve që orientojnë reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore (tërmeti, pandemia, përmbytja etj.).

**Treguesi 1**
**Numri i moduleve të trajnimit të miratuara për mësuesit për emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore.**
Ky tregues jep numrin e moduleve të hartuara nga institucionet përgjegjëse për për mësuesit lidhur me emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Treguesi 2**
**Numri i trajnimeve për emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore.**
Ky tregues na jep numrin e trajnimeve të zhvilluara me mësuesit dhe komisionin e sigurisë dhe shëndetit në shkolla në lidhje me emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Analiza e masës**
ASCAP-i ka hartuar modulin "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë", i cili synon zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore parauniversitare për të kuptuar rolin e shkollës për edukimin e nxënësve dhe stafit shkollor për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore, si dhe përgatitjen e tyre për të ndërtuar modele të veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare, në nivel klase dhe shkolle, që nxisin ndërgjegjësimin, zhvillimin e kompetencës qytetare dhe të veprimit mjedisor të nxënësve për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e emergjencave dhe reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore. Moduli është akredituar nga KAPT-i, por nuk janë zhvilluar trajnime.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.5.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.5.2** | Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit dhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe komisionit të sigurisë dhe shëndetit në shkolla**.** | Numri i moduleve të trajnimit të miratuara për mësuesit për emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore. | 100% | **5** |
| | | Numri i trajnimeve për emergjencat civile dhe fatkeqësive natyrore. | 0 | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.5.2** | | **50%** | **2.5** |

**MasaA2.5.3 Forcimi i kapacitetit të shkollave, këshillit të prindërve dhe grupeve të fëmijëve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë.**

Do të zhvillohen trajnime për rritjen e kapaciteteve të stafeve mësimore dhe këshillit të prindërve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat natyrore.

**Treguesi**

**Numri i trajnimeve të këshillit të prindërve dhe grupeve të fëmijëve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë.**

Ky tregues na jep të dhëna mbi numrin e trajnimeve të këshillit të prindërve dhe grupeve të fëmijëve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë.

**Analiza e masës**

Institucionet në varësi të MAS-it kanë hartuar paketat dhe modulet e trajnimit për menaxhimin e rrezikut në rast katastrofash, por nuk janë zhvilluar ende trajnime.

**Niveli i zbatimit**

Në planin e veprimit të SKA-së është planifikuar që kjo masë të zbatohet përgjatë viteve 2023-2024.
**Kjo masë nuk ka filluar të zbatohet dhe nuk është përfshirë në vlerësim.**

**MasaA2.5.4 Zhvillimi i orëve praktike "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore" si pjesë e planit të shkollave.**

Të gjithë institucionet arsimore parauniversitare do të hartojnë planet e reagimit në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Treguesi**

**Numri i orëve praktike të nismës "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore".**

Ky tregues na jep numrin e orëve praktike të nismës për reagimin në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

**Analiza e masës**

Të gjitha institucionet arsimore parauniversitare hartojnë plan vjetor për "Reagimin në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore". Numri i orëve praktike nuk është e përcaktuar nga MAS-i, sepse secila shkollë e përcakton vetë sa orë praktike janë të nevojshme në varësi të tematikave të veprimtarive, formës kroskurrikulare ose ekstrakurrikulare të përfshirjes së tyre, si dhe në varësi të aktorëve që marrin pjesë për realizimin e tyre.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë për vitin 2022 është realizuar në masën 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A2.5.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A2.5.4** | Zhvillimi i orëve praktike "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore" si pjesë e planit të shkollave. | Numri i orëve praktike të nismës "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore". | 100% | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A2.5.4** | | **100%** | **5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.5**

**Përshkrimi i produktit**

Në lidhje me produktin: "Edukimi mbi reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore" në SKA janë synuar 4 masa, të shtrira në afatet kohore 2021-2026.

"Hartimi i planit kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore", 2021-2022.

"Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit dhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe komisionit të sigurisë dhe shëndetit në shkolla", 2022-2022.

"Forcimi i kapacitetit të shkollave, këshillit të prindërve dhe grupeve të fëmijëve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë", 2023-2024.

Zhvillimi i orëve praktike "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore" si pjesë e planit të shkollave", 2022-2026.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

ASCAP-i ka përgatitur një material ndihmës "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë", për shkollat me modelet e veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë. Moduli është akredituar nga KAPT-i.

Institucionet në varësi të MAS-it kanë hartuar paketat dhe modulet e trajnimit për menaxhimin e rrezikut në rast katastrofash, por nuk janë zhvilluar trajnime.

Të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar hartojnë plan vjetor për "Reagimin në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore". Numri i orëve praktike përcaktohet nga shkolla.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A2.5 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| A2.5. | Edukimi mbi reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore. | A2.5.1. Hartimi i planit kombëtar për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit arsimor ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore. | 5 |
| | | A2.5.2.Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit dhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe komisionit të sigurisë dhe shëndetit në shkolla. | 2.5 |
| | | A2.5.3.Forcimi i kapacitetit të shkollave, këshillit të prindërve dhe grupeve të fëmijëve për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat në shkollë. | - |
| | | A2.5.4. Zhvillimi i orëve praktike "Si të reagojmë në raste të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore" si pjesë e planit të shkollave. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A2.5** | | **4.1** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK A3: MËSUESIT**

**PRODUKTI A3.1 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE PËR FORMIMIN FILLESTAR TË MËSUESVE**

**Masa A3.1.1 Harmonizimi i kurrikulave të formimit fillestar të mësuesve në IAL, bazuar në kërkesat e ligjit të arsimit të lartë si dhe me kurrikulën që ofrohet në arsimin parauniversitar.**

Përshtatja e kurrikulave është një proces që duhet të bëhet në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me rekomandimet e BE-së , duke përcaktuar një balancë të drejtë midis përmbajtjes lëndore, asaj pedagogjike, si dhe punës praktike të integruar në programin e studimeve. Programet për formimin fillestar të mësuesve duhet t'i pajisin mësuesit e ardhshëm me kompetencat themelore, të nevojshme për mësimdhënie cilësore, por edhe t'i motivojnë ata që këto kompetenca t'i zhvillojnë edhe më tej gjatë karrierës së tyre. Po ashtu, mësuesit duhet të aftësohen të punojnë me grupe të ndryshme të nxënësve, përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara dhe ata nga grupet vulnerabël.

**Treguesi**

**Ngritja e grupeve të përbashkëta për hartimin e programeve për formimin fillestar të mësuesve në IAL, bazuar në kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe me kurrikulën në arsimin parauniversitar.**

Ky tregues jep fazën në të cilën ndodhet ngritja e grupeve të përbashkëta për hartimin e programeve dhe hartimi i programeve për formimin fillestar të mësuesve në IAL.

**Analiza e masës**

Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH" parashikon që mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" dhe diplomë të ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë "Master" me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.

Formimi i përgjithshëm psiko-pedagogjik përbën 25% e të gjithë kurrikulës në ciklin përkatës të studimit sipas profileve të mësuesve në arsimin parauniversitar.Në këtë kuadër, të gjitha fakultetet e edukimit do njësojnë lëndët që do të zhvillojnë në këtë formim, përmbajtja e të cilave duhet të jetë në të njëjtën linjë me kërkesat e arsimit parauniversitar për kompetencat e formimit të përgjithshëm të mësuesit.

Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues *të së njëjtës lëndë/profili të mësuesisë*, do të kenë së paku 80% të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. Në këtë kuadër me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 07.05.2018 "Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar u ngritën grupe pune pranë MAS. Në 14 grupet e punës u anagazhuan specialistë të arsimit të mesëm të ulët (AMU), specialistë të arsimit të mesëm të lartë (AML), në bashkëpunim me specialistë të arsimit të lartë (IAL), me qëllim që:

- Së pari, të gjitha fakultetet e mësuesisë të të njëjtit profil të njësojnë programin e studimit që formon mësues për të njëjtën lëndë/profil.
- Së dyti, të gjitha fakultetet e mësuesisë të të njëjtit profil të njësojnë në masën 80%

përmbajtjen e kurrikulës (lëndët dhe rezultatet e të nxënit) për formimin e mësuesit të së njëjtës lëndë/profil duke e harmonizuar me kurrikulën e arsimit parauniversitar.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.1.1** | Harmonizimi i kurrikulave të formimit fillestar të mësuesve në IAL, bazuar në kërkesat e ligjit të arsimit të lartë si dhe me kurrikulën që ofrohet në arsimin parauniversitar. | Ngritja e grupeve të përbashkëta për hartimin e programeve për formimin fillestar të mësuesve në IAL, bazuar në kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe me kurrikulën në arsimin parauniversitar. | 100% | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.1.1** | | **100%** | **5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.1**

**Përshkrimi i produktit**
Bazuar Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në programet e studimit në fushën e mësuesisë, si dhe në kushtet kur kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar përcakton kërkesa specifike përballë mësuesit. Harmonizimi i kurrikulave të formimit fillestar të mësuesve të IAL-ve, si dhe harmonizimi me kurrikulën që ofrohet në arsimin Parauniversitar mbetet detyrë parësore.

**Analiza e produktit**
Ka filluar puna për rishikimin e përmbajtjes dhe organizimit të kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve nga institucionet e arsimit të lartë, për të formuar mësues që janë në gjendje të zbatojnë kurrikulën bazuar në kompetenca. Sipas përcaktimeve në ligj, kurrikula e formimit fillestar të mësuesve përbëhet nga formimi i përgjithshëm psiko–pedagogjik dhe formimi shkencor i lëndës/profilit përkatës. Tashmë 14 grupe pune të IAL-ve kanë hartuar dhe dorëzuar në MAS raportet sipas profileve/lëndëve duke përcaktuar planet mësimore me lëndët, orët dhe kreditet përkatëse si dhe rezultatet e të nxënit për secilën lëndë. Puna vijon me vendimet e grupit qendror. Ky produkt është realizuar në nivelin 5.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.1. | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A3.1.** | Përmirësimi i cilësisë së programeve për formimin fillestar të mësuesve | Përmirësimi i cilësisë së programeve për formimin fillestar të mësuesve mësuesve në IAL, bazuar në kërkesat e ligjit të arsimit të lartë si dhe me kurrikulën që ofrohet në arsimin parauniversitar. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A.3.1.** | | **5** |



**PRODUKTI A3.2SHTIMI I MUNDËSIVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSUESVE**

**MasaA3.2.1 Zhvillimi i moduleve të trajnimit të bazuara në standardet profesionale të mësuesit dhe në koherencë me kurrikulën bazuar në kompetenca.**

MAS, në bashkëpunim me ASCAP-in, DPAP-në dhe IAL-të publike do të iniciojë zhvillimin e moduleve që janë me interes për zhvillimin profesional të mësuesve bazuar në raportin kombëtar të identifikimit të nevojave, duke u dhënë përparësi programeve që kontribuojnë në përmbushjen e standardeve profesionale të mësuesit dhe zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Edhe agjencitë trajnuese do të inkurajohen të zhvillojnë programe të tilla, ndërsa, aty ku paraqitet nevoja, pjesëmarrja e mësuesve në këto trajnime do të financohet nga fondet publike.

**Treguesi 1**

**Përqindja e mësuesve të arsimit fillor që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspekte pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës .**

Ky tregues do të na tregojë numrin e mësuesve me minimumin e trajnimit të detyruar në raport me numrin e të gjithë mësuesve të nivelit përkatës.

**Treguesi 2**

**Përqindja e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.**

Ky tregues do të na tregojë numrin e mësuesve me minimumin e trajnimit të detyruar në raport me numrin e të gjithë mësuesve të nivelit përkatës.

**Treguesi 3**

**Përqindja e mësuesve të arsimit të mesëm të lartë që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspekte pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës.**

Ky tregues do të na tregojë numrin e mësuesve me minimumin e trajnimit të detyruar në raport me numrin e të gjithë mësuesve të nivelit përkatës.

**Treguesi 4**

**Përqindja e mësuesve që kanë marrë trajnim në funksion të zhvillimit profesional gjatë punës në 12 muajt e fundit sipas llojit të trajnimit.**

Ky tregues do të na tregojë numrin e mësuesve që kanë marrë pjesë në trajnime gjatë 12 muajve të fundit në raport me numrin e përgjithshëm të mësuesve.

**Analiza e masës**

Në kuadër të zhvillimit të moduleve të trajnimit të bazuara në standardet profesionale të mësuesit dhe në koherencë me kurrikulën e re, për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë janë hartuar dhe janë akredituar me vendimin Nr. 3, datë 03.02.2021 të KAPT, 14 module trajnimi për zbatimin e standardeve profesionale të mësuesve, 12 module për përdorimin e TIK, sigurimin e cilësisë, gjithëpërfshirjen, si dhe

79 module trajnimi me vendimin Nr. 166 datë 20.05.2022 në zbatim të kurrikulës me kompetenca, gjithëpërfshirjes, digjitalizimit, shërbimit psiko-sociale etj, e realizuar nga ASCAP-i gjatë vitit 2021-2022. ASCAP-i ka hartuar standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor për mësuesit në sistemin e arsimit parauniversitar, që mund të përdoren si orientim për hartimin e programeve të reja për formimin fillestar të mësuesve, por edhe për vlerësimin e performancës së mësuesve, si dhe për përcaktimin e nevojave për zhvillim profesional. Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Rrjetet profesionale të mësuesve për çdo lëndë janë furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me materiale mbështetëse, shoqëruar me takime dhe trajnime për zbatimin e tyre. Aktualisht, janë 1200 rrjete profesionale, të cilat janë trajnuar për udhëzuesin e funksionimit të rrjeteve, për planifikimin e punës vjetore të rrjeteve, për mënyrën e raportimit, si dhe për tema përmbajtjesore.

Duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, MAS në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar mes palëve, kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurta - Oficerët e sigurisë në shkolla”. Aktualisht, janë trajnuar nga ASCAP rreth 140 oficerë të sigurisë në shkolla.

Prioritet i rëndësishëm gjatë këtyre viteve ka qenë mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të mësuesve ndihmës që tashmë janë pjesë e qenësishme e sistemit tonë arsimor. Puna për këta mësues filloi me krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Janë ngritur 61 rrjete profesionale, të cilat përfshijnë rreth 1176 mësues ndihmës në të gjithë vendin.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.2.1** | Shtimi i mundësive për zhvillimin profesional të mësuesve (aftësitë pedagogjike, kompetenca digjitale, arsimi gjithëpërfshirës). | Përqindja e mësuesve të arsimit fillor që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspekte pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës . | 100% | 5 |
| | | Përqindja e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës. | 100% | 5 |
| | | Përqindja e mësuesve të arsimit të mesëm të lartë që kanë marrë së paku minimumin e trajnimit të detyruar të mësuesve (p.sh. trajnim në aspekte pedagogjik) para emërimit në detyrë ose që janë në detyrë të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës. | 100% | 5 |
| | | Përqindja e mësuesve që kanë marrë trajnim në funksion të zhvillimit profesional gjatë punës në 12 muajt e fundit sipas llojit të trajnimit. | 100% | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.2.1** | | **100%** | 5 |

**Masa A3.2.2. Mbështetja e rrjeteve profesionale dhe anëtarëve të tyre, në veçanti rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në provimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS.**

Rrjetet profesionale ngrihen nga ZVAP-të dhe DRAP-të, në përputhje me prioritetet e tyre dhe mbështeten për mirëfunksionimin e tyre. Ndërkaq, për rrjetet nga fushat prioritare në nivel vendi do të hartohen udhëzime të veçanta dhe materiale ndihmëse nga ASCAP-i që të maksimizohet efekti i punës së tyre. Do të synohet aftësimi i Rrjeteve Profesionale në vlerësimin e arritjeve të nxënësve sipas modeleve të provimeve Ndërkombëtare si PISA, PIRLS dhe TIMSS.

**Treguesi 1**

**Numri i dokumenteve(literatura, materiale, etj) për mbështetjen e rrjeteve profesionale.**

Për këtë tregues janë hartuar 5 module për mësuesit e gjuhës dhe letërsisë, shkencave të natyrës (fizikë, kimi, biologji) dhe matematikë, në maj 2022, për të cilat do trajnohen 300 drejtues të rrjeteve profesionale për periudhën (tetor 2022-maj 2023) dhe do të mbështeten përreth 6000 mësues lidhur me zhvillimin e aftësive të provimeve ndërkombëtare të mësuesit.

**Treguesi 2**

**Numri i trajnimeve për kryetarët/ mësuesit që janë anëtar të rrjeteve profesionale.**

Për vitin shkollor 2021-2022, numri i rrjeteve profesionale dhe drejtuesve të tyre, është 1250 dhe numri i anëtarëve të përfshirë në këto rrjete është 28044.

**Analiza e masës**

Përveç testit PISA, në vitin 2019 Shqipëria ka marrë pjesë, për herë të parë, edhe në TIMSS (Prirjet e Studimit Ndërkombëtar në Matematikë dhe Shkencë), që mat arritjet e nxënësve në matematikë dhe shkenca. Nxënësit shqiptarë të klasave të katërta,nga 58 vende pjesëmarrëse, janë renditur në vendin e 39-të në matematikë (pa përfshirë në këtë renditje 6 entitetet). Edhe në fushën e shkencës**,** nga 58 vende pjesëmarrëse, Shqipëria është renditur në vendin e 39-të. Në vitin 2021, Shqipëria merr pjesë për herë të parë në PIRLS (Progresi i Studimit Ndërkombëtar në Lexim), i cili mat arritjet e nxënësve të klasave të katërta në lexim. ASCAP-i në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë për provimet ndërkombëtare ka hartuar dhe akredituar modulin e trajnimit "Zhvillimi i aftësive që kërkohen në provimin ndërkombëtar PISA, PIRLS dhe TIMSS", ku do të trajnohen rreth 300 drejtues të rrjeteve profesionale dhe do të mbështeten rreth 6000 mësues, lidhur me zhvillimin e aftësive të provimeve ndërkombëtare. Për këtë gjë janë hartuar materialet e trajnimit për lëndët gjuhë shqipe edhe letërsi, matematikë, biologji, kimi e fizikë. Janë trajnuar 43 drejtues të rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave për DRAP-in Lezhë. Për vitin shkollor 2021-2022, janë hartuar 5 moduleve për mësuesit e gjuhës shqipe dhe letërsisë, matematikës, fizikës, kimisë dhe biologjisë.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 80%.Kjo masë nuk është realizuar 100%, pasi po punohet për hartimin e udhëzuesit për lëndët e matematikës dhe shkencave të natyrës, për të cilat do të trajnohen në vazhdimësi mësuesit.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.2.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.2.2** | Mbështetja e rrjeteve profesionale dhe anëtarëve të tyre, në veçanti rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në provimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS. | Numri i dokumenteve (literatura, materiale, etj.) për mbështetjen e rrjeteve profesionale | **80%** | 4 |
| | | Numri i trajnimeve për kryetarët/ mësuesit që janë anëtar të rrjeteve profesionale. | **80%** | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.2.2** | | **80%** | **4** |

**Masa A3.2.3Nxitja e mobilitetit të mësuesve nëpërmjet pjesëmarrjes së institucioneve të arsimit parauniversitar në Erasmus+ dhe programe të tjera.**
Në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare Erasmus+ do të zhvillohet një fushatë informimi në shkolla për mundësitë e aplikimit në këtë program evropian, duke siguruar mundësi për bashkëpunim me shkolla nga vendet e tjera evropiane dhe mundësi për mobilitetin e mësuesve.

**Treguesi**
**Në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare Erasmus+ do të zhvillohet një fushatë informimi në shkolla për mundësitë e aplikimit në këtë program evropian, duke siguruar mundësi për bashkëpunim me shkolla nga vendet e tjera evropiane dhe mundësi për mobilitetin e mësuesve.**
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ASCAP, së bashku me IAL-të shqiptare si dhe ato evropiane, u përfshinë në projektin "Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve" (TEAVET). Ky projekt u financua nga Komisioni Evropian, programi Erasmus+.

**Analiza e masës**
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ASCAP, së bashku me 8 IAL-e shqiptare si dhe 3 IAL-e europiane, u përfshinë në projektin "Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve" (TEAVET). Ky projekt u financua nga Komisioni Europian, programi Erasmus+ dhe kishte si fokus kryesor ngritjen e kapaciteteve të stafeve akademike të IAL-ve shqiptare për trajnimin e mësuesve si dhe ngritjen e sistemit të trajnimit nëpërmjet qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës në këto IAL-e. MASR/ASCAP u përfshi në orientimin e IAL-ve për hartimin e moduleve të trajnimit (16 module trajnimi) në fushat: Të nxënit digjital, Strategjitë e mësimdhënie/nxënies, Qytetaria aktive, Gjithëpërfshirja në arsim, Kultura e të nxënit, Metodat e lexim-shkrimit etj.

**Niveli i zbatimit**

Lidhur me programin Erasmus+, nga grupi i monitorimit te SKA 2021-2026 për zhvillimin profesional te mësuesve, na është raportuar se nuk kanë pasur komunikim me zyrën e Erasmus.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.2.3. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.2.3.** | Nxitja e mobilitetit të mësuesve nëpërmjet pjesëmarrjes së institucioneve të arsimit parauniversitar në Erasmus+ dhe programe të tjera. | Në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare Erasmus+ do të zhvillohet një fushatë informimi në shkolla për mundësitë e aplikimit në këtë program evropian, duke siguruar mundësi për bashkëpunim me shkolla nga vendet e tjera evropiane dhe mundësi për mobilitetin e mësuesve. | 0% | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.2.3.** | | **0%** | **0** |

**Masa A3.2.4Z hvillimi profesional i mësuesve të diasporës.**

Do të zhvillohen trajnime ku do të marrin pjesë edhe mësues të diasporës që do të krijojnë mundësinë e ndarjes së përvojave dhe praktikave të mira.

**Treguesi**

**Numri i trajnimeve për mësuesit e diasporës.**

Organizimi i trajnimeve me tematika të ndryshme me mësues të diasporës, për krijimin e mundësive, për ndarjen e përvojave dhe praktikave më të mira mësimore.

**Analiza e masës**

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të vitit 2015, ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për arsimin të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", në vitin 2018 u finalizua "Kurrikula e përbashkët e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", e cila është nënshkruar nga ministrat e arsimit të të dy vendeve. Në zbatim të VKM Nr. 756, datë 29.09.2020, *"Për* funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për diasporën", Komisioni i Përbashkët Shqipëri- Kosovë, ka vijuar punën për të miratuar tekste mësimore të përbashkëta për diasporën, bazuar në kurrikulën e përbashkët. Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, janë hartuar dokumente të cilat u vijnë në ndihmë mësimdhënësve të diasporës si:

- programi i integruar i mësimit shqip në diasporë;
- veprimtari mësimore sugjeruese bazuar në kurrikulën e mësimit plotësues në diasporë;
- regjistri shtetëror i diasporës;
- seminare të përbashkëta organizuar nga ministritë e dy vendeve.

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është organizimi i mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë. Mësuesit e gjuhës shqipe në Diasporë tashmë nuk do të njihen vetëm si mësuesit vullnetarë të gjuhës shqipe të komuniteteve shqiptare pjesë e të cilëve janë, por ata do të jenë pjesë e një regjistri shtetëror, i cili garanton cilësinë e mësimdhënies në Diasporë. Regjistri i diasporës përmban listën e mësuesve, të cilët kanë të drejtë të japin mësim për programin e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë. Mësimdhënësit që do të angazhohen në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, duhet të kenë diplomë universitare në profilet përkatëse, si dhe të jenë të licencuar sipas legjislacioneve përkatëse nga palët. Në regjistrin shtetëror të diasporës nga viti 2019-2023 janë përfshirë 73 mësues të diasporës.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar 0%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.2.4. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.2.4.** | Zhvillimi profesional i mësuesve të diasporës. | Numri i trajnimeve për mësuesit e diasporës | 0% | 0 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.2.4.** | | 0% | **0** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.2**

**Përshkrimi i produktit**

Ky produkt përfshin zhvillimin e moduleve që janë me interes për zhvillimin profesional të mësuesve bazuar në raportin kombëtar të identifikimit të nevojave, duke u dhënë përparësi programeve që kontribuojnë në përmbushjen e standardeve profesionale të mësuesit dhe zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Edhe agjencitë trajnuese do të inkurajohen të zhvillojnë programe të tilla, ndërsa, aty ku paraqitet nevoja, pjesëmarrja e mësuesve në këto trajnime do të financohet nga fondet publike. Po ashtu parashikohet mbështetja e rrjeteve profesionale që ngrihen ngrihen nga ZVAP-të dhe DRAP-të, në përputhje me prioritetet e tyre. Në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare Erasmus+ është parashikuar të zhvillohet një fushatë informimi në shkolla për mundësitë e aplikimit në këtë program evropian, duke siguruar mundësi për bashkëpunim me shkolla nga vendet e tjera evropiane dhe mundësi për mobilitetin

e mësuesve. Gjithashtu është parashikuar të zhvillohen trajnime ku do të marrin pjesë edhe mësues të diasporës që do të krijojnë mundësinë e ndarjes së përvojave dhe praktikave të mira.

**Analiza e produktit**

Për shtimin e mundësive për zhvillimin profesional të mësuesve, ASCAP-i ka hartuar standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor për mësuesit në sistemin e arsimit parauniversitar, që mund të përdoren si orientim për hartimin e programeve të reja për formimin fillestar të mësuesve, por edhe për vlerësimin e performancës së mësuesve, si dhe për përcaktimin e nevojave për zhvillim profesional. Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Fuqizimi i këtyre rrjeteve profesionale ka qenë në vëmendje të veçantë të punës së ASCAP-it në procesin e zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat.

ASCAP-i në mbështetje të rrjeteve profesionale dhe anëtarëve të tyre, në veçanti të rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në provimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS ka organizuar trajnime të mësuesve.

Në kuadër të bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAP-i, së bashku me IAL-të shqiptare si dhe IAL-të europiane, u përfshinë në projektin "Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve" (TEAVET). Ky projekt u financua nga Komisioni Europian, programi Erasmus+ me fokus kryesor ngritjen e kapaciteteve të stafeve akademike të IAL-ve shqiptare për trajnimin e mësuesve si dhe ngritjen e sistemit të trajnimit nëpërmjet qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës në këto IAL. MAS dhe ASCAP u përfshi në orientimin e IAL-ve për hartimin e moduleve të trajnimit (16 module trajnimi) në fushat: Të nxënit digjital, Strategjitë e mësimdhënies/nxënies, Qytetaria aktive, Gjithëpërfshirja në arsim, Kultura e të nxënit, Metodat e lexim-shkrimit etj.

Ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është parashikuar gjithashtu që Ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për diasporën, të mbështesë zbatimin e programeve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët e diasporës, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Ministritë e arsimit dhe institucionet e diasporës në Shqipëri dhe Kosovë mbështesin mësimdhënien e gjuhës shqipe jashtë vendit përmes hartimit të kurrikulës, planeve dhe teksteve mësimore, si dhe pajisjes së nxënësve që mësojnë gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në mërgatë me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese falas.

Produkti është realizuar në nivelin 4.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.2. | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A3.2.** | Shtimi i mundësive për zhvillim profesional të mësuesve. (aftësitë pedagogjike, kompetenca digjitale, arsimi gjithëpërfshirës). | A3.2.1. Zhvillimi i moduleve të trajnimit të bazuara në standardet profesionale të mësuesit dhe në koherencë me kurrikulën bazuar në kompetenca. | 5 |
| | | A3.2.2.Mbështetja e rrjeteve profesionale dhe anëtarëve të tyre, në veçanti rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në provimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS. | 4 |
| | | A3.2.3. Nxitja e mobilitetit të mësuesve nëpërmjet pjesëmarrjes së institucioneve të arsimit parauniversitar në Erasmus+ dhe programe të tjera. | 0 |
| | | A3.2.4. Zhvillimi profesional i mësuesve të diasporës. | 0 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A3.2.** | | **2.25** |



**PRODUKTI A3.3. PËRMIRËSIMI I POZICIONIT TË MËSUESIT**

**MasaA3.3.1. Rritja e pagave të mësuesve.**
Për të përmirësuar në vazhdimësi pozicionin e mësuesit në shoqëri, deri në vitin 2025 pagat e mësuesve parashikohet të rriten deri me 40% në raport me nivelin e pagave në janarin e vitit 2021.

**Treguesi**
**Përqindja e rritjes së pagës së mësuesve**
Paga e mësuesve në sistemin parauniversitar për vitin 2022 është planifikuar të pësoj një rritje me 7% nga buxheti i shtetit.

**Analiza e masës**
MAS dhe ASCAP po punojnë për rishikimin e skemës së kualifikimit të mësuesve si dhe lidhjen me sistemin e karrierës, i cili është në proces deri në fund të vitit 2023. Për të përmirësuar pozicionin e mësuesit në shoqëri janë ndërmarrë masa nga qeveria për rritjen e pagave të arsimtarëve në sistemin parauniversitar. Paga e mësuesve deri në vitin 2025 parashikohet të rritet me 40%.Në 1 janar 2021 paga e mësuesve në sistemin parauniversitar u rrit në masën 15%. Paga mesatare bruto e mësuesve në shkollat 9-vjeçare në 2022 ishte 65.800 lekë dhe u bë 72.100 lekë. Një rritje kjo prej (6.300 lekësh). Paga mesatare bruto e mësuesve të gjimnazeve në 2020 ishte 68.800 lekë u bë 75.550 lekë. Një rritje kjo prej (6.750 lekësh) e mësuesve të kësaj kategorie. Në vitin 2022 u arrit rritja e pagave e të gjithë mësuesve në sistemin parauniversitar në masën **6%**. Ku paga mesatare bruto nga 72.000 lekë shkoi në 76.300, një rritje kjo me 4.300 lekë. Për vitin 2023 në lidhje me rritjen e pagës së mësuesve në sistemin parauniversitar është planifikuar në buxhet një rritje në masën 7%.

**Niveli i zbatimit**
Ky tregues është zbatuar në masën 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.3.1. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.3.1** | Rritja e pagave të mësuesve. | Përqindja e rritjes së pagës së mësuesve | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.3.1.** | | **100%** | **5** |

**Masa A3.3.2.Ndërtimi i një sistemi të ri të kualifikimit bazuar edhe në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë.**

Vlerësimi i performancës së mësuesit duhet të jetë i fokusuar në praktikat e mësimdhënies, si dhe të ofrojë informacion reflektues për identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional. Përveç kontrollit të dokumentacionit shkollor, vlerësimi i performancës së mësuesit duhet të përfshijë edhe vëzhgimin e mësuesit në klasë, si dhe kontrollin e portofolit që dokumenton praktikat e mësimdhënies. Që një sistem i tillë të jetë funksional, duhen hartuar udhëzues që bazohen në standardet e mësuesit dhe përmbajnë instrumente për vlerësimin e aspekteve të ndryshme të performancës, të cilat paraprakisht duhen pilotuar. Po ashtu, është me rëndësi ndërtimi i kapaciteteve të vlerësuesve dhe ofrimi i mbështetjes për ta nga specialistët e ASCAP-it.

**Treguesi**

**Përqindja e mësuesve që kanë plotësuar në nivel të lartë standardet profesionale të mësuesit dhe kanë përparuar në kategoritë e kualifikimit.**

Ky tregues na jep numrin e mësuesve që kanë avancuar në kategorinë e kualifikimit në raport me numrin e mësuesve që është pritur të avancojnë.

**Analiza e masës**

Procesi i kualifikimit të mësuesve në Republikën e Shqipërisë zhvillohet në mbështetje të Ligjit Nr. 69/2012, i ndryshuar, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;VKM Nr. 194, datë 22.4.1999, "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar", i ndryshuar dhe shtesa sipas kategorive përkatëse III (mësues i kualifikuar - 5 vjet punë si mësues), II (mësues specialist - 10 vjet punë si mësues) dhe I (mësues mjeshtër - 20 vjet punë si mësues); si dhe të Udhëzimit Nr. 4, datë 26.2.2021, të MAS-it, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve". Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit (përfshirë bonuset) dhe testin për profilin/lëndën përkatëse. Testi përmban formimin pedagogjik të mësuesit si dhe formimin shkencor të mësuesit që lidhet me njohuritë dhe aftësitë e mësuesit në lëndën përkatëse.

**Niveli i zbatimit**

Nuk është ndërtuar akoma një sistem i ri i kualifikimit bazuar edhe në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë.   Masa është realizuar 0%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A3.3.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A3.3.2.** | Ndërtimi i një sistemi të ri të ngritjes nga ana profesionale-kualifikimit të bazuar edhe në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë. | Përqindja e mësuesve që kanë plotësuar në nivel të lartë standardet profesionale të mësuesit dhe kanë përparuar në kategoritë e kualifikimit. | **0%** | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A3.3.2** | | **0%** | **0** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.2**

**Përshkrimi i produktit A3.3**

Përmirësimi i pozicionit të mësuesit do arrihet nëpërmjet rritjes së pagave dhe sistemit të kualifikimit. Paga e mësuesve deri në vitin 2025 do të rritet me 40% në raport me nivelin e pagave nga janari i vitit 2021. Në sistemin e arsimit parauniversitar në vitin 2022 paga mesatare bruto e mësuesve u rrit në masën 15% dhe në vitin shkollor 2023, pësoi një rritje me 7%.

Çdo vit për ngritjen profesionale të mësuesve ASCAP organizon procesin e kualifikimit të mësuesve në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; të VKM-së Nr. 194, datë 22.4.1999, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar; dhe shtesa sipas kategorive përkatëse III (mësues i kualifikuar - 5 vjet punë si mësues), II (mësues specialist - 10 vjet punë si mësues) dhe I (mësues mjeshtër - 20 vjet punë si mësues), të Udhëzimit Nr. 4, datë 26.2.2021, të MAS-it.Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit (përfshirë bonuset) dhe testin për profilin/lëndën përkatëse. Testi përmban formimin pedagogjik të mësuesit si dhe formimin shkencor të mësuesit që lidhet me njohuritë dhe aftësitë e mësuesit në lëndën përkatëse. Produkti është vlerësuar në nivelin 4.

**Analiza e produktit**

Është realizuar ndërtimi i një sistemi të ritëngritjes në karrierë të bazuar në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë. Për të përmirësuar pozicionin e mësuesit në shoqëri janë ndërmarrë masa nga qeveria për rritjen e pagave të arsimtarëve në sistemin parauniversitar. Paga e mësuesve deri në vitin 2025 parashikohet të rritet me 40%. Në vitin 2022 u arrit rritja e pagave e të gjithë mësuesve në sistemin parauniversitar në masën **6%**. Ku paga mesatare bruto nga 72.000 lekë shkoi në 76.300, një rritje kjo me 4.300 lekë. Për vitin 2023 në lidhje me rritjen e pagës së mësuesve në sistemin parauniversitar është

planifikuar në buxhet një rritje në masën 7%. Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit (përfshirë bonuset) dhe testin për profilin/lëndën përkatëse. Testi përmban formimin pedagogjik të mësuesit si dhe formimin shkencor të mësuesit që lidhet me njohuritë dhe aftësitë e mësuesit në lëndën përkatëse.

**Vlerësimi i realizimit të produktit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A3.3** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A3.3** | Përmirësimi i pozicionit të mësuesit nëpërmjet rritjes së pagave dhe sistemit të kualifikimit (ngritjes nga ana profesionale) bazuar në standardet e vlerësimit të mësuesve. | A3.3.1. Rritja e pagave të mësuesve. | 5 |
| | | A.3.3.2. Ndërtimi i një sistemi të ri të ngritjes nga ana profesionale-kualifikimit të bazuar edhe në vlerësimin e performancës së mësuesit në shkollë. | 0 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A3.3.** | | **2.5** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK A4: ZOTËRIMI I KOMPETENCAVE TË TË NXËNIT**

**PRODUKTI A4.1.PAJISJA E SHKOLLAVE ME MJETE MËSIMORE PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS**

**Masa A4.1.1 Përcaktimi i përmbajtjes minimale të paketës mësimore**.
Për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e kompetencave në sistemin arsimor parauniversitar është e rëndësishme të përdoret baza materiale didaktike. Përmbajtja minimale e paketës përcaktohet varësisht nga numri i nxënësve të grup moshave të ndryshme dhe nevojave të çdo lënde. Masa synon të përcaktohen elementet e paketës minimale që nevojiten për mbarëvajtjen e procesit mësimor në institucionet arsimore parauniversitare.

**Treguesi**
**Hartimi i paketave me specifikime didaktike të pajisjeve mësimore.**
Treguesi na përshkruan specifikimet didaktike të pajisjeve mësimore dhe pajisjeve laboratorike që duhet të përmbajë paketa për të lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe përvetësimin e kompetencave.

**Analiza e masës**
Në përfundim të vitit 2022 ASCAP-i ka hartuar specifikimet teknike për pajisjet laboratorike në lëndët fizikë, kimi dhe biologji, për Arsim Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë. Janë hartuar 6 (gjashtë) database me specifikime didaktike dhe laboratorike të pajisjeve mësimore për profilet (Fizikë-Kimi-Biologji) në AMU. Në listë përfshihen mjete didaktike konsumi me përdorim të përkohshëm dhe pajisje laboratorike të përhershme. Deri tani janë hartuar nga ASCAP-i paketat e nevojshme për zhvillimin normal të mësimit me bazë kompetencash për këto nivele shkollimi:
1. Lista e aparateve dhe kiteve laboratorike për lëndën e fizikës në arsimin parauniversitar, gjimnaz (AML) bazuar në katalogët e huaj të laboratorëve të shkencave të natyrës.
2. Katalogu i aparateve dhe kiteve laboratorike për lëndën e fizikës në arsimin parauniversitar, gjimnaz (AML).
3. Katalogu i aparateve dhe kiteve laboratorike për lëndën e fizikës në arsimin parauniversitar, gjimnaz (AMU). Hartimi i databazës me mjete didaktike është realizuar vetëm për lëndët fizikë, kimi dhe biologji dhe jo për 13 kurrikulat shkollore.

**Niveli i zbatimit**
Masa është realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.1.1** | Përcaktimi i përmbajtjes minimale të paketës mësimore. | Hartimi i paketave me specifikime didaktike të pajisjeve mësimore. | **50 %** | **2.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.1.1** | | **50 %** | **2.5** |

**Masa A4.1.2. Shpërndarja e paketave me mjete mësimore në shkolla.**
Institucionet përgjegjëse për shpërndarjen e paketave me mjete mësimore në shkolla dhe institucione parashkollore janë DPAP dhe MAS-i.

**Treguesi**
**Numri i paketave me mjete mësimore të shpërndara në shkolla dhe në institucione parashkollore.**
Ky tregues na jep numrin e paketave me mjete mësimore të shpërndara në shkolla dhe në arsimin parashkollor.

**Analiza e masës**
Shpërndarja e paketave mësimore kryhet mbi bazën e nevoja të institucioneve arsimore mbi bazën e një plani shpërndarjeje sipas ZVAP-ve përkatëse. Hartimi i paketës mësimore në ndihmë të zbatimit të procesit të mësimdhënies me kompetenca është kryer, por nuk është kryer shpërndarja e paketave me përmbajtje kurrikulën me kompetenca.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar në masën 40%.
**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.1.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.1.2** | Shpërndarja e paketave me mjete mësimore në shkolla. | Numri i paketave me mjete mësimore të shpërndara në shkolla dhe në institucione parashkollore. | **40%** | **2** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.1.2** | | **40%** | **2** |

**Masa A4.1.3 Mbështetja dhe këshillimi i mësuesve për përdorimin e paketave mësimore**.

Pajisja e shkollave me mjete dhe aparatura mësimore të teknologjive të përparuara, kërkon mësues të specializuar, me qëllim mirë përdorimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Për këtë arsye lind domosdoshmëria e trajnimeve të mësuesve. Në disa raste trajnimi mund të shoqërohet me hartimin e udhëzuesve për përdorimin e mjeteve që janë më specifike dhe, sipas nevojës, do të organizohen edhe sesione për këshillimin e mësuesve për përdorimin e tyre. Një formë tjetër e mundshme është hartimi i video-udhëzimeve për përdorimin e paketave mësimore.

**Treguesi**

**Numri i trajnimeve të mësuesve për përdorimin e paketave mësimore.**

Ky tregues na jep numrin e mësuesve të trajnuar për përdorimin e paketave mësimore, për zhvillimin e të mësuarit më kompetenca.

**Analiza e masës**

Deri në përfundim të vitit 2022 nuk është kryer trajnimi i mësuesve për përdorimin dhe mirëmbajtjen e paketa mësimore didaktike.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar në nivelin 0%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.1.3** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.1.3** | Mbështetja dhe këshillimi i mësuesve për përdorimin e paketave mësimore. | Numri i trajnimeve të mësuesve për përdorimin e paketave mësimore. | **0%** | **0** |
| | | Përqindje e mësuesve të trajnuar sipas cikleve për përdorimin e paketave mësimore. | **0%** | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.1.3** | | **0%** | **0** |

**Masa A4.1.4. Pasurimi i bibliotekave shkollore me libra artistikë, shkencorë dhe didaktikë.**

Nëpërmjet ZVAP-ve dhe DRAP-ve është parashikuar të merret informacion rreth pajisjes së shkollave në varësi të tyre me libra artistikë, shkencorë dhe didaktikë që u shtohen bibliotekave të.

**Treguesi**

**Numri i librave artistikë, shkencorë dhe didaktikë që janë shtuar në bibliotekat e shkollave.**

Ky tregues jep numrin e saktë të librave artistikë, shkencorë dhe didaktikë që shtohen çdo vit në bibliotekat e shkollave. Buxheti për pasurimin me libra artistike, shkencorë dhe didaktikë të bibliotekave shkollore për të dy nivelet e shkollimit, AMU dhe AML është 20 milionë lekë.

**Analiza e masës**

Në total numri i librave artistikë, shkencorë dhe didaktikë që janë shtuar në bibliotekat e shkollave në të katër DRAP-et është 16.868. Për vitin 2022 buxheti për pasurimin e bibliotekave shkollore me libra artistike shkencorë dhe didaktikë për AMU është 20 milionë lekë, janë realizuar 15.8 milionë lekë. Pra është realizuar në masën 79% e buxhetit të planifikuar për vitin 2022. Për arsimin e mesëm të lartë për vitin 2022 buxheti për biblioteka shkollore për pasurimin me libra artistike, shkencorë dhe didaktikë është 20 milionë lekë dhe janë realizuar 16.6 milionë lekë, pra në masën 83%.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar në nivelin 80 %.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.1.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.1.4** | Pasurimi i bibliotekave shkollore me libra artistikë, shkencorë dhe didaktikë. | Numri i librave artistikë, shkencorë dhe didaktikë që janë shtuar në bibliotekat e shkollave. | **80%** | **4** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.1.4** | | | **4** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.1**

**Përshkrimi i produktit**

Zhvillimi i orëve mësimore në lëndët fizikë, kimi, matematikë, biologji etj, do të jenë më rezultateve nëse eksperimentohen në kushte konkrete laboratorike. Po kështu edhe përdorimi i smartboard-ve, video projektorëve në lëndët e gjuhës, histori, gjeografi, qytetari etj, zhvillon kompetencat e komunikimit e të shprehurit, kompetencat e të menduarit, etj. Për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e kompetencave në sistemin arsimor parauniversitar është e rëndësishme të përdoret baza materiale didaktike. Institucionet përgjegjëse për shpërndarjen e paketave me mjete mësimore në shkolla dhe institucione parashkollore janë DPAP dhe MAS-i. Pajisja e shkollave me mjete dhe aparatura mësimore të teknologjive të përparuara, kërkon mësues të specializuar, me qëllim mirë përdorimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Për këtë arsye lind domosdoshmëria e trajnimeve të mësuesve. Në disa raste trajnimi mund të shoqërohet me hartimin e udhëzuesve për përdorimin e mjeteve që janë më specifike dhe, sipas

nevojës, do të organizohen edhe sesione për këshillimin e mësuesve për përdorimin e tyre. Një formë tjetër e mundshme është hartimi i video-udhëzimeve për përdorimin e paketave mësimore.

**Analiza e produktit**

Në përfundim të 2022 ASCAP-i ka hartuar specifikimet teknike për pajisjet laboratorike në lëndët fizikë, kimi dhe biologji, për Arsim Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë. Hartimi i database-ve me specifikime teknike të pajisjeve dhe kiteve laboratorike dhe laboratorike të pajisjeve mësimore për profilet Fizikë-Kimi-Biologji në AMU. Në listë përfshihen mjete didaktike konsumi me përdorim të përkohshëm dhe pajisje laboratorike të përhershme. Nuk janë shpërndarë në institucionet arsimore paketat e planifikuara. Nuk është kryer trajnimi i mësuesve për përdorimin e paketave mësimore. Janë zhvilluar procedurat e tenderimit për fondin e bibliotekave në 4 DRAP-e dhe janë lidhur kontrata me shtëpitë botuese.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.1** | Pajisja e shkollave me mjete mësimore për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | A4.1.1 Përcaktimi i përmbajtjes minimale të paketës mësimore. | 2.5 |
| | | A4.1.2 Shpërndarja e paketave me mjete mësimore në shkolla | 2 |
| | | A4.1.3 Mbështetja dhe këshillimi i mësuesve për përdorimin e paketave mësimore. | 0 |
| | | A4.1.4 Pasurimi i bibliotekave shkollore me libra artistikë, shkencorë dhe didaktikë | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.1** | | **2.1** |



**PRODUKTI A4.2 MBËSHTETJE E VAZHDUESHME PËR MËSUESIT PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË RE**

Në procesin e zbatimit të kurrikulës me kompetenca, në mbështetje të institucioneve arsimore dhe stafeve mësimdhënëse një ndikim jo të vogël ka edhe puna e njësive arsimore vendore e qendrore në drejtim të këshillimeve të vazhdueshme, monitorimeve dhe vlerësimeve që kryejnë në mënyrë të herëpashershme.

**Masa A4.2.1 Përmirësimi/Hartimi i udhëzuesve për monitorimin e zbatimit të kurrikulës në nivel institucioni arsimor, si në nivel lokal dhe qendror.**

Nisur nga reformat e ndërmarra në arsimin parauniversitar, lindi e nevojshme hartimi i udhëzuesve, të cilët do t'u vinin në ndihmë institucioneve arsimore për të bërë vetëvlerësim të praktikave të veta si dhe institucioneve përgjegjëse, si: DPAP-së, ASCAP, DRAP-eve dhe ZVAP-eve për të kryer monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të institucioneve arsimore në drejtim të zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat.

**Treguesi**

**Udhëzues në mbështetje të mësuesve për zbatimin e kurrikulës**

Këta udhëzues do t'u shërbejnë vlerësuesve/inspektorëve, drejtuesve, mësuesve dhe aktorëve të tjerë për të vlerësuar cilësinë e shkollës, me qëllim sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës për veprimtarinë mësimore-edukative.

**Analiza e masës**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të Urdhër Nr. 268, datë 28.8.2020 "Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës" u miratua paketa e vlerësimit të cilësisë së shkollës, e cila përmban këto produkte:

a. Kornizën e vlerësimit të cilësisë.
b. Vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës
c. Metodologjinë e vlerësimit të brendshëm të shkollës.
d. Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të shkollës.

Udhëzuesi "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës" mundëson realizimin e vlerësimit të jashtëm, të vlerësimit të brendshëm, ndërlidhjen midis tyre, si dhe përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të shkollës. Përvojat e deritanishme dëshmojnë efektivitetin e lidhjes mes dy vlerësimeve, në kuptimin e përdorimit të së njëjtës gjuhë standarde vlerësimi. Aktorët vlerësues, jashtë dhe brenda shkollës, përcaktojnë vlerat për informacionin e grumbulluar nga procesi i matjeve, me element kryesor gjykimin. Shkollat e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri, në aspektin vertikal të llogaridhënies, raportojnë në nivelin lokal në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) përkatëse.

ZVAP-të dhe DRAP-et raportojnë në nivel kombëtar te Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP). Nga ky këndvështrim, vlerësimi i jashtëm, vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi krahasues (Karta e Performancës) janë mënyrat kryesore, se si realizohet raportimi dhe mundësohet llogaridhënia. Gjithashtu, në aspektin horizontal të llogaridhënies, sistemi i vlerësimit, përmes raportimeve, informon prindërit, nxënësit dhe palët e interesuara për cilësinë e shërbimit të ofruar nga shkolla.

**Niveli i zbatimit**
Procesi i hartimit të udhëzuesve në mbështetje të mësuesve për zbatimin e kurrikulës konsiderohet i realizuar në masën 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.2.1** | Përmirësimi/Hartimi i udhëzuesve për monitorimin e zbatimit të kurrikulës në nivel institucioni arsimor, si dhe në nivel lokal dhe qendror. | Udhëzues në mbështetje të mësuesve për zbatimin e kurrikulës. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.2.1** | | **100%** | **5** |

**Masa A4.2.2. Forcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorët e kurrikulës në nivel të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në funksion të mbështetjes së shkollave për zbatimin e kurrikulës me kompetenca.**
Instalimi i strukturës së re qeverisëse në arsimin parauniversitar konsiderohet si arritje, sepse sjell monitorimin, vlerësimin, inspektimin më afër shkollës. Zbatimi i detyrave të parashtruara në SKA për vënien në zbatim të kurrikulës me kompetenca, sjell si domosdoshmëri plotësimin e njësive arsimore përkatëse me burime njerëzore përkatëse për të kryer këtë proces.

**Treguesi**
**Numri i specialistëve në sektorët e kurrikulës në DRAP-e dhe ZVAP-e të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca**.
Treguesi na jep mundësi të marrim informacion mbi numrin e specialistëve të DRAP-e dhe ZVAP-e të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca, pra numrin e inspektorëve që kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara brenda vitit në raport me numrin e përgjithshëm të inspektorëve (specialistëve).

**Analiza e masës**
Sipas organikës, DPAP-ja duhet të ketë 261 specialistë në sektorët e monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional të nivelit qendror, rajonal dhe vendor: 239 specialistë në 52 ZVAP-të, 16 specialistë në katër DRAP-e dhe 6 në Drejtorinë Qendrore të DPAP-së. ASCAP-i do të ofrojë mbështetje të vazhduar për zhvillimin e kapaciteteve të specialistëve në sektorët e kurrikulës në DRAP-e dhe ZVAP, si dhe këshillime të vazhdueshme për DPAP në mënyrë që të mund të ofrojnë mbështetje efektive për shkollat për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. Megjithatë, strukturat e DPAP-së janë ende në proces të

plotësimit me personel sipas skemës së re organizative. Veprimtaria është planifikuar të përfundojë në fund të vitit 2024.

Në përfundim të vitit 2022 në institucionet e varësisë së DPAP-së kanë qenë të punësuar 250 punonjës në sektorët e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga 261 që përmban organika (95%, ose 11 specialistë më pak e organikës nga numri i përcaktuar në organikë) përkatësisht 6 në DPAP, 14 specialistë në katër DRAP-e nga 16 që duhet të ishin (87%) dhe 230 në 52 ZVAP-të nga 239 që duhet të ishin (dmth 96%). Nga informacionet e vjela nga DPAP përgjithësisht të gjithë specialistët që i përkasin sektorit të kurrikulës në DRAP-e dhe ZVAP-e janë të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca.

Përveç kësaj, për të fuqizuar aftësitë dhe kapacitetet vlerësuese e monitoruese është miratuar nga MAS udhëzimi nr. 10, nr. Prot. 2830/2 datë 06.05.2022 “Për ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të rrjetit kombëtar të monitoruesve dhe vlerësuesve në bazë risku për institucionet arsimore parauniversitare. Deri në përfundim të vitit 2022 ASCAP-i ka trajnuar rreth 330 specialistë të njësive arsimore vendore, drejtues të shkollave, mësues për vlerësimin e zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Janë trajnuar dhe certifikuar 337 vlerësues nga 300 vlerësues që ishte parashikimi.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.2.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.2.2** | Forcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorët e kurrikulës në nivel të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në funksion të mbështetjes së shkollave për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | Numri i specialistëve në sektorët e kurrikulës në DRAP-e dhe ZVAP-e të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.2.2** | | **100%** | **5** |

**Masa A4.2.3 Monitorimi sistematik i zbatimit të kurrikulës.**

Masa na mundëson marrjen e informacioneve mbi monitorimet e kryera në institucionet arsimore në raport me numrin e përgjithshëm të shkollave. Procesi i monitorimit do të organizohet nga DPAP-ja, nëpërmjet DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në bazë të udhëzimeve të hartuara nga ASCAP-i.

**Treguesi**
**Numri i monitorimeve të bëra në shkolla për zbatimin e kurrikulës me kompetenca.**
Ky tregues na jep numrin e shkollave që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm të paktën një herë gjatë 3 viteve të fundit në raport me numrin e përgjithshëm të shkollave.

**Analiza e masës**
Në përshtatje me skemën e re të vlerësimit të institucioneve arsimore ASCAP-i dhe DPAP-ja kanë bashkëpunuar në hartimin e protokolleve për inspektim/vlerësim dhe në ngritjen e kapaciteteve inspektuese/vlerësuese. Sipas raportit të realizimit të detyrave të ngarkuara për periudhën janar - dhjetor 2022, të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë, rezulton se në vitin 2022 janë realizuar 34 vlerësime të plota të IAP-ve publike dhe private, nga 30 që ishin planifikuar të vlerësoheshin, ku u vëzhguan dhe vlerësuan mbi 700 orë mësimore. U hartuan raportet e vlerësimit të plotë për secilën shkollë dhe u hartua raporti përmbledhës për vlerësimin e 34 institucioneve arsimore parauniversitare, i cilin u raportua në MAS.

**Niveli i zbatimit**
Masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.2.3 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.2.3** | Monitorimi sistematik i zbatimit të kurrikulës. | Numri i monitorimeve të bëra në shkolla për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.2.3** | | **100%** | **5** |

**Masa A4.2.4. Këshillimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulës**
Qëllimi i zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë në institucionet arsimore parauniversitare është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave në mënyrë që t'u sigurojnë nxënësve shërbim arsimor cilësor. Trajnimi do të konsiderohet si i tillë në të gjitha format e zbatimit: trajnimet; rrjetet profesionale. këshillimet, kurset afatshkurtra dhe afatgjata. Përveç kësaj specialistët e kurrikulave nga ZVAP-të do të kryejnë vizita në shkolla për t'i mbështetur mësuesit në klasat e tyre nëpërmjet udhëzimeve praktike, në mënyrë që ata të ndihen të mbështetur për nevojat e tyre dhe të zbatojnë me efektivitet kurrikulën.

**Treguesi**

**Numri i mësuesve të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në të gjithë përbërësit e saj.**

Ky tregues do të na paraqesë numrin e mësuesve që kanë marrë pjesë në trajnime për zhvillimin profesional për njohjen dhe zbatimin e kurrikulës me kompetenca në të gjithë përbërësit e saj gjatë vitit 2022 në raport me numrin e përgjithshëm të mësuesve.

**Analiza e masës**

Procesi i zbatimit të kurrikulës është shoqëruar me monitorimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të mësuesve dhe të shkollave nga ASCAP-i. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe dhe në vazhdim, nga specialistët e ASCAP-it janë zhvilluar takime të vazhdueshme me mësues, drejtues dhe specialistë të drejtorive arsimore, në lidhje me vlerësimin e ecurisë së zbatimit të kurrikulës, identifikimit të problematikave, mbështetjes së mësuesve dhe drejtuesve, si dhe evidentimit dhe shkëmbimit të përvojave pozitive. Deri në përfundim të vitit 2022 janë trajnuar22366 mësues në raport me 28921 për tema të ndryshme lidhur me kurrikulën e re edhe është ende në proces për të vazhduar gjatë vitit 2023.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 70%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.2.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.2.4** | Këshillimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulës. | Numri i mësuesve të përfshirë në aktivitete këshillimi dhe monitorimi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në të gjithë përbërësit e saj. | **70%** | **3.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.2.4** | | **70%** | **3.5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.2**

Është miratuar paketa e vlerësimit të cilësisë së shkollës me dokumente shërbejnë për t'u ardhur në ndihmë vlerësuesve/inspektorëve, drejtuesve, mësuesve dhe aktorëve të tjerë për të vlerësuar cilësinë e shkollës, me qëllim sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës për veprimtarinë mësimore-edukative. Në përfundim të vitit 2022 në institucionet e varësisë së DPAP-së kanë qenë të punësuar 250 punonjës në sektorët e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga 261 që përmban organika (95% e organikës) përkatësisht 6 në DPAP, 14 specialistë në katër DRAP-e nga 16 që duhet të ishin (87%) dhe 230 në 52 ZVAP-të nga 239 që duhet të ishin (d.m.th 96%).Strukturat e institucione arsimore qendrore dhe

vendore DRAP-et dhe ZVAP-et janë ende në proces të plotësimit me personel sipas skemës së re organizative. Deri në përfundim të vitit 2022 ASCAP-i ka trajnuar dhe certifikuar rreth 330 specialistë të njësive arsimore vendore, drejtues të shkollave, mësues për vlerësimin e zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Deri në përfundim të vitit 2022 janë trajnuar22366 mësues në raport me 28921 për tema të ndryshme lidhur me kurrikulën e re (78%) e mësuesve që janë në sistem edhe është ende në proces për të vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Mbështetje e vazhdueshme për mësuesit për zbatimin e kurrikulës së re është realizuar në masën 93%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.2 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.2** | Mbështetje e vazhdueshme për mësuesit për zbatimin e kurrikulës së re | A4.2.1 Përmirësimi/Hartimi i udhëzuesve për monitorimin e zbatimit të kurrikulës në nivel institucioni arsimor, si në nivel lokal dhe qendror. | 5 |
| | | A4.2.2 Forcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorët e kurrikulës në nivel të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në funksion të mbështetjes së shkollave për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | 5 |
| | | A4.2.3 Monitorimi sistematik i zbatimit të kurrikulës. | 5 |
| | | A4.2.4 Këshillimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulës. | 3.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.2** | | **4.6** |



**PRODUKTI A4.3. PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE TË NXËNËSVE NË LEXIM-SHKRIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË**

**Masa A4.3.1 Mbështetja e zbatimit të praktikave të reja të vlerësimit të nxënësve.**
Në përputhje me rekomandimet e OECD-së, do të mbështeten mësuesit në mënyrë të vazhdueshme, duke vënë theksin në vlerësimin formues dhe mënyrën e shfrytëzimit të rezultateve të tij për të përmirësuar të nxënit.

**Treguesi**
**Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për udhëzuesin e ri të vlerësimit të nxënësve.**
Ky tregues do të na mundësojë vjeljen e informacionit të plotë mbi numrin e trajnimeve të realizuar të drejtuesve të rrjeteve profesionale kryetarët/ mësuesit që janë anëtarë të rrjeteve profesionale, lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë.

**Analiza e masës**
Me ndryshimet kurrikulare, në zbatim të Udhëzimit Nr. 17 datë 5.7.2022 "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar" doli si domosdoshmëri njohja e mësuesve me praktikat e reja të vlerësimit të nxënësve në mësimdhënien me bazë kompetencash. Fillimisht me udhëzuesin e ri të vlerësimit të nxënësve dhe praktikat e reja të vlerësimit u la si detyrë të trajnoheshin drejtuesit e rrjeteve profesionale e më pas do trajnohen të gjitha stafet mësimore. Për këtë Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit ka planifikuar për vitin 2022 hartimin e materialeve mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve dhe lëndëve përkatëse, produkte që janë planifikuar për të mbështetur drejtuesit e rrjeteve profesionale dhe mësuesit. Janë realizuar trajnimet për 125 vlerësues të jashtëm.

**Niveli i zbatimit**
Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për udhëzuesin e ri të vlerësimit të nxënësve është realizuar në masën 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.3.1** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.3.1** | Mbështetja e zbatimit të praktikave të reja të vlerësimit të nxënësve. | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për udhëzuesin e ri të vlerësimit të nxënësve. | **100 %** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.3.1** | | **100 %** | **5** |

**Masa A4.3.2. Hartimi i udhëzuesve dhe materialeve ndihmëse për mësues për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës.**

ASCAP-i, në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse, do të hartojë materiale ndihmëse për mësuesit për fushat prioritare të kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë dhe Shkencat e natyrës. Materialet ndihmëse do të ofrojnë udhëzime për zhvillimin e aftësive të lexim-shkrimit, matematikore dhe shkencore te nxënësit, si dhe për vlerësimin e tyre.

**Treguesi 1**

**Hartimi i moduleve të trajnimit për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës**

Paraqet numrin e moduleve, materialeve ndihmëse të hartuara nga ASCAP për mësuesit për fushat prioritare të kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë dhe Shkencat e natyrës.

**Treguesi 2**

**Rezultatet e nxënësve 15-vjeçar në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca**

Treguesi do të na paraqesë rezultatet e nxënësve 15-vjeçar në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca. Treguesi është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor, është tregues i përdorur në SKA. Burimi i informacionit MAS, QSHA.

**Treguesi 3**

**Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve në fund të (a) arsimit fillor dhe (b) të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë.**

Treguesi jep përqindjen e fëmijëve dhe të rinjve në fund të (a) arsimit fillor dhe (b) të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë. Treguesi është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor, është tregues i përdorur në SKA. Burimi i informacionit MAS, QSHA.

**Analiza e masës**

ASCAP-i ka hartuar në vitin 2022 materiale mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve dhe lëndëve përkatëse. Kanë përfunduar trajnimet për këto rrjete profesionale ku janë trajnuar 90 drejtues rrjetesh të profileve (Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Biologji, Kimi, Fizikë). Janë hartuar 5 module për secilën lëndë, të cilat u janë prezantuar drejtuesve të rrjeteve për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës. ASCAP-i ka përgatitur një paketë materialesh mbështetëse për përdorimin e platformave online me simulime PHET, për mësimdhënien dhe mësimin e shkencave natyrore dhe matematikës në AMU dhe AML, si dhe 4 module trajnimi dhe udhëzues për të mbështetur mësuesit e shkencave natyrore dhe matematikës. ASCAP-i në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse, ka hartuar të gjitha modulet dhe materialet ndihmëse të parashikuara (100%) për mësuesit për fushat prioritare të kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë dhe Shkencat e natyrë, të cilat do të ofrojnë udhëzime për zhvillimin e aftësive të lexim-shkrimit, matematikore dhe shkencore të nxënësit, si dhe për vlerësimin e tyre. ASCAP-i është angazhuar edhe në hartimin e programit orientues për provimin kombëtar të arsimit fillor (PKAF). ASCAP-i planifikoi hartimin e një materiali mbështetës për mësuesit e arsimit fillor, me qëllim që mësuesit të kuptojnë më mirë synimin dhe kërkesat e programit orientues (PKAF) dhe nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën të familjarizohen me natyrën e pyetjeve që përmban testimi VANAF. Programi orientues ka si qëllim të orientojë punën e mësuesit, përgatitjen e

nxënësve dhe hartuesit e testeve për VANAF. Programi përfshin konceptet, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit në Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre në përfundim të arsimit fillor.

Rezultatet e nxënësve 15-vjeçar në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca evidentohen në çdo tri vite nëpërmjet testimit të PISA-s. Vlerat e vlerësimeve të fundit të publikuara për rezultatet e testimit 2018 janë: Lexim: 405 pikë, Matematikë: 437 pikë dhe Shkenca natyrore: 417 pikë. Vlerat aktuale në total sipas gjinive janë: Lexim: 58.0 (F), 37.9 (M); Matematikë: 59.4 (F), 55.9 (M).Vlerat e synuara për t'u arritur janë, në mesataren e vendeve të OECD-së. Rezultatet e nxënësve në testimin e PISA-2022 ende nuk janë bërë publike si rrjedhojë nuk mund t'i paraqesim në analizën e Raportit të Vlerësimit.

Lidhur me rezultatet e fëmijëve dhe të rinjve në fund të (a) arsimit fillor dhe (b) të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë nuk kemi pasur informacion nga institucionet përkatëse.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë konsiderohet e realizuar 80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.3.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.3.2** | Hartimi i udhëzuesve dhe materialeve ndihmëse për mësues për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës. | 1. Hartimi i moduleve të trajnimit për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës | **80%** | **4** |
| | | 2. Rezultatet e nxënësve 15-vjeçar në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca. | **-** | **-** |
| | | 3. Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve në fund të (a) arsimit fillor dhe (b) të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë. | **-** | **-** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.3.2** | | **80%** | **4** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.3**

**Përshkrimi i produktit**

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat dhe nga detyrat më themelore që kërkon sistemi ynë arsimor. Nëpërmjet tij ne marrim informacion rreth përparimit të nxënësve. Vlerësimi fokusohet në zbatimin e standardeve dhe pritshmërive të progresit dhe arritjes së nxënësve në njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Vlerësimi mbështetet në vlerësimin e brendshëm: Maturën Shtetërore (MSH); provimet kombëtare të arsimit bazë (PKB), provimet e arsimit fillor (VANAF) si dhe vlerësimi i jashtëm, testimi PISA.

**Analiza e produktit**

ASCAP ka hartuar materiale mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve përkatëse. Janë trajnuar 90 drejtues rrjetesh të profileve (Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Biologji, Kimi, Fizikë). Janë hartuar 5 module për secilën lëndë, të cilat u janë prezantuar drejtuesve të rrjeteve të lëndëve, për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës. ASCAP-i ka përgatitur një paketë materialesh mbështetëse për përdorimin e platformave online me simulime PHET, për mësimdhënien e shkencave natyrore dhe matematikës në AMU dhe AML. ASCAP-i është angazhuar edhe në hartimin e programit orientues për provimin kombëtar të arsimit fillor (PKAF). Ky program nuk arriti të përfundonte në fund të vitit 2022, siç ishte parashikuar. Lidhur me rezultatet e fëmijëve dhe të rinjve në fund të (a) arsimit fillor dhe (b) të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim dhe matematikë, sipas gjinisë nuk kemi pasur informacion nga institucionet përkatëse.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.3** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.3** | Përmirësimi i aftësive të nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkencë. | A4.3.1 Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për udhëzuesin e ri të vlerësimit të nxënësve. | 5 |
| | | A4.3.2 Hartimi i udhëzuesve dhe materialeve ndihmëse për mësues për fushat e gjuhës dhe komunikimit, matematikës dhe shkencave të natyrës. | 4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.3** | | **4.5** |



**PRODUKTI A4.4.SIGURIMI I BESUESHMËRISË SË PROVIMEVE KOMBËTARE**

**Masa A4.4.1 Përmirësimi i administrimit dhe cilësisë së provimeve/ vlerësimeve kombëtare bazuar në kompetenca. Analizë e detajuar e provimeve/ vlerësimeve kombëtare ndër vite me qëllim identifikimin e problematikave dhe rishikimin e plotë të të gjithë procesit të provimeve/ vlerësimeve kombëtare, akteve rregullatore dhe administrimin e tyre.**

Nxjerrja e të dhënave të besueshme mbi rezultatet e të nxënit në nivel sistemi dhe shkolle nëpërmjet vlerësimeve të konsoliduara, përmirësimit të besueshmërisë, përmirësimit të cilësisë së korrigjimit.

**Treguesi 1**
**Përmirësimi i akteve rregullator dhe administrimit të provimeve kombëtare.**
Ky tregues na jep të dhëna për ndryshimet e akteve rregullator në funksion të përmirësimit të administrimit të provimeve kombëtare.

**Treguesi 2**
**Përmirësimi i hartimit të testeve kombëtare dhe kritereve të korrigjimit.**
Ky tregues na jep të dhëna për cilësinë e hartimit të provimeve kombëtare dhe korrigjimin e tyre.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.4.1** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.4.1** | Përmirësimi i administrimit dhe cilësisë së provimeve/vlerësimeve kombëtare bazuar në kompetenca. Analizë e detajuar e provimeve/ vlerësimeve kombëtare ndër vite me qëllim identifikimin e problematikave dhe rishikimin e plotë të të gjithë procesit të provimeve/vlerësimeve kombëtare, akteve rregullator dhe administrimin e tyre. | Përmirësimi i akteve rregullator dhe administrimit të provimeve kombëtare. | 80% | **4** |
| | | Përmirësimi i hartimit të testeve kombëtare dhe kritereve të korrigjimit. | 60% | **3** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.4.1** | | **70%** | **3.5** |

**Analiza e masës**
Matura Shtetërore dhe provimet kombëtare të arsimit bazë janë provimet kombëtare me rëndësi të lartë për arsimin parauniversitar. QSHA-ja përgatit raporte periodike të Maturës Shtetërore që kanë si qëllim njohjen e nivelit të arritjeve të nxënësve maturantë të sistemit arsimor kombëtar në tërësi, bazuar në

rezultatet e një vlerësimi të jashtëm të standardizuar. Tashmë, kemi një matje më të thelluar të aftësive që pritet të zotërojnë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Kështu, testet e Maturës Shtetërore afrohen shumë me metodologjitë e ndërtimit të testeve bashkëkohore. Në kuadër të përmirësimit të administrimit të procesit të MSH 2022 janë trajnuar 3514 drejtues, mësues, psikologë dhe punonjës socialë, të cilët administruan të gjitha qendrat e provimit. Përfaqësuesit e MAS-it monitoruan me korrektësi 395 qendra provimi ku morën pjesë 29159 nxënës. Megjithë, masat e marra nga MAS vihet re se ka patur neglizhencë nga përgjegjësit e administrimit dhe monitoruesit, pasi janë vendosur si monitorues të provimeve të Maturës Shtetërore, oficerët e sigurisë së shkollës apo punonjës socialë të patrajnuar më parë për rëndësinë dhe rolin e tyre gjatë procesit të provimit. Gjithashtu, një pjesë e mësuesve të përzgjedhur për të administruar procesin heqin dorë mëngjesin e ditës së provimit, gjë e cila sjell vonesa në fillimin e procesit.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 70%.

**Masa A4.4.2. Përgatitja e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore dhe për provimet kombëtare të arsimit bazë.**
Hapat që ndërmarrin institucionet arsimore për parapërgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore.

**Treguesi**
**Përputhshmëria e rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore me rezultatet e vitit.**
Ky tregues na jep të dhëna krahasuese midis notës vjetore dhe notës në MSH.

**Analiza e masës**
Referuar rezultateve të MSH 2022 konstatohet se në lëndën e gjuhës shqipe 13.71% e nxënësve kanë pasur vlerësimin vjetor notën 10, ndërsa në provimin e Maturës Shtetërore e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10 vetëm 2.68%, ashtu sikundër 0.64%e nxënësve të vlerësuar me notën vjetore 5 janë vlerësuar në provimin e Maturës Shtetërore me notën 9 (diferenca me 4 nota) dhe 7.19% e nxënësve kanë kaluar nga nota 5 në notën 7 dhe 8 (diferenca me 2 dhe 3 nota).
Paqëndrueshmëri të theksuara konstatohen edhe në lëndën e Matematikës ku nga 10.48% e nxënësve me notën vjetore 10, vetëm 6.10 e ruajnë këtë rezultat. 0.16% e nxënësve kanë kaluar nga nota 5 në notën 10, (diferenca me 5 nota); 0.52% nga nota 6 në 10 (diferenca me 4 nota). Këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, në provimin e Maturës Shtetërore janë vlerësuar edhe me notën 5, 6, 7, 8. Problematike është dukuria që një nxënës i vlerësuar me 10 gjatë procesit mësimor në provimin e Maturës Shtetërore është ulur në vlerësim me 3 deri në 4 nota.
Qëndrueshmëria e arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës kundrejt arritjeve vjetore, shihet se në lëndën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe ku nxënësit e arsimit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/meshkuj, si dhe qytet/fshat, ndërsa në lëndën e matematikës dhe gjuhës së huaj nxënësit e sistemit privat kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit publik.
Dukuria e pranisë së rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore 2022 me një ndryshim

prej më shumë ose më pak 2, 3 ose 4 nota kundrejt rezultateve vjetore të tyre, tregon për paqëndrueshmërinë e arritjeve të tyre. Nga krahasimi i të dhënave me Maturën e vitit të kaluar, në sesionin e parë për të gjitha lëndët e MSH 2022 rezulton:

- kalueshmëria në provim, me një rritje prej 0.08 %;
- nota mesatare në provimin e maturës, me një rritje prej 0.3 njësi note;
- nota mesatare vjetore, me një rënie prej 0.07 njësi note;

Nga krahasimi i të dhënave me Maturën e vitit të kaluar, në sesionin e parë dhe të dytë, për të gjitha lëndët e MSH 2022 rezulton:

- kalueshmëria në provim, me një rritje prej 0.31%.
- nota mesatare në provimin e maturës, me një rritje prej 0.34 njësi note;
- 7.29 nota mesatare vjetore, me një rënie prej 0.10 njësi note.

**Tabela për lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi**

| **Notat vjetore** (në %) | | **Notat e Provimit të Maturës Shtetërore (në %)** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
| **Pa notë** | **0.03%** | **0.00%** | 0.00% | 0.01% | 0.01% | 0.00% | 0.01% | 0.00% |
| **5** | **19.56%** | 0.31% | **3.81%** | 6.98% | 6.49% | 1.84% | 0.14% | 0.00% |
| **6** | **18.86%** | 0.07% | 1.69% | **4.57%** | 7.78% | 4.14% | 0.60% | 0.02% |
| **7** | **17.09%** | 0.00% | 0.56% | 2.12% | **5.94%** | 6.61% | 1.80% | 0.06% |
| **8** | **16.37%** | 0.00% | 0.14% | 0.78% | 3.75% | **7.63%** | 3.83% | 0.24% |
| **9** | **14.38%** | 0.00% | 0.02% | 0.16% | 1.43% | 5.68% | **6.39%** | 0.71% |
| **10** | **13.71%** | 0.00% | 0.00% | 0.03% | 0.34% | 2.83% | 7.83% | **2.68%** |
| **Gjithsej** | **100.00%** | **0.38%** | **6.22%** | **14.66%** | **25.74%** | **28.72%** | **20.59%** | **3.70%** |

**Tabela për lëndën Matematikë**

| | | **Notat e Provimit të Maturës Shtetërore (në %)** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **(në %)** | | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
| **Pa notë** | 0.03% | **0.01%** | 0.01% | 0.01% | 0.01% | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| **5** | 32.18% | 1.71% | **10.96%** | 11.53% | 5.43% | 1.76% | 0.64% | 0.16% |
| **6** | 22.25% | 0.46% | 4.75% | **7.13%** | 5.19% | 2.75% | 1.44% | 0.52% |
| **7** | 14.82% | 0.11% | 1.89% | 3.62% | **3.97%** | 2.57% | 1.85% | 0.81% |
| **8** | 11.37% | 0.04% | 0.73% | 1.81% | 2.59% | **2.50%** | 2.32% | 1.39% |
| **9** | 8.85% | 0.01% | 0.20% | 0.62% | 1.43% | 2.09% | **2.43%** | 2.08% |
| **10** | 10.48% | 0.00% | 0.05% | 0.18% | 0.48% | 1.15% | 2.53% | **6.10%** |
| **Gjithsej** | **100%** | **2.33%** | **18.59%** | **24.90%** | **19.10%** | **12.81%** | **11.21%** | **11.06%** |

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 70%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.4.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.4.2** | Përgatitja e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore dhe për provimet kombëtare të arsimit bazë. | Përputhshmëria e rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore me rezultatet e vitit. | 70% | **3.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.4.2** | | | **3.5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.4**

**Përshkrimi i produktit**

Qendra e Shërbimeve Arsimore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin parauniversitar. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve realizohet nëpërmjet vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe provimeve të maturës shtetërore. Në këtë mënyrë, Shqipëria, në përfundim të çdo niveli arsimor, ka një panoramë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve. Të gjitha të dhënat, të përpunuara dhe analizuara nga QSHA-ja, janë vënë në dispozicion të MAS-it, DPAP-së, ZVA-ve, ASCAP-it e deri në nivel shkolle, të cilat mund të përdoren jo vetëm për të bërë krahasime midis rajoneve, shkollave apo edhe viteve të ndryshme, por edhe për të ndërtuar politika në lidhje me nevojat për trajnim të mësuesve, cilësinë e mësimdhënies në shkollë, kurrikulat shkollore, tekstet e nxënësit etj. QSHA-ja ofron një metodë drejt një cilësie më të lartë, e një lidhjeje më të mirë midis të nxënit dhe vlerësimit, duke nxitur përmirësimin e procesit të të nxënit në klasë. Më e rëndësishme në vlerësimin e testeve në Maturën Shtetërore nuk ka të bëjë me matjen e aftësive të nxënësve për të riprodhuar njohuri, por pikërisht me vlerësimin e kompetencave të nxënësve për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë që zotërojnë tashmë, në situata të panjohura. Ky model është në koherencë të plotë edhe me metodologjitë e vlerësimit të përdorura sot në vendet më të zhvilluara, ku individi vlerësohet jo për atë që di, por për atë që është në gjendje të bëjë me atë që di.

**Analiza e produktit**

Matura Shtetërore dhe provimi kombëtar i arsimit bazë kanë si qëllim njohjen e nivelit të arritjeve të nxënësve në sistemin arsimor kombëtar në tërësi, bazuar në rezultatet e një vlerësimi të jashtëm të standardizuar. Testet e Maturës Shtetërore afrohen shumë me metodologjitë e ndërtimit të testeve bashkëkohore. Për herë të parë, në vitin 2019 për MSH-në u aplikua korrigjimi elektronik i pyetjeve me alternativa. Në kuadër të përmirësimit të administrimit të procesit të MSH 2022 janë trajnuar përgjegjësit

e qendrave të provimit. Përfaqësuesit e MAS-it janë përpjekur të monitorojnë me korrektësi qendrat provimi. Me gjithë masat e marra nga MAS ka pasur sërish neglizhencë nga përgjegjësit e administrimit dhe monitoruesit. Referuar rezultateve të MSH 2022 konstatohet paqëndrueshmëri të theksuara në lëndën e Matematikës të notës vjetore me notën e MSH. Po ashtu vihet re që një nxënës i vlerësuar me 10 gjatë procesit mësimor në provimin e Maturës Shtetërore është ulur në vlerësim me 3 deri në 4 nota. Dukuria e pranisë së rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore 2022 me një ndryshim prej më shumë ose më pak 2, 3 ose 4 nota kundrejt rezultateve vjetore të tyre, tregon për paqëndrueshmërinë e arritjeve të tyre.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.4** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.4** | Sigurimi i besueshmërisë së provimeve/ vlerësimeve kombëtare (Matura shtetërore, provimet kombëtare të arsimit bazë dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor.) | A4.4.1 Përmirësimi i administrimit dhe cilësisë së provimeve/vlerësimeve kombëtare bazuar në kompetenca. Analizë e detajuar e provimeve/ vlerësimeve kombëtare ndër vite me qëllim identifikimin e problematikave dhe rishikimin e plotë të të gjithë procesit të provimeve/vlerësimeve kombëtare, akteve rregullator dhe administrimin e tyre. | 3.5 |
| | | A4.4.2 Përgatitja e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore dhe për provimet kombëtare të arsimit bazë. | 3.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.4** | | **3.5** |



**PRODUKTI A4.5 TË MËSUARIT E GJUHËS ANGLEZE QË NGA KLASA E PARË**

**Masa A4.5.1. Futja e gjuhës angleze si lëndë e detyruar nga klasa e parë e arsimit bazë**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 127, datë 01.06.2021 “Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë për klasën e parë, udhëzimin për vitin e ri shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar”, i cili orienton dhe ndihmon institucionet arsimore në zbatimin efikas të politikave dhe krijimin e një mjedisi sa më miqësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit, vihet theksi tek aplikimi për herë të parë i gjuhës angleze në klasat e para, si dhe tek trajnimi i mësuesve përkatës për këtë qëllim.

Gjuha angleze do të mësohet nga fëmijët duke filluar nga mosha 5 vjeç. Kjo gjuhë do të jetë lëndë e veçantë në klasën e parë dhe të dytë të arsimit bazë. Vëmendje do t`i kushtohet hartimit të programeve të gjuhës angleze për këto klasa, si dhe forcimit të kapaciteteve të mësimdhënies në këtë lëndë.

**Treguesi**

**Numri i klasave/nxënësve që zhvillojnë gjuhën angleze si lëndë në klasën e parë.**

Ky tregues do të na japë numrin e klasave që do të implementojnë gjuhën angleze si lëndë në klasën e parë. Informacioni jepet çdo vit nga DPAP-ja.

**Analizë e masës**

ASCAP-i hartoi programet e gjuhës angleze për klasën e parë dhe të dytë. U ngrit rrjeti i koordinatorëve në ZVAP, DRAP dhe DPAP për ndjekjen e procesit të mësimdhënies të gjuhës angleze në klasën e parë, ku u krijua databaza e mësuesve të gjuhës angleze të klasave të para dhe u identifikuan mësuesit e sapo hyrë në sistem si dhe mësuesit me më pak se 5 vjet përvojë në mësimdhënie. Në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane u krye identifikimi i nevojave të mësuesve të gjuhës angleze të klasave të para dhe gjatë vitit shkollor 2021-2022 u trajnuan nga ASCAP 646 mësues. Në bashkëpunim me Korpusin e Paqes u trajnuan 249 mësues të gjuhës angleze të klasave të para pa përvojë pune. ASCAP-i hartoi dhe publikoi materialin metodologjik ndihmës për mësuesit e gjuhës angleze të klasave të para "Methodology of English Language Teaching to Young Learners". U hartuan modulet për implementimin e mësimit të kombinuar në lëndën e gjuhës angleze nëpërmjet platformës digjitale Akelius në klasat e para dhe të dyta. Në këtë kuadër po vijon trajnimi edhe për 300 mësues të gjuhës angleze në klasat e para dhe të dyta. Në fillim të vitit shkollor shtator 2022 rezulton se rreth 29.000 nxënës së klasës 1-rë, ndjekin mësimin e gjuhës angleze, të shpërndarë mesatarisht në 1261 klasa.

**Niveli i zbatimit**

Masa konsiderohet e zbatuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.5.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.5.1** | Futja e gjuhës angleze si lëndë e detyruar nga klasa e parë e arsimit bazë. | Numri i klasave/nxënësve që zhvillojnë gjuhën angleze si lëndë në klasën e parë. | **100 %** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.5.1** | | **100 %** | **5** |

**Masa A4.5.2. Futja e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në arsimin bazë, në klasën e gjashtë.**
Në zbatim të Udhëzimit "Për vitin shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar", datë 16.08.2021, pika 21/b u shtrua si detyrë që gjuha e huaj e dytë do të futej si detyrim në arsimin bazë, në klasën e gjashtë. Kjo masë i shtrin efektet e saj deri në vitin 2026.

**Treguesi**
**Numri i klasave/nxënësve që zhvillojnë gjuhën e huaj të dytë si lëndë të detyruar në klasën e gjashtë.**
Treguesi jep numrin e klasave që zhvillojnë gjuhën e huaj të dytë si lëndë të detyruar në klasën e gjashtë.

**Niveli i zbatimit**
Deri tani nuk ka filluar të zbatohet kjo masë, pasi në Planin e Veprimit të SKA-së është planifikuar që kjo masë të zbatohet në TM3 të vitit 2026. **Kjo masë nuk është përfshirë në vlerësim.**

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.5.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.5.2** | Futja e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në arsimin bazë, në klasën e gjashtë. | Numri i klasave/nxënësve që zhvillojnë gjuhën e huaj të dytë si lëndë të detyruar në klasën e gjashtë. | **-** | - |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.5.2** | | **-** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT  A4.5**

**Përshkrimi i produktit**

Në fillim të vitit shkollor 2021-2022 me Urdhër Nr. 127, datë 01.06.2021 “Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë për klasën e parë, në sistemin parauniversitar” u vu si detyrë që gjuha angleze duhet të filloi të mësohet nga fëmijët duke filluar nga mosha 5 vjeç. Kjo gjuhë do të jetë lëndë e veçantë  në klasën e parë dhe të dytë të arsimit bazë. Futja e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në arsimin bazë, në klasën e gjashtë. Në zbatim të Udhëzimit “Për vitin shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar”, datë 16.08.2021, gjuha e huaj e dytë do të futej si detyrim në arsimin bazë, në klasën e gjashtë dhe do ti shtrijë efektet e saj deri në vitin 2026.

**Analiza e Produktit**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 127, datë 01.06.2021, “Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë për klasën e parë, udhëzimin për vitin e ri shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar”, u mundësua futja për herë të parë e gjuhës angleze në klasat e para dhe trajnimin e mësuesve përkatës. U hartuan programet e gjuhës angleze për klasën e parë dhe të dytë. Në shtator 2021 u ngrit rrjeti i koordinatorëve në ZVAP, DRAP dhe DPAP për ndjekjen e procesit të mësimdhënies të gjuhës angleze në klasën e parë dhe u krijua databaza e mësuesve të gjuhës angleze të klasave të para. Gjatë vitit shkollor 2021-2022 u trajnuan nga ASCAP 646 mësues të gjuhës angleze të klasave të para në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane.  U identifikuan mësuesit e sapo hyrë në sistem si dhe mësuesit me më pak se 5 vjet përvojë në mësimdhënie. U hartuan modulet për implementimin e mësimit të kombinuar në lëndën e gjuhës angleze nëpërmjet platformës digjitale Akelius në klasat e para dhe të dyta. Në bashkëpunim me Korpusin e Paqes u trajnuan 249 mësues të gjuhës angleze të klasave të para pa përvojë pune. Në fund të vitit shkollor 2022 u raportua se rreth 29.000 nxënës së klasës 1-rë, ndjekin mësimin e gjuhës angleze, të shpërndarë në 1261 klasa. Për futjen e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në klasën e gjashtë nuk ka informacion mbi trajnimin dhe numrin e nxënësve, pasi kjo masë është planifikuar të zbatohet në TM3 të vitit 2026.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.5 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.5** | Të mësuarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë. | A4.5.1 Futja e gjuhës angleze si lëndë e detyruar nga klasa e parë e arsimit bazë. | 5 |
| | | A4.5.2 Futja e gjuhës së huaj të dytë të detyruar në arsimin bazë, në klasën e gjashtë. | - |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.5** | | **5** |



**PRODUKTI A4.6. TË MËSUARIT E ZEJEVE DHE TË ARTEVE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË.**

**Masa A4.6.1. Hartimi i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje dhe arte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë.**
Hartimi i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje, arte dhe sporte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin parauniversitar duhet të ketë përfunduar deri gusht 2022.

**Treguesi 1**
**Numri i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje, arte dhe sporte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin parauniversitar.**
Ky tregues na jep numrin e moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje, arte dhe sporte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin parauniversitar.

**Treguesi 2**
**Përqindja e nxënësve që do të mësojnë zeje, arte dhe sporte në arsimin parauniversitar.**
Nëpërmjet këtij treguesi do të na jepet mundësia për të marrë informacion mbi numrin e nxënësve që mësojnë zeje dhe arte në raport me numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkollat e mesme të larta.

**Analiza e masës**
Gjatë vitit-2022, është punuar për identifikimin e burimeve dhe mundësive në shkolla për zhvillimin e programit kombëtar "Art, Zeje, Sport" në arsimin parauniversitar dhe është punuar nga grupi ndërministror për hartimin e kurrikulave sipas fushave nga ministritë e linjës. U hartua Udhëzuesi për zbatimin e programit kombëtar "Art, zeje, sport", i cili është një material ndihmës për shkollat dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (ZVAP dhe DRAP), të përfshira në zbatimin e programit. Ai është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe ka për qëllim: Të mbështesë institucionet arsimore parauniversitare (IAP) për zhvillimin e veprimtarive jashtë orarit mësimor me nxënësit që ndjekin programin "Art, zeje, sport"; si dhe t'u vijë në ndihmë ZVAP-ve dhe DRAP-ve për koordinimin dhe për monitorimin e veprimtarive të shkollave të angazhuara në zbatimin e këtij programi. Produkt i këtyre veprimtarive është "Udhëzuesi për institucionet arsimore për Programin Kombëtar "Art, Zeje, Sport".Për trajnimin e mësuesve që do të zhvillojnë modulet për zejet, artet dhe sportet në arsimin parauniversitar, MAS në bashkëpunim me ASCAP-in dhe DPAP-në ka mundësuar ngritjen e 200 kapaciteteve të koordinatorëve të ZVAP-ve për Programin Kombëtar "Art, Zeje, Sport", që do zbatohet në 200 institucione arsimore duke filluar nga Janari 2023. Janë përzgjedhur nga DPAP 200 shkolla që plotësojnë kriteret dhe deri në dhjetor 2022 janë trajnuar drejtuesit e 200 shkollave, nga 1 specialist nga 4 DRAP-et dhe nga 1 specialist nga ZVAP-të. Gjithsej janë trajnuar 56 specialistë dhe 200 drejtues shkollash. Implementimi i projektit nëpër shkolla ka filluar në mars të vitit 2023.
Për vitin 2022 nuk kemi asnjë të dhënë mbi numrin e nxënësve që mësojnë zeje, arte dhe sporte në arsimin parauniversitar. Implementimi i projektit nëpër shkolla do të fillojë në vitin 2023. Për vitin 2023 synohet që 5% e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë të aftësohen dhe të përfitojnë kompetenca në zeje, arte dhe sporte.

**Niveli i zbatimit**

Numri i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje, arte dhe sporte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin parauniversitar është realizuar në masën 100%.

Deri në përfundim të vitit 2022 nuk ka filluar të zbatohet nëpër shkolla, pasi është planifikuar për t'u zbatuar në fillim të vitit 2023.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.6.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.6.1** | Hartimi i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje dhe arte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë. | Numri i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje, arte dhe sporte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin parauniversitar. | **100 %** | **5** |
| | | Përqindja e nxënësve që do të mësojnë zeje, arte dhe sporte në arsimin parauniversitar. | **-** | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.6.1** | | **100%** | |

**Masa A4.6.2 Trajnimi i mësuesve që do të zhvillojnë modulet për zejet arte dhe sporte në arsimin e mesëm të lartë në lidhje me përmbajtjen mësimore, metodologjinë dhe vlerësimin e këtyre moduleve.**
Si një formë e re edukimi dhe module të reja të pa trajtuara më parë, nevojitet të parapërgatitet dhe të trajnohet stafi mësimor për një mësimdhënie me bazë kompetencash. Trajnimi do të bëhet për modulet: zejet, artet dhe sportet në arsimin parauniversitar.

**Treguesi**

**Numri i mësuesve të trajnuar për të zhvilluar modulet për zejet, artet dhe sportet në arsimin parauniversitar.**

Si një formë e re edukimi me module të reja, më parë nevojitet të përgatitet stafi mësimor sipas kurrikulës me kompetenca. Treguesi i mësipërm na jep mundësi për të evidentuar numrin e mësuesve të trajnuar, si dhe për të nxjerrë nevojat për trajnime të mëtejshme.

**Analiza e masës**

Në përmbushje të nismës janë përzgjedhur 200 shkolla që plotësojnë kriteret për zbatimin e saj dhe në dhjetor 2022 janë trajnuar drejtuesit e 200 shkollave, nga 1 specialist nga secili DRAP si dhe nga 1 specialist për çdo ZVAP. Në përfundim të vitit 2022 janë trajnuar gjithsej 56 specialistë dhe 200 drejtues shkollash.

MAS-i, në bashkëpunim me ASCAP-in dhe DPAP-n ka mundësuar ngritjen e 200 kapaciteteve të koordinatorëve të ZVAP-ve për Programit Kombëtar “Art, Zeje, Sport” që do zbatohet në 200 institucione arsimore duke filluar nga Janari 2023.

**Niveli i zbatimit**
Masa konsiderohet e realizuar100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A4.6.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A4.6.2** | Trajnimi i mësuesve që do të zhvillojnë modulet për zejet arte dhe sporte në arsimin e mesëm të lartë në lidhje me përmbajtjen mësimore, metodologjinë dhe vlerësimin e këtyre moduleve. | Numri i mësuesve të trajnuar për të zhvilluar modulet për zejet, artet dhe sportet në arsimin parauniversitar. | **100 %** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A4.6.2** | | **100 %** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.6**

**Përshkrimi i produktit**
Në zbatim të Udhëzimit “Për vitin shkollor 2021-2022 në sistemin parauniversitar”,datë 16.08.2021. Programi Kombëtar “Art, zeje, Sport” i quajtur ndryshe dhe si Programet Jashtë Orarit Mësimor (JOM) parashikohet të zbatohet në sistemin arsimor parauniversitar në 200 Shkolla Qendër Komunitare të zgjedhura nga ZVAP-të dhe miratuara nga MAS. U vu detyrë të hartohej Udhëzuesi për zbatimin e programit kombëtar “Art, zeje, sport”, i cili do të shërbente si një material ndihmës për shkollat dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (ZVAP dhe DRAP), të përfshira në zbatimin e programit si dhe të bëhej trajnimi i tyre.

**Analiza e produktit**
Gjatë vitit-2022, është punuar për identifikimin e burimeve dhe mundësive në shkolla për zhvillimin e programit kombëtar “Art, Zeje, Sport” në arsimin parauniversitar dhe është punuar nga grupi ndërministror për hartimin e kurrikulave sipas fushave nga ministritë e linjës.
U hartua Udhëzuesi për zbatimin e programit kombëtar “Art, zeje, sport”, i cili është një material ndihmës për shkollat dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (ZVAP dhe DRAP), të përfshira në zbatimin e programit. U mundësua ngritja e 200 kapaciteteve të koordinatorëve të ZVAP-ve për Programin Kombëtar “Art, Zeje, Sport”, që do zbatohet në 200 institucione arsimore. Janë përzgjedhur nga DPAP 200 shkolla që plotësojnë kriteret dhe deri në dhjetor 2022 janë trajnuar drejtuesit

e 200 shkollave, nga 1 specialist nga 4 DRAP-et dhe nga 1 specialist nga ZVAP-të. Gjithsej janë trajnuar 56 specialistë dhe 200 drejtues shkollash. Implementimi i projektit nëpër shkolla do të zbatohet në vitin 2023.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A4.6 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A4.6.** | Sigurimi i besueshmërisë së vlerësimeve kombëtare | Hartimi i moduleve kurrikulare dhe profesionale për zeje dhe arte, të cilat do të zhvillohen në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë. | 5 |
| | | Trajnimi i mësuesve që do të zhvillojnë modulet për zejet arte dhe sporte në arsimin e mesëm të lartë në lidhje me përmbajtjen mësimore, metodologjinë dhe vlerësimin e këtyre moduleve. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A4.6.** | | **5** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK A5: DIGJITALIZIMI I ARSIMIT**

**Produkti A5.1 Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.**

**Masa A5.1.1 Përcaktimi i standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla.**
Masa kërkon përcaktimin e disa standardeve si më poshtë:
- Standarde në lidhje me numrin e nxënësve dhe mësuesve për kompjuter;
- Numri i kompjuterave të lidhur me internetin dhe shpejtësinë e lidhjes;
- Standarde mbi mirëmbajtjen teknike të pajisjeve;
- Standarde mbi parametrat e sigurisë, softuerin që përdoret në shkolla,
- Aksesibilitetin për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë që edhe ata të përfitojnë kompetenca digjitale e të aftësohen për tregun e punës.

**Treguesi**
**Hartimi i dokumentit të standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla**
Treguesi kërkon hartimin e dokumentit i cili përcakton standardet e nevojshme për pajisjet e TIK-ut në shkolla. Afati i realizimit të masës është TM2–2022.

**Analiza e masës**
Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK-ut, miratuar me urdhër nr. 84 datë 06.05.2021 nga MAS. Dokumenti i Standardeve profesionale është mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Mësuesve, DigComEdu, Kornizën e Kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3, UNESCO) si dhe në Rezolutën e Këshillit Evropian për kornizën strategjike 2021 – 2030 (Council Resolution of 26 February 2021 on a strategic frameëork for European cooperation in education and training toëards the European Education Area and beyond 2021-2030) OJ C 66, 26.2.2021, p. 1–21). (ASCAP). Është hartuar dhe publikuar nga ASCAP “Udhëzuesi për zbatimin e arsimit të kombinuar në institucionet arsimore parauniversitare”. Është realizuar në 6-mujorin e parë të 2022.

**Niveli i zbatimit**
Është hartuar dokumenti i standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla dhe masa konsiderohet e realizuar 100 %.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.1.1** | Përcaktimi i standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla. | Hartimi i dokumentit të standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla. | **100 %** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.1.1** | | **100 %** | **5** |

**Masa A5.1.2 Instalimi i rrjeteve wireless në shkolla do të jetë në funksion të shfrytëzimit të pajisjeve nga nxënësit dhe mësuesit.**
Kjo masë parashikon instalimin e shërbimit wireless, të cilat duhet të sigurojnë mbulueshmëri të klasave, bibliotekave, laboratorëve dhe hapësirave të tjera ku zhvillohet mësimi. Afati i përfundimit të veprimtarisë është TM3 - 2026.

**Treguesi**
**Numri i shkollave që kanë shërbim wireless.**
Ky tregues na përshkruan numrin e shkollave me rrjete wireless për qëllime pedagogjike.

**Analiza e masës**
Kontrata për shërbimin e internetit në shkolla është bërë me AKSHI-n. Afati i kontratës ka qenë deri me 31-dhjetor 2022. Në këtë kontratë ishin të përfshirë 1200 shkolla dhe cilësia e internetit ka qenë e planifikuar nga 6-15 Gb, në varësi të zonës së shkollës dhe numrit të nxënësve të shkollë, por nuk kemi informacion të saktë nëse të gjitha shkollat e planifikuara e kanë përfituar shërbimin
Deri në fund të 2022 kanë marrë shërbim Internet nga AKSHI vetëm 1200 shkolla.

**Niveli i zbatimit**
**Masa është realizuar 60%** (vlerësimi merr në konsideratë edhe numrin e raportuar të kompjuterave dhe pajisjeve funksionale për nxënës).

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.1.2. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.1.2.** | Instalimi i rrjeteve wireless në shkolla do të jetë në funksion të shfrytëzimit të pajisjeve nga nxënësit dhe mësuesit. | Numri i shkollave që kanë shërbim wireless. | **60 %** | **3** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.1.2.** | | **60 %** | **3** |

**Masa A5.1.3. Investim për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla.**

Në përmbushje të politikave të qeverisë për procesin e digjitalizimit të shkollave, qeveria do të vazhdojë të investojë në pajisje digjitale dhe për instalimin e aksesit në internet për të gjitha institucionet arsimore parauniversitare duke ruajtur ekuilibrin midis investimeve në lidhje me shpenzimet për pajisje dhe aksesin në internet si dhe shpenzimeve për mirëmbajtjen teknike. Kjo veprimtari duhet të shoqërohet nga vendosja e pajisjeve në klasa duke rritur ndjeshëm numrin e kompjuterave tërësisht funksionale e të përdorshëm nga nxënësit në shkolla. Duke u nisur nga standardet për pajisjet e TIK-ut në shkolla, nevojitet të hartohet një plan për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla, përfshirë kompjuterët, projektorët, tabelat interaktive, rrjetet **wireless**, dhe aksesorët e ndryshëm.

**Treguesi 1**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 1.**
Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj. Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 1.
**Realizimi është 98%.**

**Treguesi 2**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 2**
Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në energji elektrike –
Niveli ISCED 2.
**Realizimi është 95%.**

**Treguesi 3**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 3.**
Ky tregues na jep përqindjen e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 3.
**Realizimi është 91%.**

**Treguesi 4**

**Përqindja e shkollave me akses në kompjutera për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1**

Ky tregues na jep përqindjen e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1.

**Realizimi është 49%.**

**Treguesi 5**

**Përqindja e shkollave me akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2.**

Ky tregues na jep përqindjen e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2.

**Realizimi është 83%.**

**Treguesi 6**

**Përqindja e shkollave me akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3.**

Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3.

**Realizimi është 81%.**

**Treguesi 7**

**Raporti kompjuter-nxënës në shkolla.**

Ky tregues do të na tregojë numrin e kompjuterave në institucione të arsimit parauniversitar në raport me numrin nxënësve. Treguesi është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor, është tregues i përdorur në SKA.

Vlera aktuale në total është 20 nxënës për kompjuter. Aktualisht në sistemin tonë raporti kompjuter-nxënës është 1 me 20 dhe duke e krahasuar me vlerën e synuar që është 1 me 3 deri 1 me 7.

**Realizimi është 34%.**

**Treguesi 8**

**Shpejtësia e internetit në shkolla.**

Ky tregues do të na tregojë mesataren e shpejtësisë së internetit në shkolla.

Institucioni përgjegjës për grumbullimin e të dhënave MAS - AKSHI

Vlera aktuale në total është N/A. Vlera e synuar 30 Mbps.

**Realizimi është 56%.**

**Analiza e masës**

Ka përfunduar instalimi i rrjeteve wireless në 100 shkollat pilot në hapësirat e SmartLab-ve për projektin pilot “Element IT”, Në përputhje me standardet. Janë ndërtuar 5 laboratorë të TIK në 5 gjimnaze publike në kuadër të projektit “Inteligjenca Artificiale për të rinjtë” nga Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim (AADF). Gjithashtu, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka ndërtuar 8 laboratorë të TIK për shkollat e arsimit bazë sipas modelit pilot të 100 Smartlabeve. Në kuadër të projektit “Qëndro” në bashkëpunim me MAS, AKSHI-in, dhe World Bank, UNICEF janë ndërtuar 17 laboratorë TIK në shkolla për

t'i dhënë mundësi nxënësve të mund të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe të mund të mësojnë nëpërmjet mësimit të kombinuar

Sipas rezultateve të paraqitura më sipër vihet re se:

- 98% e shkollave kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 1, ndërsa vlera e synuar është 99%, pra (-1,29%);
- 95.43% e shkollave kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 2, ndërsa vlera e synuar është 98% (- 2,57%);
- 90.95% e shkollave kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 3, ndërsa vlera e synuar është 95% (- 4,05%);
- 49.02% e shkollave kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1, ndërsa vlera e synuar është 75% (-25,98);
- 82.82% e shkollave kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2, ndërsa vlera e synuar është 90% (-7,18%)
- 81.69% e shkollave kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3, ndërsa vlera e synuar është 95%. (-13,31%)

Mosrealizimi i parashikimeve lëviz nga 1,29% - 25.98%.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 74%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.1.3 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.1.3** | Investim për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla. | 1. Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 1. | 98% | 3.7 |
| | | 2. Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 2. | 95% | |
| | | 3. Përqindja e shkollave që kanë akses në energji elektrike - Niveli ISCED 3. | 91% | |
| | | 4. Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 1. | 49% | |
| | | 5. Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2. | 83% | |
| | | 6. Përqindja e shkollave që kanë akses në kompjuterë për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3. | 81% | |
| | | 7. Raporti kompjuter-nxënës në shkolla. | 34% | |
| | | 8. Shpejtësia e internetit në shkolla. | 56% | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.1.3** | | **74%** | |

**A5.1.4 Mirëmbajtja teknike e pajisjeve të TIK-ut nëpërmjet klubeve të nxënësve e strukturës arsimore lokale.**

SKA parashikon të krijohen nëpër shkolla klube të nxënësve, të cilët, bashkë me mësuesit e informatikës, do të përkujdesen për mirëmbajtjen elementare teknike të pajisjeve të TIK-ut, përfshirë instalimin dhe përditësimin e softuerit, konfigurimin e pajisjeve, si dhe evitimin e defekteve të vogla. Për këtë qëllim do të hartohen udhëzues të veçantë për këto klube dhe do të kryhen trajnime për mësuesit të cilët do të jenë drejtuesit e këtyre klubeve. Për të mbështetur klubet e nxënësve në shkolla, do të krijohen njësi të specializuara të mirëmbajtjes pranë strukturave arsimore lokale.

**Treguesi**
**Numri i klubeve të nxënësve të përfshirë në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut.**
Treguesi na jep informacion mbi numrin e klubeve të nxënësve të përfshirë në mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të TIK-ut, duke qenë se detyrë e institucioneve arsimore është mirëmbajtja teknike të pajisjeve të TIK-ut. Për këtë qëllim është detyrë e shkollave të ngrenë klube të përbëra nga mësues dhe nxënës të aftë për procesin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të TIK-ut në institucionet e tyre.

**Analiza e masës**
Deri në përfundim të vitit 2022 nuk ka të dhëna mbi numrin e klubeve të mirëmbajtjes në shkolla.
**Kjo masë nuk është përfshirë në vlerësim.**

**A5.1.5 Zhvillimi i politikave të përdorimit të TIK-ut në nivel shkolle.**
MAS në bashkëpunim me AKSHI-n harton politika për përdorimin i teknologjisë së informacionit në nivel shkolle, e cila siguron garantimin e përdorimit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastrukturës së TIK-ut, përdorimin e pajisjeve nga ana e personelit të shkollës dhe nxënësve, mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në Internet, komunikimin elektronik, etj.
Duke marrë parasysh faktin se një numër i konsiderueshëm i nxënësve dhe mësuesve kanë pajisje personale si laptop, tableta ose telefona SMART, duhet të zbatohen politika të tilla që të inkurajojnë shfrytëzimin e tyre në mjedisin shkollor.

**Treguesi 1**
**Numri i shkollave që zhvillojnë module-tema për rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e TIK-ut.**
Treguesi jep mbi numrin e shkollave që zhvillojnë module-tema për rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e TIK-ut në raport me numrin e përgjithshëm të shkollave.

**Treguesi 2**
**Numri i shkollave që kanë faqen e tyre në internet, rrjete sociale.**
Ky tregues jep numrin e shkollave që kanë faqen e tyre në internet, rrjete sociale.

**Analiza e masës**
Janë rishikuar kurrikulat duke përfshirë edhe atë të TIK në klasë të parë dhe aprovimi i planit mësimor për klasën e parë dhe të dytë përfaqëson politikën e përdorimit në nivel shkolle. Gjithashtu është duke u përgatitur Plani i implementimit për zgjerimin e iniciativës së kodimit edhe në 200 shkollat me mbështetjen e Bankës Botërore. Marrëveshjet e lidhura me AADF si për elementët e IT-së dhe Inteligjenca Artificiale përfaqësojnë një politikë të përdorimit të TIK-ut. ASCAP-i është asistuar për rishikimin e kurrikulës së TIK-ut me ekspertë të huaj me mbështetjen e AADF. Njëkohësisht është duke u mbështetur ASCAP-i në krijimin e një plani për zhvillimin profesional të mësuesve në nivele të ndryshme. Zgjerimi i komunitetit ESEP/et në Shqipëri përfaqëson një mundësi të aplikimit të politikave evropiane për integrimin e TIK-ut në arsim. Politikat janë në zbatim të plotë të agjendës digjitale evropiane.
- Deri në përfundim të vitit 2022 është përgatitur materiali i për trajnimin e mësuesve dhe janë trajnuar 500 mësues të arsimit parashkollor si dhe 97 mësues të gjuhëve të huaja për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.

- Nuk ka të dhëna për numrin e shkollave që zhvillojnë module-tema për rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e TIK-ut.
- Deri në përfundim të vitit 2022 vetëm 50% e shkollave kanë faqen e tyre në internet e rrjete sociale.

**Niveli i zbatimit**
Masa është realizuar 50%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.1.5. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.1.5.** | Zhvillimi i politikave të përdorimit të TIK-ut në nivel shkolle. | Numri i shkollave që zhvillojnë module-tema për rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e TIK-ut. | **-** | **-** |
| | | Numri i shkollave që kanë faqen e tyre në internet, rrjete sociale. | **50%** | **2.5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.1.5.** | | **50%** | **2.5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.1**

**Përshkrimi i produktit**
Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK), ku bëjnë pjesë kompjuterat, tabletat, telefonat SMART, tabelat interaktive dhe aksesorët e tjerë, ka ndikim pozitiv në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në shtimin e motivimit dhe përmirësimin e performancës së nxënësve, duke siguruar që të gjithë nxënësit të përfitojnë nivele të caktuara të kompetencës digjitale për t'iu përshtatur kërkesave të kohës. Për të realizuar këto është e domosdoshme krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla, si dhe të merren masat e nevojshme për mirëmbajtjen e tij. TIK-u ofron mundësi për organizimin e mësimit në distancë në rastin e situatave të paparashikueshme, ndërkaq, në situata normale, teknologjia mund të shfrytëzohet për avancimin e procesit mësimor në të gjitha kurrikulat shkollore.

**Analiza e produktit**
Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK-ut. Dokumenti i Standardeve profesionale është mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Mësuesve, DigComEdu, Kornizën e Kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3, UNESCO) si dhe në

Rezolutën e Këshillit Europian për kornizën strategjike 2021-2030. Është hartuar dhe publikuar në 6-mujorin e parë të 2022 nga ASCAP "Udhëzuesi për zbatimin e arsimit të kombinuar në institucionet arsimore parauniversitare". Për shërbimin e internetit në shkolla është lidhur kontrata me AKSHI-n, e cila ka përfunduar në 31-dhjetor 2022. Në këtë kontratë ishin të përfshirë 1200 shkolla dhe cilësia e internetit ka qenë e planifikuar nga 6-15 Gb, në varësi të zonës së shkollës dhe numrit të nxënësve të shkollë, por nuk kemi informacion të saktë nëse të gjitha shkollat e planifikuara e kanë përfituar shërbimin. Deri në fund të 2022 kanë marrë shërbim Internet nga AKSHI vetëm 1200 shkolla, nga 3708 shkolla në total.
Ka përfunduar instalimi i rrjeteve wireless në 100 shkollat pilot në hapësirat e SmartLab-ve për projektin pilot "Element IT", Në përputhje me standardet. Janë ndërtuar 5 laboratorë të TIK në 5 gjimnaze publike në kuadër të projektit "Inteligjenca Artificiale për të rinjtë" nga Fondacioni Shqiptaro Amerikan për Zhvillim (AADF). Gjithashtu, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka ndërtuar 8 laboratorë të TIK për shkollat e arsimit bazë sipas modelit pilot të 100 Smartlabeve.
Në kuadër të projektit "Qëndro" në bashkëpunim me MAS, AKSHI-in, dhe World Bank, UNICEF janë ndërtuar 17 laboratorë TIK në shkolla për t'i dhënë mundësi nxënësve të mund të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe të mund të mësojnë nëpërmjet mësimit të kombinuar
Janë investuar nëpajisje digjitale dhe për instalimin e aksesit në internet për të gjitha institucionet arsimore parauniversitare duke ruajtur ekuilibrin midis investimeve në lidhje me shpenzimet për pajisje dhe aksesin në internet si dhe shpenzimeve për mirëmbajtjen teknike. Deri në përfundim të vitit 2022 nuk ka të dhëna mbi numrin e klubeve të mirëmbajtjes në shkolla.
Janë rishikuar kurrikulat duke përfshirë edhe atë të TIK në klasë të parë dhe aprovimi i planit mësimor për klasën e parë dhe të dytë. Gjithashtu është duke u përgatitur Plani i implementimit për zgjerimin e iniciativës së kodimit edhe në 200 shkollat me mbështetjen e Bankës Botërore. Deri në përfundim të vitit 2022 është përgatitur materiali për trajnimin e mësuesve dhe janë trajnuar 500 mësues të arsimit parashkollor si dhe 97 mësues të gjuhëve të huaja për përdorimin e TIK-ut në procesim mësimor.
Nuk ka të dhëna për numrin e shkollave që zhvillojnë module-tema për rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e TIK-ut.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.1. | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A5.1.** | Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla e mirëmbajtja e saj. | Përcaktimi i standardeve për pajisjet e TIK-ut në shkolla | 5 |
| | | Instalimi i rrjeteve wireless në shkolla do të jetë në funksion të shfrytëzimit të pajisjeve nga nxënësit dhe mësuesit | 3 |
| | | Investim për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla | 3.7 |
| | | Mirëmbajtja teknike e pajisjeve të TIK-ut nëpërmjet klubeve të nxënësve dhe strukturës arsimore lokale | - |
| | | Zhvillimi i politikave të përdorimit të TIK-ut në nivel shkolle | 2.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A5.1.** | | **3.5** |



## PRODUKTI A5.2. ZHVILLIMI I KOMPETENCËS DIGJITALE

### A5.2.1 Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit.

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Shkollat dhe klasat, si ato reale ashtu edhe ato virtuale, duhet të kenë mësues të cilët duhet të dinë që gjatë procesit të mësimdhënies të ndërlidhin tri komponentë: përmbajtjen e lëndës, pedagogjinë dhe teknologjinë. Një mësuesi për të qenë i aftë në punën e tij nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore, ku TIK-u ka vlera të domosdoshme dhe të patjetërsueshme për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënie-nxënies. TIK nuk ndikon vetëm në një mësimdhënie të suksesshme, por dhe në mundësitë që u krijon mësuesve për të mësuar dhe për të bashkëpunuar me njëri - tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve, përvojave dhe zgjidhjes së problemeve të përbashkëta pedagogjike.

**Treguesi**

**Hartimi i dokumentit të standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK-ut.**

Treguesi parashikon dokumentin e standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK-ut, i cili përcakton kriteret që duhet të përmbushë çdo mësues i arsimit parauniversitar në përmbushje të detyrave të tij.

**Analiza e masës**

Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE), kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Në këto kushte dhe në Shqipëri shtrohet si domosdoshmëri hartimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie – mësim nxënie, për t'u siguruar që të gjithë mësuesit të jenë të mirë përgatitur, për të përdorur TIK-un në procesin mësimor me qëllim pajisjen e nxënësve me aftësitë e shekullit XXI. "Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit", produkt i ASCAP-it, tetor 2020 ka për qëllim të sigurojnë një qasje të standardizuar për të gjithë mësuesit, në lidhje me përdorimin e TIK-ut në shkollë dhe në procesin mësimor. Këto standarde përcaktojnë treguesit për zbatimin e TIK-ut në procesin mësimor, si dhe synojnë të përgatisin mësuesit për t'u bërë përdorues të teknologjive të ndryshme të komunikimit dhe të informimit.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është zbatuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/ Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.1** | Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit. | Hartimi i dokumentit të standardeve të mësuesit për përdorimin e TIK-ut. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.1** | | **100%** | |

**A5.2.2. Pilotimi i SELFIE**

Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of InnovativeEducational Technologies është një aplikacion i dizenjuar për të ndihmuar shkollat në përfshirjen e teknologjive digjitale në mësimdhënie, mësim nxënie dhe vlerësim. Kjo masë na tregojë shkollat që përdorin platformat online për mësim në raport me numrin e përgjithshëm të shkollave.

**Treguesi**

**Përqindja e shkollave që përdorin platformat online SELFIE (Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of Innovative Educational Technologies).**

Ky tregues do të na tregojë numrin e shkollave që kanë faqen e tyre në internet, rrjete sociale. Treguesi na jep informacion mbi numrin e shkollave që përdorin platformat online SELFIE.

**Analiza e masës**

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga sondazhi me mësues dhe nxënës, aplikacioni gjeneron një raport "SELFIE" që zbulon pikat e forta dhe të dobëta në lidhje me përdorimin e teknologjive digjitale në shkollë, duke përcaktuar rrugën për përmirësim në këtë drejtim. Meqë SELFIE është në dispozicion edhe në gjuhën shqipe do të nxitet pilotimi i aplikacionit në shkollat shqiptare.

**Niveli i realizimit Vlera aktuale 0%**

Deri në përfundim të vitit 2022 e në vijim nuk ka filluar ende të pilotohet platforma "SELFIE".

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.2** | Pilotimi i SELFIE (Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of Innovative Educational Technologies). | Përqindja e shkollave që përdorin platformat online. | **0%** | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.2** | | **0%** | |

**A5.2.3 Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet.**

Duke parë rreziqet që derivojnë nga përdorimi i pakontrolluar i internetit në shkolla, u parashtruan një sërë masat për parandalimin e tyre. Në dokumentin “Manuali i mësuesve të TIK (klasa e parë) është planifikuar për t'u zbatuar 1 kapitull me 4 tema mësimore (32-34) lidhur me Sigurinë e të punuarit në kompjuter, që lidhet me besimin për kompjuterin, të dhënat personale dhe përdorimin e fjalëkalimeve.

**Treguesi**

**Përfshirja në kurrikul të temave për sigurinë në internet që në arsimin bazë.**

Nëpërmjet treguesit, marrim informacion mbi tematikën dhe përfshirjen e temave për sigurinë në internet në programet e arsimit bazë.

**Analiza e masës**

Në kuadër të linçimit të nismës "Siguria në internet", ASCAP-i ka hartuar një manual për mësuesit lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin e mësuesve lidhur me sfidat dhe rreziqet që përballen nxënësit në botën virtuale. Në vijimësi ASCAP-i do të finalizojë një plan konkret veprimi dhe do të zhvillojë trajnime me mësuesit në të gjithë vendin në kuadër të kësaj nisme. Po kështu në programet lëndore të TIK-ut, klasa e parë janë të përfshira tema për sigurinë në internet.

**Niveli i zbatimit**

Masa konsiderohet e realizuar80%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.3. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.3.** | Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet. | Përfshirja në kurrikul të temave për sigurinë në internet që në arsimin bazë. | **80%** | **4** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.3.** | | **80%** | |

**A5.2.4 Përcaktimi i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian.**

Në të gjitha vendet evropiane e më gjerë, TIK është bërë pjesë e domosdoshme e kurrikulave, si një metodologji e re për integrimin e tij në mësimdhënie. Arsimi sot kërkon mësues të pajisur me të gjitha aftësitë e nevojshme për të mësuar nxënësit, të cilët duhet të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat e zhvillimeve të reja të botës moderne digjitale. Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë e Edukimit (ISTE), kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Këto paketa standardesh u kanë siguruar shteteve, rajoneve, shkollave dhe institucioneve të edukimit themele mbi të cilat ngrihet filozofia dhe hartohen plane për integrimin e teknologjisë në kurrikul dhe janë bërë pjesë të dokumentit të standardeve të mësuesve në vendin tonë

**Treguesi**

**Dokumenti i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Europian.**

Treguesi na paraqet dokumentin e standardeve për arritjen e kompetencës digjitale, sipas formatit të Bashkimit Europian.

**Analiza e masës**

Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK miratuar me urdhër nr. 84 date 06.05.2021 nga MAS. Dokumenti i Standardeve profesionale është mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale të Mësuesve, DigComEdu, Kornizën e Kompetencës së TIK-ut për mësuesit, (ICT CFT, version 3, UNESCO ) si dhe në Rezolutën e Këshillit Europian për kornizën strategjike 2021 - 2030.

**Niveli i zbatimit**

Është hartuar Dokumenti i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian. Masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.4.** | Përcaktimi i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian. | Dokumenti i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.4** | | **100%** | |

**A5.2.5 Përfshirja e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët e të lartë në programin kombëtar të kodimit, nëpërmjet angazhimeve tërësore për përfshirjen e tyre në qendra të specializuara në mbështetje të zhvillimit të kompetencave digjitale të kodimit për këtë grup-moshë.**

Shkollat do të angazhohen për pjesëmarrje aktive në EU Code Week, iniciativë e Komisionit Evropian për një përqasje të re të zhvillimit të kapaciteteve në këtë drejtim.

Do të fuqizohet rrjeti Twinning si një mundësi konkrete e përfshirjes aktive të mësuesve e nxënësve në projekte kurrikulare binjakëzuese të bazuara në zhvillimin e kompetencave të qëndrueshme të TIK-ut edhe në aspektin e kodimit.

**Treguesi**

**Numri i nxënësve që janë përfshirë në programin kombëtar të kodimit**

Treguesi na jep mundësi për t'u informuar mbi numrin e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët e të lartë që janë përfshirë në programin kombëtar të kodimit, nëpërmjet angazhimeve tërësore për përfshirjen e tyre në qendra të specializuara në mbështetje të zhvillimit të kompetencave digjitale të kodimit për këtë grup-moshë.

**Analiza e masës**

Në kuadër të realizimit të detyrave, të cilat derivojnë nga strategjia e arsimit 2021 – 2026 si dhe në zbatim të urdhrit të brendshëm institucional ASCAP me nr. 14, datë 07.02.2022, grupi i punës ASCAP ka hartuar materialin mbështetës në ndihmë të mësuesve i cili inicion njohjen e koncepteve të kodimit dhe nocionet e të menduarit kompjuterik (computationalthinking). Ky material u vjen në ndihmë veçanërisht mësueseve, të cilët do të zhvillojnë lëndën e TIK-ut në klasën e parë, për t'u njohur më në detaje me konceptet kodimit, të menduarit kompjuterik dhe platformat e ndryshme softwerike, dedikuar qasjes së programimit të bazuar në bllok. Mësuesit do të gjejnë në këtë material jo vetëm shpjegime teorike mbi nocionet kryesore të kodimit, por edhe shembuj praktikë lidhur me metodologjinë e zhvillimit të orës mësimore, bazuar mbi instruksionet unplugged.

**Niveli i zbatimit**
Për vitin shkollor 2022-2023 programi kombëtar i kodimit zbatohet në 100 shkolla, ku janë përfshirë 101 mësues dhe numri i nxënësve është 7076 gjithsej.

Masa konsiderohet e realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.5** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.5** | Përfshirja e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët e të lartë në programin kombëtar të kodimit, nëpërmjet angazhimeve tërësore për përfshirjen e tyre në qendra të specializuara në mbështetje të zhvillimit të kompetencave digjitale të kodimit për këtë grup-moshë. | Numri i nxënësve që janë përfshirë në programin kombëtare të kodimit. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.5** | | **100%** | |

**A5.2.6. Përfshirja e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që në klasën e parë.**
Për prezantimin e kurrikulës së TIK-ut për klasat 1-3 po zbatohet projekti element IT, i cili është realizim i bashkëpunimit mes Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për zhvillim (AADF) dhe Ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së informacionit. Projekti synon prezantimin e një kurrikule TIK për klasën e parë deri në të tretën si dhe zgjerimin e kurrikulës në të gjitha shkollat fillore në Shqipëri, ofrimin e një platforme plotësuese online për të mbështetur mësimin e kodimit dhe mësimdhënien për të gjitha shkollat fillore në Shqipëri si dhe trajnimin e mësuesve për kurrikulën e re të TIK-ut.

**Treguesi**
**Numri i nxënësve të klasës së parë që janë të përfshirë në përfitimin e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.**
Treguesi jep informacion mbi numrin e nxënësve të klasës së parë të arsimit bazë që janë të përfshirë në përfitimin e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

**Analiza e masës**

Në bazë të urdhrit të Kryeministrit me Nr. 151, datë 30.12.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për kurrikulën e kodimit që në klasë të parë për projektin “Analiza e situatës aktuale dhe propozimi i kurrikulave të përditësuara për lëndën e kodimit në sistemin arsimor parauniversitar”, vendimit të këshillit të Nr. 594, datë 07.09.2022 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për zbatimin e projektit “Element IT”, për përfshirjen e TIK në klasën e parë me fokus kodimin, është hartuar produkti: Programi i TIK-ut për klasën e pare. Nga raportimi i punës së ASCAP-it 2022, rezulton se janë hartuar materialet mbështetëse për zbatimin e programeve të klasës së parë. Trajnimet ndiqen 100% nga AADF. Aktualisht janë trajnuar 125 TOT dhe 300 mësues që japin mësimin e lëndës së TIK në klasën e parë. Kompetenca digjitale që në klasën e parë është shtrirë në 100 shkolla, në përmbushje të planifikimit.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.2.6 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.2.6** | Përfshirja e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që në klasën e parë. | Numri i nxënësve të klasës së parë që janë të përfshirë në përfitimin e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. | **100%** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.2.6** | | **100%** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.2**

**Përshkrimi i produktit**

Hartimi i“Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, ka për qëllim të sigurojnë një qasje të standardizuar për të gjithë mësuesit, në lidhje me përdorimin e TIK-ut në shkollë dhe në procesin mësimor. Këto standarde përcaktojnë treguesit për zbatimin e TIK-ut në procesin mësimor, si dhe synojnë të përgatisin mësuesit për t’u bërë përdorues të teknologjive të ndryshme të komunikimit dhe të informimit.

Pilotimi i SELFIE Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of InnovativeEducational Technologies është një aplikacion i dizenjuar për të ndihmuar shkollat në përfshirjen e teknologjive digjitale në mësimdhënie, mësim nxënie dhe vlerësim. Rrjeti Twinning është një mundësi konkrete e

përfshirjes aktive të mësuesve e nxënësve në projekte kurrikulare binjakëzuese të bazuara në zhvillimin e kompetencave të qëndrueshme të TIK-ut. Për një përqasje të re të zhvillimit të kapaciteteve shkollat do të angazhohen për pjesëmarrje aktive në EU Code Week, iniciativë e Komisionit Evropian.

**Analiza e produktit**

ASCAP ka hartuar"Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit", tetor 2020 për të siguruar një qasje të standardizuar për të gjithë mësuesit, në lidhje me përdorimin e TIK-ut në shkollë dhe në procesin mësimor. Deri në përfundim të vitit 2022 e në vijim nuk ka filluar ende të pilotohet platforma "SELFIE".

Në kuadër të linçimit të nismës "Siguria në internet", ASCAP ka hartuar një manual për mësuesit lidhur me informimin dhe ndërgjegjësimin e mësuesve me sfidat dhe rreziqet që përballen nxënësit në botën virtuale. Janë hartuar dhe miratuar Standardet profesionale të përdorimit të TIK, mbështetur në Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale.

ASCAP ka hartuar materialin mbështetës në ndihmë të mësuesve i cili inicion njohjen e koncepteve të kodimit dhe nocionet e të menduarit kompjuterik (computational thinking). Për vitin shkollor 2022-2023 programi kombëtar i kodimit zbatohet në 100 shkolla, ku janë përfshirë 101 mësues dhe numri i nxënësve është 7 076 gjithsej. Nga raportimi i punës së ASCAP-it 2022, rezulton se janë hartuar materialet mbështetëse për zbatimin e programeve të klasës së parë. Aktualisht janë trajnuar 125 TOT dhe 300 mësues që japin mësimin e lëndës së TIK në klasën e parë. Kompetenca digjitale që në klasën e parë është shtrirë në 100 shkolla, në përmbushje të planifikimit.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.2 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A5.2** | Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit të shtuar të TIK-ut në të gjitha lëndët në të gjitha nivelet e arsimit duke filluar që nga klasa e parë e arsimit bazë. | Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit | 5 |
| | | Pilotimi i SELFIE (Self-reflection on Effective Learning by Fostering the use of Innovative Educational Technologies) | 0 |
| | | Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet | 4 |
| | | Përcaktimi i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian | 5 |
| | | Përfshirja e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët e të lartë në programin kombëtar të kodimit | 5 |
| | | Përfshirja e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që në klasën e parë të arsimit bazë | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A5.2** | | **4** |



**PRODUKTI A5.3. OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE TË TIK-UT**

**A5.3.1 Kontraktimi i shërbimit të internetit për shkollat.**
Institucionet shkollore duhet të kenë qasje në internet broadband, për shfrytëzimin efektiv të burimeve nga Interneti. Investimet për lidhje cilësore me internetin në shkolla në zona të thella, janë të kushtueshme, megjithatë, janë shpenzime të nevojshme për të siguruar shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla.

**Treguesi 1**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED1.** Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - **Niveli ISCED 1.** Vlera aktuale në total është 32%

**Treguesi 2**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED2.**
Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2. Vlera aktuale në total është 32%

**Treguesi 3**
**Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 2**
Ky tregues do të na tregojë përqindjen e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED 3. Vlera aktuale në total është 32%.
Institucioni përgjegjës për realizimin e treguesit - AKSHI.

**Analiza e masës**
Deri në përfundim të vitit 2022 vetëm 1200 institucione arsimore parauniversitare kanë marrë shërbim Internet nga AKSHI, ose 60% e të gjitha shkollave që duhet ta merrnin këtë shërbim.

**Niveli i zbatimit**
Masa konsiderohet e realizuar 60 %.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.3.1. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.3.1.** | Kontraktimi shërbimit të internetit për shkollat. | Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED1. | 60 % | 3 |
| | | Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED2. | 60% | 3 |
| | | Përqindja e shkollave që kanë akses në internet për qëllime pedagogjike - Niveli ISCED3. | 60% | 3 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.3.1.** | | **60%** | **3** |

**A5.3.2 Hartimi i metodologjisë për mësimin online.**

ASCAP-i ka detyrë hartimin e metodologjisë për zhvillimin e mësimit online, si në kushte normale, ashtu edhe në raste të emergjencave. Përparësi do të ketë qasja e nxënit të kombinuar, por sistemi duhet të jetë i përgatitur edhe për të ofruar mësim të plotë online në situatat e jashtëzakonshme, siç janë: pandemitë, fatkeqësitë natyrore, e të ngjashme.

**Treguesi**

**Hartimi i dokumentit për mësimin online të kombinuar.**

Treguesi na kushtëzon hartimin e një dokumenti mbi metodologjinë e zhvillimit të mësimit online e të kombinuar.

**Analiza e masës**

Nga raportimi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Kualifikimit për periudhën Janar - dhjetor 2022, rezulton se: Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, është hartuar materialit final, specifikisht me objektivin “Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë” dhe në veprimtarinë e këtij objektivi “Hartimi i metodologjisë për mësimin online”, ASCAP ka hartuar metodologjinë për zhvillimin e mësimit të kombinuar. Përparësi ka qasja e të nxënit të kombinuar, pasi sistemi duhet të jetë i përgatitur edhe për të ofruar mësim të plotë online në situatat e jashtëzakonshme. Produkt i këtij është udhëzuesi në mbështetje të mësuesve, lidhur me zhvillimin e modelit të arsimit të kombinuar dhe zbatimin e kompetencës digjitale” i publikuar ne faqen e ASCAP-it. ASCAP-I ka hartuar dy manuale: “Udhëzuesi për zbatimin e arsimit të kombinuar në institucionet arsimore parauniversitare” si dhe "Manuali i përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies”.

**Niveli i zbatimit**
Masa është në realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS A5.3.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **A5.3.2** | Hartimi i metodologjisë për mësimin online. | Hartimi i dokumentit për mësimin online të kombinuar. | **100 %** | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës A5.3.2** | | **100 %** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.3**

**Përshkrimiil produktit A5.3**
Institucionet shkollore duhet të kenë qasje në internet broad band, për shfrytëzimin efektiv të burimeve nga Interneti. Nevojitet që institucionet arsimore të kenë akses në internet për qëllime pedagogjike në Niveli ISCED 1; Niveli ISCED2 dhe Niveli ISCED3. Treguesi është pjesë e treguesve që OECD, UN, UNESCO përdor, është tregues i përdorur në SKA. Investimet për lidhje cilësore me internetin në shkolla në zona të thella, janë të kushtueshme, megjithatë, janë shpenzime të nevojshme për të siguruar shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla. Për zhvillimin e mësimit online, si në kushte normale, ashtu edhe në raste të emergjencave është e nevojshme hartimi i metodologjisë për mësimdhënien online. Në situatat e jashtëzakonshme si në raste pandemie apo fatkeqësie natyrore përparësi duhet të ketë qasja e nxënit të kombinuar.

**Analiza e produktit A5.3**
Deri në përfundim të vitit 2022 vetëm 1200 institucione arsimore parauniversitare kanë marrë shërbim Internet nga AKSHI, nga 3708 shkolla në total, 32% e të gjitha shkollave që duhet ta merrnin këtë shërbim. Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, është hartuar materiali final, specifikisht me objektivin “Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë” ASCAP ka hartuar dy manuale: “Udhëzuesi për zbatimin e arsimit të kombinuar në institucionet arsimore parauniversitare” si dhe "Manuali i përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies”.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT A5.3 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **A5.3** | Ofrimi i shërbimeve cilësore të TIK-ut për sistemin e arsimit parauniversitar. | Kontraktimi shërbimit të internetit për shkollat. | 3 |
| | | Hartimi i metodologjisë për mësimin online. | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit A5.3** | | **4** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK B1: NIVELI I SHKOLLËS**

**PRODUKTI B1.1. RRITJA E KAPACITETEVE INSPEKTUESE/MONITORUESE ME FOKUS RRITJEN E CILËSISË.**

**Masa B1.1.1. Trajnimi i inspektorëve**

ASCAP-i, në bashkëpunim me DPAP-në, analizon në vazhdimësi nevojat për trajnim të inspektorëve/vlerësuesve dhe harton module trajnimi për trajtimin e tyre. Inspektimet e ASCAP-it, që ndërmerren në bazë të vlerësimit të riskut, do të jenë burim i rëndësishëm i informacionit për vlerësimin e institucioneve arsimore..

**Treguesi**

**Përqindja e inspektorëve të trajnuar.**

Ky tregues jep numrin e inspektorëve/vlerësuesve të trajnuar të DPAP-së, DRAP-eve dhe ZVAP-ve që kanë marrë pjesë në trajnime.

**Analiza e masës**

Në zbatim të Udhëzimit të MAS Nr. 10, datë 06.05.2022 "Për ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të rrjetit kombëtar të monitoruesve, vlerësuesve dhe vlerësuesve në bazë risku për institucionet arsimore parauniversitare", ASCAP-i ka përgatitur infrastrukturën e nevojshme dhe ka planifikuar grupet e vlerësuesve për trajnim. Me një program 14 ditor, ASCAP-i ka trajnuar 96 specialistë dhe drejtorë shkollash të DRAP-it Durrës dhe ZVAP-ve, 121 specialistë dhe drejtues shkollash të DRAP-it Fier dhe ZVAP-ve përkatëse, si dhe 130 specialistë dhe drejtues shkollash si vlerësues të DRAP-it Korçë dhe ZVAP-ve të saj. Gjithashtu, janë trajnuar mësues të cilët janë përzgjedhur pas procesit të aplikimit në bazë të kritereve të vendosura. Janë certifikuar 347 vlerësues nga 300 vlerësues të parashikuar. Kohorta e katërt është planifikuar në janar 2023.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar në nivelin 5.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.1.1** | Trajnimi i inspektorëve. | Përqindja e inspektorëve të trajnuar. | 100 % | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.1.1** | | **100 %** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.1**

**Përshkrimi i produktit**

Në vitin 2019 janë krijuar dy institucione qendrore Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), e cila është përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së institucioneve arsimore dhe trajnimin e vlerësuesve të jashtëm, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) që bën vlerësime të jashtme nëpërmjet njësive të veta rajonale.

**Analiza e produktit**

Duke qenë se numri i inspektorëve dhe monitoruesve ka në sistemin arsimor ka qenë i ulët është parashikuar që deri në vitin 2026 të rriten kapacitetet inspektuese nëpërmjet trajnimeve dhe certifikimeve të vlerësuesve të rinj. Për vitin 2022 ASCAP-i ka trajnuar dhe certifikuar 347 vlerësues, të cilët do të angazhohen në grupe për vlerësimin e institucioneve arsimore.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **B1.1** | Rritja e kapaciteteve inspektuese/monitoruese me fokus rritjen e cilësisë. | Trajnimi i inspektorëve | 5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit B.1.1** | | **5** |



**PRODUKTI B1.2 PËRMIRËSIMI I DREJTIMIT DHE MENAXHIMIT TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

**Masa B1.2.1 Trajnimi i drejtuesve të shkollave.**
Trajnimet e drejtuesve të shkollave parashikohet të bëhen nga Shkolla e Drejtorëve, e cila ofron programe për trajnimin e detyrueshëm përgatitor që sjellin certifikimin për drejtues të shkollës, si dhe programe të zhvillimit profesional të vazhdueshëm për drejtues të shkollave.

**Treguesi**
**Numri i të certifikuarve nga Shkolla e Drejtorëve.**
Ky tregues na jep numrin e drejtuesve/aspirantëve për drejtues që kanë përfunduar më sukses dhe janë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve.

**Analiza e masës**
Shkolla e drejtorëve që nga viti 2019 ka filluar programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare dhe certifikimin e tyre. Ky program ka për qëllim certifikimin e drejtuesve të IAP-ve dhe aspirantëve për drejtues, duke ndjekur programin e trajnimit të hartuar specifikisht për drejtuesit e shkollave. Qendra "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL- Center for School Leadership), ushtron veprimtarinë, në vijim të një sërë hapash të përbashkët që janë ndërmarrë nga MASR dhe Fondacioni Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim (AADF). Nga viti 2019 deri në vitin 2022 kanë aplikuar 2281 kandidatë, janë trajnuar 1906 prej tyre dhe janë certifikuar 404 prej tyre.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.2.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.2.1** | Trajnimi i drejtuesve të shkollave. | Numri i të certifikuarve nga Shkolla e Drejtorëve. | 100% | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.2.1** | | **100%** | |

**Masa B1.2.2Avancimi i kritereve dhe hartimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave.**
Hartimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave parashikohet të bëhet nga specialistët e ASCAP-it.

**Treguesi**
**Dokumentet e hartuara/ miratuara për emërimin e drejtuesve të shkollave.**
Ky tregues na jep dokumentet e hartuara dhe miratuara për emërimin e drejtuesve të shkollave, ku përfshihet përmirësimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave mbi bazën e procedurave transparente.

**Analiza e masës**
Lidhur me hartohen dhe miratohen dokumente për emërimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në funksion të transparencës dhe meritokracisë. Në këtë kuadër, MAS-i ka nxjerrë dy akte: Udhëzimin Nr. 24, datë 01.08.2022 "Për një ndryshim në udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar i ndryshuar", si dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar 100%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.2.2 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.2.2** | Avancimi i kritereve dhe hartimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave. | Dokumentet e hartuara/ miratuara për emërimin e drejtuesve të shkollave. | 100% | **5** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.2.2** | | **100 %** | |

**Masa B1.2.3 Vlerësimi i drejtuesve të shkollave**.
Vlerësimi i drejtuesve të shkollave do të realizohet në funksion të përmirësimit të cilësisë në drejtimin e institucioneve arsimore.

**Treguesi**
**Përqindja e drejtorëve që u është vlerësuar performanca.**
Ky tregues na jep përqindjen e drejtorëve të institucione arsimore që u është vlerësuar performanca.

**Analiza e masës**

Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së drejtimit dhe menaxhimit të shkollës, si dhe të vlerësimit të performancës së drejtuesve, të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin e detyruar pranë CSL-së dhe drejtuesve të tjerë të shkollave, ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-n ka realizuar 53 vlerësime shkollash (drejtorë dhe nëndrejtorë) nga 60 institucione arsimore të planifikuara.

**Niveli i zbatimit**

Masa është realizuar 88%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.2.3 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.2.3** | Vlerësimi i drejtuesve të shkollave. | Përqindja e drejtorëve që u është vlerësuar performanca. | 80% | **4.4** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.2.3** | | **88%** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.2**

**Produkti: Përmirësimi i drejtimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore**

**Përshkrimi i produktit**

Një rol te rëndësishëm në përmirësimin e performancës së shkollës luan drejtimi dhe menaxhimi i institucionit arsimor. Në SKA është parashikuar trajnimi i drejtuesve të shkollave dhe vlerësimi i tyre. Gjithashtu, parashikohet avancimi i kritereve dhe hartimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave. Përpos ndryshimeve ligjore dhe matjes së performancës së drejtuesve, parashikohet trajnimi i detyrueshëm përgatitor për drejtuesit dhe aspirantëve për drejtues në institucionet arsimore parauniversitare nga shkolla e drejtorëve.

**Analiza e produktit**

Shkolla e drejtorëve AADF ka hartuar dhe miratuar bazën ligjore të nevojshme për programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare. Baza kryesore ligjore ku mbështetet kjo veprimtari është Ligji Nr. 48/2018 datë 23.07.2018 për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr 69/2012 datë 21.06.2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj ka sjellë disa ndryshime thelbësore që kanë të bëjnë me institucionin tonë dhe procesin e përzgjedhjes

e emërimit të drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar. Gjithashtu, MAS-i ka nxjerrë dy akte përkatësisht: Udhëzimin Nr. 24, datë 01.08.2022 "Për një ndryshim në udhëzimin Nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar i ndryshuar", si dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar".

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.2** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **B1.2** | Përmirësimi i drejtimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore. | Trajnimi i drejtuesve të shkollave. | 5 |
| | | Avancimi i kritereve dhe hartimi i udhëzimeve për emërimin e drejtuesve të shkollave. | 5 |
| | | Vlerësimi i drejtuesve të shkollave. | 4.4 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit B1.2** | | **4.8** |



**PRODUKTI B1.3 VLERËSIMI I JASHTËM E I BRENDSHËM NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË SHKOLLËS**

**Masa B1.3.1 Trajnimi i inspektorëve dhe drejtuesve e stafeve të shkollave lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë.**

Trajnimi i inspektorëve të DRAP-ve lidhur me dokumentin "Korniza për vlerësimin e shkollës", është parashikuar të realizohet nga ASCAP-i, duke mbuluar tema kyçe, si: shfrytëzimi i treguesve të cilësisë nga mbledhja e të dhënave përkatëse dhe dhënia e informacioneve reflektuese. Trajnimi do të bazohet në shembuj nga praktika, si dhe do të përfshijë edhe punën praktike në terren, nën mbikëqyrjen e specialistëve të ASCAP-it.

**Treguesi 1**

**Numri i trajnimeve të realizuar për inspektorët lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë.**

Ky tregues na jep numrin e inspektorëve të trajnuar për kornizën e vlerësimit të cilësisë.

**Treguesi 2**

**Numri i trajnimeve të realizuara për drejtuesit e shkollave lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë.**

Ky tregues na jep numrin e drejtorëve të shkollave të trajnuar për kornizën e vlerësimit të cilësisë.

**Treguesi 3**

**Numri i trajnimeve të realizuar për mësuesit/stafet lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë**

Ky tregues na jep numrin e mësuesve/stafeve të trajnuar për kornizën e vlerësimit të cilësisë.

**Analiza e masës**

Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë pranë ASCAP-it, në vitin 2020 ka hartuar paketën e vlerësimit të cilësisë të institucioneve arsimore, "Korniza e vlerësimit të cilësisë", "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës", "Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës", "Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës". Hartimi i këtyre dokumenteve u realizua në kushtet e ndryshimeve të mëdha në sistemin arsimor shqiptar, veçanërisht në fushën kurrikulare.

ASCAP-i, në vitin 2021 ka zhvilluar trajnime me grupet e interesit në lidhje me paketën e vlerësimit të cilësisë. Në vitin 2022 nuk janë zhvilluar trajnime me stafet mësimore në lidhje me paketën e vlerësimit të cilësisë të institucioneve arsimore.

**Niveli i zbatimit**

Kjo masë është realizuar 66%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.3.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.3.1** | Trajnimi i inspektorëve dhe drejtuesve e stafeve të shkollave | Numri i trajnimeve të realizuar për inspektorët lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë. | 100% | **3.3** |
| | | Numri i trajnimeve të realizuar për drejtuesit e shkollave lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë. | 100% | |
| | | Numri i trajnimeve të realizuar për mësuesit/stafet lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë. | **0%** | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.3.1** | | **66 %** | |

**Masa B1.3.2Mbështetja e vazhdueshme e shkollave me performancë të ulët për përmirësimin e tyre.** Shkollave me performancë më të ulët do t'u ofrohet mbështetje e veçantë për përmirësim nga ZVAP-të dhe DRAP-et përkatëse. Kjo parashikohet të arrihet nëpërmjet mbikëqyrjeve dhe këshillimit të shtuar, por edhe krijimit të rrjeteve të shkollave në nivel lokal për ofrimin e ndihmës së nevojshme për përmirësim të performancës.

**Treguesi 1**
**Numri i shkollave me performancë të ulët**
Ky tregues jep numrin e shkollave më performancë të ulët të cilat janë verifikuar si të tilla nga testet kombëtare dhe trupat e inspektimit/vlerësimit.

**Treguesi 2**
**Numri i shkollave me performancë të ulët të rivlerësuara, me rekomandime.**
Ky tregues na jep numrin e shkollave me performancë të ulët të rivlerësuara.

**Analiza e masës**
Shkollave me performancë më të ulët do t'u ofrohet mbështetje e veçantë për përmirësim nga ZVAP-të dhe DRAP-et përkatëse. Këshillimi i shtuar, mbikëqyrja e shtuar e vazhdueshme dhe krijimi i rrjeteve të shkollave në nivel lokal për ofrimin e ndihmës së nevojshme për përmirësim e performancës së shkollave.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë nuk është vlerësuar sepse është parashikuar të realizohet në periudhën 2023-2026.

**Tabela e vlerësimit**

| **VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.3.2** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.3.2** | Mbështetja e vazhdueshme e shkollave me performancë të ulët për përmirësimin e tyre. | Numri i shkollave me performancë të ulët. | - | **-** |
| | | Numri i shkollave me performancë të ulët të rivlerësuara (me rekomandime). | - | |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.3.2** | | **-** | |

**Masa B.1.3.3 Kontrolli i cilësisë të vlerësimeve të jashtme i bazuar në rrezik.**
ASCAP-i parashikohet të bëjë vlerësime të jashtme të shkollave të bazuar në risk, nëpërmjet të cilave do të realizohet edhe një kontroll i vlerësimeve të jashtme të realizuara nga DRAP-të.

**Treguesi 1**
**Numri i vlerësimeve nga ASCAP-i i bazuar në rrezik.**
Ky tregues na jep numrin e shkollave të vlerësuara në bazë të riskut në përputhje me Manualin e Riskut.

**Treguesi 2**
**Përqindja e shkollave që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm.**
**Numri i shkollave që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm nga institucionet përgjegjëse mbështetur ne paketën e vlerësimit të cilësisë.**

**Analiza e masës**
Procesi i kontrollit të cilësisë në bazë të riskut në planin e veprimit të SKA është synuar të arrihet në vitet 2022-2026. Gjatë vitit 2022 është hartuar vetëm manuali i Riskut, i cili pritet te miratohet nga MAS. ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në, gjatë vitit 2022, kanë realizuar 34 vlerësime të plota të IAP-ve publike dhe private. Janë vëzhguar dhe vlerësuar mbi 700 orë mësimore. Kjo masë nuk është realizuar plotësisht ashtu siç është synuar në SKA, pasi nuk është realizuar asnjë vlerësim në bazë risku. Ndërkohë, janë realizuar veprimtari të tjera të paplanifikuara në planin vjetor, të iniciuara nga MAS.

**Niveli i zbatimit**
Masa është zbatuar 60%.

**Tabela e vlerësimit**

<table>
<tr><th colspan="5">VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.3.3</th></tr>
<tr><th>Nr.</th><th>Masa/Veprimtaria</th><th>Treguesit e matjes</th><th>Realizimi %</th><th>Vlerësimi 1-5</th></tr>
<tr><td rowspan="3">B1.3.3</td><td rowspan="2">Kontrolli i cilësisë të vlerësimeve të jashtme i bazuar në rrezik.</td><td>Numri i vlerësimeve nga ASCAP-i i bazuar në rrezik.</td><td>20%</td><td rowspan="3">3</td></tr>
<tr><td>Përqindja e shkollave që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm.</td><td>100%</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i realizimit të masës B1.3.3</td><td>60%</td></tr>
</table>

**Masa B.1.3.4. Për një shkollë autonome, vendosja e prioriteteve në bashkëpunim me organizmat e shkollës dhe komunitetit për një planifikim afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës.**

**Treguesi**
**Planifikimi afatmesëm për një shkollë autonome.**
Vlerësimi i shkollave në funksion të vendosjes së prioriteteve në planifikimin afatmesëm për një shkollë autonome.

**Analiza e masës**
Planifikimi afatmesëm dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës janë të karakterizuara me formalizëm dhe pa ndërlidhje të qartë ndërmjet tyre. Edhe pse të menduara si hapa drejt shtimit të autonomisë së shkollës, përkundër udhëzimeve të Ministrisë, jo të gjitha shkollat i kanë të qarta detyrimet e veta në lidhje me planifikimin afatmesëm dhe vlerësimin e brendshëm. Në kuadër të një planifikimi afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës, institucionet përgjegjëse nuk kanë planifikuar dhe nuk kanë realizuar vlerësime/monitorime apo ngritje kapacitetesh për një shkollë autonome.

**Niveli i zbatimit**
Kjo masë është realizuar në nivelin 0%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B1.3.4 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B1.3.4** | Për një shkollë autonome, vendosja e prioriteteve në bashkëpunim me organizmat e shkollës dhe komunitetit për një planifikim afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës. | Planifikimi i një procesi afatmesëm për një shkollë autonome. | 0% | **0** |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B1.3.4.** | | **0%** | |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.3**

**Përshkrimi i produktit**
Me qëllim përmirësimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit të jashtëm të shkollës është parashikuar të realizohet trajnimi i inspektorëve dhe drejtuesve e stafeve të shkollave lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë. Mbështetja e vazhdueshme e shkollave me performancë të ulët për përmirësimin e tyre dhe ofrimi i mbështetjes së veçantë për përmirësim nga ZVAP-të dhe DRAP-të përkatëse do të jetë në fokus të institucioneve përgjegjëse (ASCAP, DPAP) për përmirësimit të cilësisë së shkollës. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mbikëqyrjeve dhe këshillimit të shtuar, por edhe krijimit të rrjeteve të shkollave në nivel lokal për ofrimin e ndihmës së nevojshme për përmirësim të performancës. ASCAP-i do të bëjë vlerësimin e jashtëm të shkollave të bazuara në risk. Ndërkohë në vëmendje të punës së institucioneve arsimore do të jetë edhe zbatimi i masës për një shkollë autonome, vendosja e prioriteteve në bashkëpunim me organizmat e shkollës dhe komunitetit për një planifikim afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës.

**Analiza e produktit**
ASCAP-i ka realizuar trajnimin e inspektorëve dhe vlerësuesve të arsimit parauniversitar. Për vitin 2022 ka trajnuar dhe certifikuar 347 vlerësues. Në lidhje me programin e trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare nga shkolla e drejtorëve AADF, është hartuar dhe miratuar baza ligjore e nevojshme. Ndërkaq, MAS ka nxjerrë dy udhëzime për emërimin e drejtuesve të shkollave. ASCAP-i ka filluar punën për kontrollin e cilësisë në bazë të riskut. Kështu, gjatë vitit 2022 ka hartuar manualin e riskut, që përmban matricën e riskut dhe faktorët e riskut. Ndërkaq, ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në kanë realizuar gjatë vitit 2022, 34 vlerësime të plota të IAP-ve publike dhe private dhe janë vëzhguar dhe vlerësuar mbi 700 orë mësimore. Është krijuar një model i qëndrueshëm,

është hartuar kuadër ligjor i mirë me një menaxhim institucional korrekt në lidhje me vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm në funksion të përmirësimit të shkollës

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B1.3 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **B1.3** | Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm janë në funksion të përmirësimit të shkollës | Trajnimi i inspektorëve dhe drejtuesve e stafeve të shkollave lidhur me kornizën e vlerësimit të cilësisë. | 3.3 |
| | | Mbështetja e vazhdueshme e shkollave me performancë të ulët për përmirësimin e tyre. | - |
| | | Kontrolli i cilësisë të vlerësimeve të jashtme i bazuar në rrezik. | 3 |
| | | Për një shkollë autonome, vendosja e prioriteteve në bashkëpunim me organizmat e shkollës dhe komunitetit për një planifikim afatmesëm bazuar në vlerësimin e shkollës. | 0 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit B1.3** | | **2.1** |



**OBJEKTIVI SPECIFIK B2: NIVELI I SISTEMIT**

**PRODUKTI B2.1 FUNKSIONALIZIMI I PLOTË I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PARAUNIVERSITAR (SMIP).**

**Masa B2.1.1 Konsolidimi i SMIP-it për ofrimin e të dhënave të nevojshme për vendimmarrje**.
Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) është baza e parë e të dhënave në Shqipëri që kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënit në nivelin qendror. Me këtë sistem mundësohet krijimi i regjistrit dhe amzës digjitale e shkollës në të cilat pasqyrohen të gjitha të dhënat dhe përditësimet njësoj si në dokumentet fizike.

**Treguesi**
**Trajnimi i personave përgjegjës në shkolla për SMIP.**
Ky tregues na jep numrin e trajnimeve të personave përgjegjës në shkollat publike dhe jopublike në sistemin parauniversitar.

**Analiza e masës**
Për sigurimin e informacionit lidhur me ofrimin e të dhënave të nevojshme për vendimmarrjen, është krijuar databaza e plotë me të dhëna e institucioneve arsimore publike dhe jopublike e realizuar gjatë vitit 2021-2022 nga DPAP/QShA, ku janë trajnuar administratorët e SMIP në çdo IAP. Aktualisht në sistem janë të implementuara të gjithë planet mësimore të cilat përdoren në institucionet arsimore publike (20 plane mësimore). Në vijim të procesit të popullimit të sistemit SMIP më të gjithë llojet e kurrikulave që aplikohen në sistemin arsimor parauniversitar, ASCAP-i ka rishikuar 224 plane mësimore të shkollave jopublike, si dhe ka dhënë sugjerime lidhur me riorganizimin e planeve mësimore dhe miratimin e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu vijon puna me procesin e analizës së planeve të ridërguar nga shkollat jopublike, si dhe hedhja në sistem e kurrikulave dhe planeve mësimore për shkollat e krijuara me VKM, shkollat me karakter fetar, me seksion dygjuhësh etj. Gjatë zbatimit të kësaj mase ka pasur disa vonesa të hedhjes së planeve nga shkollat jopublike, si dhe vonesa në hedhjen në sistem të kurrikulave dhe planeve mësimore për shkollat e krijuara me VKM, si shkollat me karakter fetar, si dhe ato me sistem dygjuhësh.

**Niveli i zbatimit**
Kjo konsiderohet është realizuar 90%.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS B2.1.1 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Masa/Veprimtaria** | **Treguesit e matjes** | **Realizimi %** | **Vlerësimi 1-5** |
| **B2.1.1** | Konsolidimi i SMIP-it për ofrimin e të dhënave të nevojshme për vendimmarrje. | Trajnimi i personave përgjegjës në shkolla për SMIP. | 90% | 4.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të masës B2.1.1** | | **90%** | **4.5** |

**VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B2.1**

**Përshkrimi i produktit**

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) është baza e parë e të dhënave në Shqipëri që kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënit në nivelin qendror. Me këtë sistem mundësohet krijimi i regjistrit dhe amzës digjitale e shkollës në të cilat pasqyrohen të gjitha të dhënat dhe përditësimet njësoj si në dokumentet fizike.

**Analiza e produktit**

Shqipëria ka bërë hapin e parë drejt vlerësimit të brendshëm performancës së sistemit të arsimit duke krijuar një drejtori të veçantë për performancën brenda ASCAP-it, si dhe duke avancuar në krijimin e një sistemi të mirëfilltë të menaxhimit të informacioneve në arsimin parauniversitar. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), është një sistem elektronik i bazës së të dhënave shtetërore kombëtare në arsimin parauniversitar. Ky sistem tashmë është implementuar dhe po shtrihet në të gjithë shkollat e vendit. Funksionalizimi i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) është pothuajse i realizuar.

**Tabela e vlerësimit**

| VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT B2.1 | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Produkti** | **Masa/veprimtaria** | **Vlerësimi** |
| **B2.1** | Funksionalizimi i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP). | B2.1.1. Konsolidimi i SMIP-it për ofrimin e të dhënave të nevojshme për vendimmarrje. | 4.5 |
| | **Vlerësimi i realizimit të produktit B2.1** | | **4.5** |



**PRODUKTI B2.3 PËRCAKTIMI I TREGUESVE KOMBËTARË TË ARSIMIT**

**Masa B2.3.1 Përcaktimi i paketës së treguesve kombëtarë të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor.**
Paketa e treguesve e miratuar institucionalisht parashikohet të jetë bazë për analizën dhe vlerësimin e performancës së sistemit arsimor

**Treguesi**
**Publikohen të dhëna për treguesit kombëtarë të arsimit**
Ky tregues pasqyron paketën e treguesve kombëtar në gjithë sistemin arsimor.

**Analiza e masës**
